

# STUDIM MBI TË DREJTAT E PRONËSISË TË KOMUNITETEVE FETARE NË SHQIPËRI

Botuar nga Instituti Shqiptar për Studime Ligjore dhe Territoriale (A.L.T.R.I) në kuadër të projektit me temë:

**“Një studim gjithëpërfshirës mbi të drejtat e pronësisë të komuniteteve fetare në Shqipëri”, financuar nga Canada Fund for Local Initiatives  
Tiranë, 2016**

Activity supported by the  
Canada Fund Local Initiatives  
Activité réalisée avec l'appui du  
Fonds canadien d'initiatives locales

Canada



**A.L.T.R.I**

Ky Studim është përgatitur nga ekspertët e Institutit Shqiptar për Studime Ligjore dhe Territoriale (A.L.T.R.I) në kuadër të projektit me temë: “Një studim gjithëpërfshirës mbi të drejtat e pronësisë të komuniteteve fetare në Shqipëri”, financuar nga Canada Fund for Local Initiatives. Opinionet e shprehura në këtë Studim nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht mendimet e donatorit.

Botuar nga Instituti Shqiptar për Studime Ligjore dhe Territoriale-A.L.T.R.I  
Rr “Asim Zeneli”, Nr. 15, Tiranë, Shqipëri  
Web: [www.altri.al](http://www.altri.al)  
Email: [qendra.altri@gmail.com](mailto:qendra.altri@gmail.com);

Të gjitha të drejtat e autorit janë të rezervuara. Materiali që përmban ky publikim mund të citohet ose të rishtypet me kusht që të njihet autorësia e tij. Çdo përdorim tjetër i këtij materiali, që përfshin, por që nuk kufizohet në përdorimin tregtar apo në krijimin e punimeve që rrjedhin nga ky publikim, kërkon lejen me shkrim të Qendrës ALTRI.

*ISBN:*

# PËRMBAJTJA E LËNDËS

<i>Falenderime</i> .....	5
<i>Parathënie</i> .....	7

## KAPITULLI I

### ANALIZË LIGJORE MBI TË DREJTAT E PRONËSISË TË

### KOMUNITETEVE FETARE NË SHQIPËRI .....

1.1	Evolucioni i të drejtës së pronësisë së komuniteteve fetare që prej vitit 1912 .....	9
1.1.1	Kanuni Labërisë .....	10
1.1.2	Të drejtat e pronësisë së komuniteteve fetare pas viti 1912 deri në vitin 1944 .....	11
1.1.3	E drejta Socialiste 1944-1990.....	15
1.2	Kuadri ligjor dhe politik mbi të drejtën e pronësisë të komuniteteve fetare në Shqipëri .....	20
1.2.1	Kuadri ligjor ndërkombëtar .....	20
1.2.2	Kuadri ligjor i brendshëm .....	23
	i. Kuadri kushtetues i respektimit dhe mbrojtjes së lirisë së ushtrimit të besimit fetar dhe të drejtës së pronës .....	24
	ii. Kuadri ligjor që garanton të drejtën e pronës .....	28
	iii. Marrëveshjet ndërmjet Qeverisë shqiptare dhe komuniteteve fetare .....	29
1.2.3	Kuadri Politik .....	35
	i. Strategjitë .....	35
	ii. Vlerësime të raporteve të organizatave ndërkombëtare .....	39
1.3	Institucionet përgjegjëse për çështjet e pronësisë .....	43
1.4	Vendime të Gjykatës kushtetuese dhe Gjykatës së lartë mbi të drejtën e pronës .....	46
1.4.1	Vendime të Gjykatës Kushtetuese .....	46
1.4.2	Vendime të Gjykatës së Lartë .....	49

## **KAPITULLI II**

### **VLERËSIMI I SITUATËS AKTUALE TË ÇËSHTJES SË PRONËSISË**

<b>SË KOMUNITETEVE FETARE .....</b>	<b>53</b>
2.1 Analiza e të dhënave të mbledhura nga fokus grupet .....	54
2.1.1 Zbatimi i legjislacionit në fuqi .....	54
2.1.2 Situata e kthimit dhe kompensimit të pronave të komuniteteve fetare .....	58
2.1.3 Situata në procesin e legalizimit të pasurive .....	59
2.2 Situata e pronave të komuniteteve fetare .....	61
2.2.1 Komuniteti Mysliman Shqiptar .....	61
2.2.2 Kryegjyshata Botërore Bektashiane .....	63
2.2.3 Kisha Katolike e Shqipërisë .....	65
2.2.4 Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë .....	67

## **KAPITULLI III**

### **KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME .....**

<b>KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME .....</b>	<b>69</b>
Shtojca I .....	73
Shtojca II .....	77
Shtojca III .....	81
Shtojca IV .....	94
Shtojca V .....	107

## **FALËNDERIME**

Falënderojmë Fondin Kanadez për Iniciativat Lokale (Canada Fund for Local Initiatives) i cili mbështeti realizimin e këtij studimi dhe aktiviteteve të tjera në kuadër të këtij projekti. Një mbështetje të pakufizuar dhe angazhim të plotë dhanë, gjatë zbatimit të këtij projekti, përfaqësuesit e institucioneve shtetërore përgjegjëse për çështjet e pronësisë dhe çështjet e nxitjes së respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut: Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, ALUIZNI, Komiteti Shtetëror i Kulteve, Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Avokati i Shtetit, Arkiva e Shtetit dhe Këshilli i Qarkut Tiranë. Falënderojmë drejtuesit dhe punonjësit e këtyre institucioneve që lehtësuan komunikimin për marrjen e të dhënave në kohë shumë të shkurtër dhe që mundësuan jo vetëm qartësimin e situatës aktuale, por krijuan hapësira të reja për më tepër bashkëpunim dhe ndërveprim në të ardhmen. A.L.T.R.I shpreh mirënjohjen dhe falënderimet e veçanta për kontributin dhe pjesëmarrjen gjatë aktiviteteve të këtij projekti për komunitetet fetare shqiptare: Komunitetin Mysliman Shqiptar, Kishën Katolike të Shqipërisë, Kishën Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë dhe Kryegjyshatën Botërore Bektashiane, pa bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen aktive të të cilëve, ky projekt do të ishte i pamundur. Në veçanti A.L.T.R.I. falënderon ekspertët ligjorë të përfshirë në këtë projekt të cilët me punën kërkimore dhe analizën e specializuar ligjore pasqyruan kuadrin e plotë aktual të situatës së të drejtave të pronësisë të komuniteteve fetare në Shqipëri.

*Tabela e shkurtimeve dhe akronimeve*

<b>AKKP</b>	Agjencia për Kthimin dhe Kompesimin e Pronave
<b>ALUIZNI</b>	Agjencia e Legalizimit Urbanizimit dhe Integrimi i Zonave/Ndërtimeve Informale
<b>ATP</b>	Agjencia për Trajtimin e Pronave
<b>GJEDNJ</b>	Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut
<b>KEDNJ</b>	Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut
<b>KKKP</b>	Komisioni për Kthimin dhe Kompesimit të Pronave
<b>KMD</b>	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
<b>KMSH</b>	Komuniteti Mysliman Shqiptar
<b>KOASH</b>	Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë
<b>KPrC</b>	Kodi i Proçedurës Civile
<b>VKM</b>	Vendim i Këshillit të Ministrave
<b>ZRPP</b>	Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme

## PARATHËNIE

E drejta e ushtrimit të besimit fetar është një e drejtë themelore e njeriut, njohur edhe në instrumentet ndërkombëtare. Standardet ndërkombëtare specifikojnë se çdo njeri gëzon të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe besimit fetar. Kjo e drejtë përfshin lirinë e manifestimit të besimit fetar në mënyrë individuale ose në komunitet me persona të tjerë, në mënyrë publike ose private, nëpërmjet adhurimit, mësimi, praktikimit dhe respektimit.<sup>1</sup> Liria e adhurimit përfshin lirinë e mbledhjes së një komuniteti fetar të caktuar dhe lirinë e tij për të kryer ritualet dhe ceremonitë fetare si dhe praktikatat e ndryshme si shprehje e besimit fetar, përfshirë lirinë e hyrjes në vendet e kultit, shfaqjen dhe përdorimin e objekteve simbolike me karakter fetar.

E drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut i akordon mbrojtje të veçantë komuniteteve fetare, pavarësisht nëse ata gëzojnë ose jo personalitet juridik. Komunitetet fetare mund të zgjedhin të krijojnë, në përputhje me legjislacionin vendas, organizata fetare për të krijuar mundësinë për të kryer veprime juridike. Shtetet duhet të sigurojnë se kuadri ligjor kombëtar që parashikon çështjen e fitimit të personalitetit juridik të komuniteteve fetare duhet të jetë në përputhje me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut për të cilat ata janë palë dhe me angazhimet e tyre të tjera ndërkombëtare.

Ekzistenca autonome e komuniteteve fetare është e domosdoshme për pluralizmin e një shoqërie demokratike dhe si e tillë qëndron në themel të mbrojtjes së lirisë së besimit fetar. Kjo autonomi ka të bëjë jo vetëm me organizimin e këtyre komuniteteve si të tillë, por edhe me gëzimin efektiv të së drejtës për të ushtruar lirinë e besimit fetar nga të gjithë anëtarët aktivë të tyre.

---

<sup>1</sup> OSCE/ODHIR Guidelines on the Legal Personality of Religious or Belief Communities, 2014.

Ky studim, i cili realizohet me mbështetjen e Canada Fund for Local Initiatives (CFLI), ka si qëllim identifikimin e situatës ligjore dhe praktike të së drejtës së pronësisë të komuniteteve fetare në Shqipëri. Studimi reflekton punën disa mujore të ekspertëve të Qendrës A.L.T.R.I. të cilët nëpërmjet aktiviteteve kërkimore dhe analizës së specializuar të legjislacionit në fuqi kanë pasqyruar të detajuar të drejtat pronësore të komuniteteve fetare duke i trajtuar në këndvështrimin e evolucionit të tyre dhe të aktualitetit bazuar mbi praktikat dhe legjislacionin në fuqi.

Ky studim ofron një bazë të plotë dhe të nevojshme në fushën e të drejtave të pronësisë të komuniteteve fetare në Shqipëri, kjo edhe për faktin se përfshin vlerësimin e situatës aktuale të zbatimit të legjislacionit në fuqi. Me qëllim identifikimin e situatës aktuale, ALTRI zhvilloi një sërë takimesh me përfaqësues të institucioneve publike përgjegjës për çështjet e pronësisë, si edhe me përfaqësues të komuniteteve fetare. Fokusi i këtyre takimeve ishte diskutimi lidhur me zbatimin e legjislacionit në praktikë, identifikimi i problematikave, mbledhja e të dhënave lidhur me kërkesat e komuniteteve dhe vendime të dhëna nga institucionet përgjegjëse për kthimin/kompensimin/legalizimin e objekteve të tyre, si dhe marrja e mendimeve për sa i përket mekanizmave/instrumenteve të nevojshëm për zgjidhjen e problematikave të identifikuara.

Të gjitha informacionet dhe të dhënat e përpunuara janë përfshirë në pjesën e dytë të këtij studimi. Ato, së bashku konkluzionet e nxjerra nga analiza ligjore, shërbyen si bazë për ekspertët e ALTRI për të hartuar rekomandimet për vijimësinë e punës. Me qëllim njohjen e rekomandimeve nga të gjithë përfituesit e këtij studimi, ALTRI zhvilloi një proces të gjerë konsultimi, rezultat i të cilit janë rekomandimet e unifikuara të paraqitura në pjesën e tretë të këtij studimi.



# KAPITULLI I

## ANALIZË LIGJORE MBI TË DREJTAT E PRONËSISË TË KOMUNITETEVE FETARE NË SHQIPËRI

Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të njeriut është një nga shtyllat kryesore të një shoqërie demokratike. Shqipëria është palë në një sërë konventash europiane dhe ndërkombëtare dhe ka miratuar një legjislacion gjithëpërfshirës mbi të drejtat e njeriut. Një kapitull i veçantë i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i është kushtuar këtyre të drejtave.

E drejta dhe liria e ushtrimit të besimit fetar individualisht ose kolektivisht është një e drejtë e sanksionuar në aktet e lartpërmendura. Ushtrimi i besimit fetar është i lidhur ngushtësisht me të drejtën e komuniteteve fetare për të pasur në pronësi objektet e kultit dhe pasuri të tjera të paluajshme. Në Shqipëri kjo e drejtë ka kaluar në disa faza historike, duke u përballur me probleme të mprehta të cilat presin ende zgjidhje.

Për një kuptim më të plotë të situatës së gëzimit të të drejtave pasurore nga ana e komunitetit fetar është e nevojshme të bëhet referimi tek shifrat që tregojnë madhësinë e komunitetit fetar në Shqipëri. Për këtë, përgjigjen referuese e gjejmë në rezultatet e Censurit të Popullsisë dhe Banesave të vitit 2011. Sipas këtij censuri, numri i banorëve të Shqipërisë që iu nënshtrua procesit të intervistimit ishte 2.800.138 nga të cilët 56.70% i përkisnin besimit mysliman, 10.03% besimit katolik, 6.75% besimit ortodoks, 2.09% besimit bektashi<sup>2</sup>. Siç shihet, mbi 75% e të gjithë popullsisë i përket katër besimeve tradicionale fetare që dëshmon rëndësinë që paraqet mbrojtja të drejtave të tyre të pronësisë.

### **I.1 Evolucionin e të drejtës së pronësisë së komuniteteve fetare që prej vitit 1912**

Analiza mbi evolucionin e të drejtës së pronësisë së komuniteteve fetare në Shqipëri që prej vitit 1912 merr rëndësi për shkak se nga ky vërtetim do

---

<sup>2</sup> Rënditja e komuniteteve fetare në përmbajtjen e këtij Studim është mbështetur në rezultatet e Censurit të 2011.

të mund të kuptohet jo vetëm problematika aktuale, por edhe mënyra se si duhet trajtuar kjo çështje në ditët e sotme dhe në të ardhmen.

### ***1.1.1 Kanuni Labërisë***

Një nga kanunet që ka arritur deri më sot është dhe Kanuni i Labërisë, ose siç njihet në popull me emrin shartet e Idriz Sulit. Në normat e Kanunit të Labërisë sanksionohen në unitet etika dhe një sistem vlerash shumë të larta morale, si dhe parimet themelore juridike të mbrojtjes së nderit, burrërisë, fisnikërisë, besës, mikpritjes, parimet e barazisë së njerëzve etj. Në Kanunin e Labërisë janë të pasqyruar mjaft qartë të gjitha parimet ku është mbështetur në tërësi e drejta zakonore shqiptare.<sup>3</sup>

Gjithashtu, normat e Kanunit të Labërisë përcaktojnë në mënyrë fare të qartë se *prona private është e shenjtë dhe e paprekshme*, dhe si e tillë, ajo mbrohet në mënyrë të gjithanshme. Këto norma juridike përcaktojnë në mënyrë të prerë dhe pa asnjë paqartësi edhe format e ekzistencës së pronës private, të cilat ishin:

- a. Prona e vogël private, ku përfshihej dhe prona individuale;
- b. Prona e mesme private;
- c. Prona e madhe private;
- d. Prona e përdorimit të përbashkët (mushate);
- e. *Prona e institucioneve fetare, të quajtuara ndryshe “vakëfe”*;
- f. Prona shtetërore ose “malli belik”.

Kanuni i Labërisë parashikonte dispozita që sanksiononin masa ndëshkimore për këdo që cënonte apo dëmtonte objektet e kultit të njohura si vakëfe, si dhe veprimet ndaj klerikëve që shërbenin nën rrobën fetare.

Konkretisht, në Pjesën e VII “*Pjesa e posaçme llojet e veprave penale*”, të Kanunit të Labërisë parashikohen tre dispozita që kanë të bëjnë me veprimet kundër klerikëve ose objekteve të kultit. Më konkretisht, veprat penale si sharja, rrahja, ose çdo veprim tjetër poshtërues kundër klerikëve (priftërinjve, hoxhallarëve, baballarëve të teqesë) apo institucioneve fetare (kishës, xhamisë, teqesë) gjatë ushtrimit të riteve fetare, dënohej, si rregull me gjobë, ose me bojkotim apo me dëbim për një afat të caktuar nga komuniteti i një njësie vendore.<sup>4</sup>

<sup>3</sup> Ismet Elezi-Kanuni i Labërisë.

<sup>4</sup> Nenet 668 dhe 775 të Kanunit të Labërisë.

Ndërkohë që mbrojtje e veçantë i jepej edhe pasurisë dhe pronave të komuniteteve fetare, ku cënimi apo vjedhja e tyre dënohej sipas dispozitave të parashikuara në Kanun (vjedhja e pasurisë së xhamisë, kishës).

### ***1.1.2 Të drejtat e pronësisë së komuniteteve fetare pas viti 1912 dhe deri në vitin 1944***

Sanksionimi i pozitës së feve dhe komuniteteve fetare në shtetin e ri shqiptar të pavarur filloi që në hartimin e Kushtetutës së përkohshme të Shqipërisë nga Kongresi i Lushnjës, e cila në nenin 93 të saj parashikonte: *“Shteti shqiptar nuk ka fe zyrtare”. Të gjitha fetë dhe besimet fetare respektohen dhe sigurohet liria e praktikimit të tyre të jashtëm. “Feja në asnjë mënyrë nuk mund të përbëjë një pengesë juridike. Fetë dhe besimet fetare nuk mund të përdoren kurrsesi për qëllime politike.”*

Hap i rëndësishëm për fetë është miratimi në qershor të vitit 1923 nga Parlamenti Shqiptar i Statutit Legal të Komuniteteve Fetare.<sup>5</sup> Ishte Ahmet Zogu që i propozoi parlamentit që të votonte ligjin mbi statutin e komuniteteve fetare me të cilin shtetasit shqiptarë nuk do t’i nënshtroheshin më asnjë legjislacioni kanonik, veçse me dëshirë, por sidoqoftë duke iu bindur ligjeve të shtetit.

Në këtë statut përcaktohej që në hyrje të saj se *“të gjitha fetë e njohura janë të lira dhe të barabarta në raport me shtetin...Besimi, kulti, shfaqja e saj e jashtëm, procesioni dhe gjithë zakonet fetare që nuk kundërshtojnë moralin e përgjithshëm janë të lira dhe të siguruara brenda kufijve të Shtetit Shqiptar”*.<sup>6</sup>

Gjithashtu, statuti parashikonte se: *“Çdo komunitet fetar konsiderohet person juridik i cili ka të drejtë të ketë pasuri, të blejë e të shesë, të përfaqësohet në autoritetet civile e gjyqësore, ashtu dhe të drejtën të pranojë dhurata dhe vasiere për komunitetin që përfaqëson”*.<sup>7</sup>

Çështja e menaxhimit të pasurive të komuniteteve fetare, është një element shumë i rëndësishëm i rregulluar në këtë statut. Më konkretisht,

---

<sup>5</sup> A.Q.SH, f.246 v.1924 d.50 fl.3.

<sup>6</sup> Statusi Legal i Komuniteteve Fetare, pika I.

<sup>7</sup> Statusi Legal i Komuniteteve Fetare, pika XV.

në dispozitat e tij përcaktohet qartësisht se: *“komunitetet fetare kanë të drejtë të kenë, të fitojnë dhe të tjetërsojnë pasuri të luajtshme edhe të paluajtshme dhe të drejtat e tjera civile kompatible me natyrën e tyre, si edhe kanë të drejtë të administrojnë pasurinë e vet. Shteti ruan të drejtat e kontrollimit, mbi administrimin e pasurisë dhe mbi llogaritë e përvitshme të tyre sipas legjislacionit të veçantë për shoqatat (association)”*.<sup>8</sup>

Statuti u ndalon të gjitha autoriteteve fetare që të mbledhin taksa nga populli duke qenë se kjo detyrë i përket Qeverisë, me përjashtim të dhuratave të ndryshme që i adresohen këtyre komuniteteve. Sipas Statutit, Këshillat laike (të cilat përbëhen prej katër përfaqësuesish të zgjedhur prej komunitetit të çdo besimi fetar), kanë të drejtën për të kontrolluar pasurinë e vakëfeve, organizimin dhe administrimin e veprave filantropike, si dhe kontrollin e buxhetit të çdo komuniteti.<sup>9</sup>

Një element shumë i rëndësishëm i këtij Statuti është edhe subvencionin nga shteti i komuniteteve fetare, ku përcaktohet në mënyrë të veçantë se *“Gjithë kleri paguhet nga të ardhurat e pasurisë së tyre edhe nga ndihma financiare që ofrohet nga buxheti i shtetit, proporcionalisht sipas numrit të popullsisë së çdo komuniteti fetar”*.<sup>10</sup>

Statuti thekson, gjithashtu, se pasuritë e paluajtshme të komuniteteve janë të tjetërsueshme. Secili komunitet fetar ka të drejtë të menaxhojë, drejtojë dhe të kontrollojë (me shpenzimet e veta), xhami, kisha, teqe, manastire dhe faltore të tjera si dhe institute bamirësie pa asnjë pengesë apo formalitet, duke respektuar legjislacionin në fuqi.<sup>11</sup>

Duhet të theksohet se jo vetëm në zgjerimin e Statutit të 1921, por edhe në Statutin Themelor të Republikës të 2 marsit 1925,<sup>12</sup> dhe të Mbretërisë së shtatorit 1928, sanksionohej se feja nuk duhej të përdorej për qëllime politike.

<sup>8</sup> Statusi Legal i Komuniteteve Fetare, pika IV.

<sup>9</sup> Statusi Legal i Komuniteteve Fetare, pika XIX.

<sup>10</sup> Statusi Legal i Komuniteteve Fetare, pika XX.

<sup>11</sup> Statusi Legal i Komuniteteve Fetare, pika IV.

<sup>12</sup> Statusi Legal i Komuniteteve Fetare, Neni 5.

Më 1 shtator 1928, në mënyrë unanime, Kuvendi Kushtetues, aprovoi ndryshimet në Kushtetutë,<sup>13</sup> ku në të cilën Shqipëria shpallej Mbretëri Demokratike Parlamentare dhe e trashëgueshme. Gjithashtu, kjo Kushtetutë sanksiononte se: “*Shteti shqiptar nuk ka fe zyrtare. Të gjitha fetë dhe të gjithë besimet respektohen dhe garantohet ushtrimi i lirë i tyre. Feja në asnjë mënyrë nuk mund të shërbejë si ndalesë ose pengesë juridike e çdo lloji. Feja dhe besimet nuk mund të përdoren në asnjë mënyrë për realizimin e synimeve politike*”.<sup>14</sup>

Pothuajse gjashtë muaj pas shpalljes së monarkisë, më 16 korrik 1929,<sup>15</sup> Mbreti Zog, dekretoi ligjin mbi administrimin e komuniteteve fetare. Sipas tij, komunitetet fetare në Shqipëri ishin persona moral, që gëzonin të gjitha të drejtat përveç asaj për të marrë pjesë në veprimtari politike në mënyrë të drejtpërdrejtë, apo të tërthortë.<sup>16</sup>

Komunitetet fetare, gjithashtu, quheshin të formuara dhe gëzonin të drejtat e akorduara prej ligjit, vetëm kur Statuti i paraqitur prej tyre, aprovohej prej Këshillit të Ministrave dhe dekretohej nga Mbreti. Çdo kryetar sekti fetar zgjidhej në bazë të rregullores së vet edhe emërohej prej Kryetarit të komunitetit respektiv, përveç Kryetarëve të sekteve me rëndësi që duhet t’i paraqiteshin Qeverisë nëpërmjet Kryesisë së Komunitetit, për dekretim nga ana e mbretit.<sup>17</sup>

Komunitetet fetare ishin të lidhura, me Ministrinë e Drejtësisë, dhe të gjitha marrëdhëniet e tyre me Qeverinë kryheshin me anën e saj, e cila kishte të drejtë edhe t’i inspektonte ato. Po sipas ligjit, Mbreti mund të ndryshonte drejtuesit e komuniteteve fetare sa herë që ai konstatonte se ata ishin duke shkelur ligjin. *Komunitetet fetare nuk duhej të merrnin asnjë ndihmë e subvencion nga jashtë. Shpenzimet e tyre për qëllime humanitare, duhej të miratoheshin nga qeveria*.<sup>18</sup>

<sup>13</sup> Ndryshimet kushtetuese hyn në fuqi më 13 dhjetor 1928.

<sup>14</sup> “Shqipëria më 1937”, faqe 7.

<sup>15</sup> “Dekret–Ligjë mbi formimin e Komuniteteve Fetare”, botuar në gazetën zyrtare, më 1 shkurt 1930.

<sup>16</sup> “Dekret–Ligjë mbi formimin e Komuniteteve Fetare”, neni 3.

<sup>17</sup> “Dekret–Ligjë mbi formimin e Komuniteteve Fetare”, neni 6.

<sup>18</sup> Fletorja zyrtare, 1 shkurt 1939, nr. 8.

Megjithatë, me dekretin e tij komunitetet fetare në përgjithësi morën të gjitha masat për t'iu përshtatur situatës së re. Komuniteti mysliman, që ishte më i madh në numër, rreth 70 % sipas numërimit të 1930-ës, më 8 gusht të vitit 1929, organizoi Kongresin e Sunitëve shqiptarë, në të cilin u miratua edhe Statuti i Komunitetit Mysliman Shqiptar.<sup>19</sup>

Shumë interesante është pjesa e ligjit e cila përcaktonte të ardhurat e Komunitetit të cilat përbëheshin nga: të ardhurat nga vakëfet, ndihmat e ndryshme të shtetit, si dhe ndihmat nga besimtarët. Gjithashtu, çdo shtëpi myslimane duhej të paguante një taksë fakultative në arkën e Komunitetit Mysliman. Për ato shtëpi që nuk paguanin taksën, Kryemyftiu, Myftiu, ose Nënmyftiu kishte të drejtë të ndalonte pjesëmarrjen në ceremonitë fetare. Sipas statutit nuk mund të pranoheshin dhurata ose subvencione nga shtete të huaja, vetëm me pëlqimin e qeverisë.

Sipas statutit, në rast inspektimi nga shteti, zyrat e komunitetit mysliman detyroheshin të tregonin gjithë llogaritë e tyre financiare. Në rast se konstatohej ndonjë abuzim financiar, veprohej sipas dispozitave të Kodit Penal.<sup>20</sup>

Edhe komunitetet e tjera fetare, në përputhje me ligjin për komunitetet fetare, miratuan statutet e tyre. Në Kongresin Ortodoks të Korçës, të vitit 1929, Kisha Ortodokse Shqiptare miratoi statutin e saj,<sup>21</sup> ndërkohë që bektashinjtë miratuan rregulloren e tyre më 26 shkurt 1930.<sup>22</sup> Vështirësitë më të mëdha u hasën në marrëdhëniet e Mbretit Zog me komunitetin katolik, sidomos pas aprovimit të ligjit të komuniteteve fetare të 1929-ës si dhe ligjit për mbylljen e shkollave të huaja dhe shtetëzimin e tyre, ndër to edhe shkollat katolike.<sup>23</sup>

Ligji për komunitetet fetare përcaktonte, gjithashtu, se: *“buxhetet dhe rregulloret e komuniteteve nuk mund të hyjnë në fuqi pa u aprovuar nga Ministria e Drejtësisë, e cila në çdo rast ka të drejtë të kontrollojë gjendjen e të ardhurave e të pasurive që zotërojnë komunitetet fetare, me anën e një*

<sup>19</sup> “Statuti i Komunitetit Mysliman Shqiptar”, Fletorja Zyrtare, nr. 53, 24 shtator 1929.

<sup>20</sup> “Statuti i Komunitetit Mysliman Shqiptar”, nenit 64.

<sup>21</sup> Fletorja Zyrtare, nr. 45, 14 gusht 1929.

<sup>22</sup> Fletorja Zyrtare, nr. 5, 26 gusht 1930.

<sup>23</sup> Historia e popullit shqiptar, vep. e përmendur, f. 302.

*inspektori ose prokurori të Shtetit, si dhe t'u kërkojë llogari dhe të hetojë edhe mënyrën e shpenzimeve të realizuara*".<sup>24</sup>

Ndërkohë që komunitetet fetare e kishin të ndaluar që të pranonin ndihma prej shteteve të huaja, me përjashtim të rasteve të miratuara prej qeverisë, kur këto ndihma kishin për qëllim vepra filantropike. Këtu përfshiheshin edhe ndihmat që mund të ofronin shtetasit e huaj.<sup>25</sup>

Dispozitat e këtij ligji parashikonin, gjithashtu, se në rastet kur donacionet ofroheshin prej qytetarëve shqiptarë, dhe kur donacioni i ofruar e kalonte shumë prej 1000 franga ari, duhet të merrej miratimi i Qeverisë, në përputhje me nenin 562 të Kodit Civil.<sup>26</sup>

Së fundi, ligji parashikonte edhe mënyrën e regjistrimit të një pasurie të paluajtshme apo të luajtshme në favor të një komuniteti fetar, sipas disa procedurave të përcaktuara. Në çdo rast, regjistrimi i tyre në zyrat e hipotekës bëhej vetëm pas daljes së dekretit mbretëror përkatës.<sup>27</sup>

### ***1.1.3 E drejta Socialiste 1944-1990***

Teoricieni dhe politikani sovjetik Nikollaj Bukarin shkruante në librin e tij më të njohur ABC e komunizmit, se: "*feja dhe komunizmi janë të papërrputhshme si në teori ashtu edhe në praktikë*".<sup>28</sup> Në vijimësi të këtij mendimi, që ndodhet në burim të mendimit marksist ndaj fesë, do të shtresëzohet praktika leniniste, që do të kërkonte çrënjosjen e fesë nga shoqëria dhe ndërgjegjia njerëzore.

Studiuesi i njohur Joseph Bochenski theksonte në mesin e viteve '70 *se politika fetare në vendet socialiste, pavarësisht të gjithave, varej kaq shumë nga teoria saqë kjo e fundit nuk mund të anashkalohej në studimin e politikave fetare të këtyre shteteve*".<sup>29</sup> Kështu feja do të shihej në vendet

<sup>24</sup> "Dekret-Ligjë mbi formimin e Komuniteteve Fetare", neni 9.

<sup>25</sup> "Dekret-Ligjë mbi formimin e Komuniteteve Fetare", neni 17.

<sup>26</sup> "Dekret-Ligjë mbi formimin e Komuniteteve Fetare", neni 20.

<sup>27</sup> "Dekret-Ligjë mbi formimin e Komuniteteve Fetare", neni 11.

<sup>28</sup> Nikolai Bukharin & Evgeny Preobrazhenski, *The ABC of Communism*, (Ann Arbor: Michigan University Press, 1966), 247.

<sup>29</sup> Joseph M. Bochenski, "Marxism-Leninism and Religion," në bot. Bohdan R. Bociurkiw & John W. Strong, *Religion and Atheism in the USSR and Eastern Europe*, (London: MacMillan, 1975), 1.

e bllokut sovjetik, përfshirë këtu edhe Shqipërinë, si një armik ideologjik dhe politik.

Më 14 mars 1946, Asambleja Kushtetuese e Shqipërisë miratoi Kushtetutën e cila ishte një dokument hibrid, me përbërës ligjorë dhe konstitucionalë të traditës së mëparshme juridike shqiptare dhe asaj borgjeze e po ashtu, edhe të asaj sovjetike. Kështu në nenin 9 të saj, ndërsa shpallej se pronat dhe nismat private mbroheshin, këtyre u viheshin kufij të rëndësishëm si në përmasa, ashtu edhe në sektorët ku ajo mund të shtrihej.<sup>30</sup>

Përsa u takon çështjeve fetare, në nenin 13 nënvizohej barazia e shtetasve pa dallim feje, race apo kombësie dhe deklaroheshin ndëshkimi i çdo lloj diskriminimi me bazë fetare, racore, kombëtare.<sup>31</sup> Në nenin 16 të Kushtetutës shpallej ndarja e shtetit nga kisha. Ndalohej angazhim i klerikëve në politikë, si dhe përdorimi i fesë për qëllime politike. Liria e besimit dhe ushtrimi i detyrave nga komunitetet fetare mbrohej me ligj. Ky nen mbyllej me fjalinë “*Shteti mund të ndihmojë materialisht komunitetet fetare*”.<sup>32</sup> Në këtë mënyrë, Kushtetuta e linte të hapur si mundësinë e ndihmës ashtu edhe mosdhënien e saj pa përcaktuar ndonjë kriter për komunitetet fetare.

Përsa i takon fushës së politikave fetare, dalja e Kushtetutës nuk u shoqërua me nxjerrjen e dispozitave ligjore. Marrëdhëniet midis pushtetit politik dhe komuniteteve fetare vazhduan të rregulloheshin edhe për disa vjet në përputhje me ligjin fetar të vitit 1929 të Zogut. Kjo vazhdimësi, shfaqet në faktin se marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe komuniteteve fetare rregulloheshin, njëlloj si edhe më parë, nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë. Kjo varësi institucionale në raportet me shtetin do të ruhej deri në fund të vitit 1949.<sup>33</sup> Ishte kjo e fundit ajo që miratonte emërimin e hierarkëve të lartë fetarë, dhe madje bënte edhe emërimet.

Nga pikëpamja institucionale, edhe pse Komiteti për Çështjet e Kultit, i formuar në vitin 1929, u suprimua pas ardhjes së komunistëve në pushtet, Ministria e Drejtësisë vazhdoi të ishte nyja lidhëse ndërmjet komunitetit të kultit dhe shtetit.

<sup>30</sup> AQSh, F. Kryeministria, nr. 490, viti 1946, d. 51, fl. 5.

<sup>31</sup> AQSh, F. Kryeministria, nr. 490, viti 1946, d. 51 fl. 6.

<sup>32</sup> AQSh, F. Kryeministria, nr. 490, viti 1946, d. 51, fl. 7.

<sup>33</sup> AMPB, Dega 1, viti 1953, d. 49, fl. 39.



Goditja e shtetit ndaj komuniteteve fetare kishte nisur qysh në gjysmën e dytë të vitit 1945. Goditja e parë u krye që më 29 gusht të vitit 1945 kur u shpall, nga kryesia e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar, ligji për reformën agrare. Sipas këtij ligji shpronësoheshin familjet e mëdha latifondiste, komunitetet fetare dhe çifligjet e shtetit, si dhe pronarët që kishin përfituar nga reforma e Zogut e vitit 1936. Nga kjo reformë prekeshin arat bujqësore, ullishtet, pemishtet, vreshtat, godinat bujqësore dhe veglat bujqësore të kësaj kategorie.<sup>34</sup> Megjithatë, kjo reformë u zbatua në dy shkallë, faza e dytë e së cilës preku rëndë edhe pronat e institucioneve fetare.

Në fund të saj, ato u reduktuan në vetëm 1/4 e sipërfaqes së vitit 1944. Nga faza e parë e reformës agrare, komuniteteve fetare *nuk u lihej më shumë se 20 hektarë tokë*.<sup>35</sup> Në fazën e dytë, sipas së cilës nuk lejohej më shumë se 5 hektarë për kryefamiljar, *u shpronësuan më tej edhe 480 prona fetare*.<sup>36</sup>

Pas kësaj faze pronat tokësore të komuniteteve fetare nuk mund të tejkalonin 5 hektarë sipërfaqe me përjashtim të manastireve, që mund të zotëronin deri në 20 hektarë, çka vlente edhe për administratën klerikale deri në rang nënprefekturë.<sup>37</sup> Kështu, nga rreth 4.225 hektarë toka që të gjitha komunitetet fetare kishin përpara reformës agrare, në përfundim të saj atyre u ishin shpronësuar 3.163 hektarë tokë.<sup>38</sup>

Ajo që u mbeti këtyre komuniteteve përllogaritej të ishin përafërsisht 1.062 hektarë. Nga 70.000 mijë rrënjë ullinj që kishin para reformës, në fund të saj përfunduan diku me rreth 9.000 rrënjë pasi iu shpronësuan rreth 61 mijë rrënjë ullinj.<sup>39</sup> Veç kësaj, atyre iu shpronësuan edhe 40 hektarë vreshta. Për të kuptuar se çfarë peshe zinin pronat e komuniteteve fetare në sasinë e përgjithshme të tokave të shpronësuar gjatë reformës, mjafton të përmendim faktin se sipërfaqja e përgjithshme e vakëfeve në raport me sipërfaqen e përgjithshme të tokës së punuar ishte 393.355 hektarë përballë 4.225 hektarëve, rreth 1.1% e sipërfaqes së përgjithshme të tokës.

---

<sup>34</sup> Kastriot Dervishi, *Historia*, 578.

<sup>35</sup> *Historia e Shqipërisë*, 39.

<sup>36</sup> *Historia e Shqipërisë*, 66–67.

<sup>37</sup> *Cimbalo, Pluralismo*, 84.

<sup>38</sup> *Fishta & Toçi, Ekonomia*, 218.

<sup>39</sup> *Fishta & Toçi, Ekonomia*, 218.

Përsa i takon raportit ndërmjet sipërfaqes së përgjithshme të tokave të shpronësuara, që ishte 288.400 hektarë dhe pronave tokësore të institucioneve fetare të shpronësuara, del se vakëfet zinin 2% të sasisë së përgjithshme të sipërfaqeve të shpronësuara prej reformës. Në përfundim raporti i sipërfaqes së përgjithshme të tokës dhe sipërfaqes së vakëfeve të mbetura pas reformës, është afërsisht 0.3%.

Kjo sasi tokash që zotërohej nga të gjitha komunitetet, qëndronte shumë më poshtë se sasia e pronave të familjeve Vlora dhe Vriani dhe mbi të gjitha, ato nuk përvetësoheshin nga një numër i ngushtë individësh, por i shërbenin funksionimit të institucioneve ku ishin të punësuar me qindra njerëz. Pronat e komuniteteve fetare ishin të pamjaftueshme për t'i plotësuar nevojat dhe buxhetet vjetore të tyre që përpara kryerjes së reformës. Që nga krijimi i shtetit shqiptar dhe deri në fund këto komunitete kishin nevojë për mbështetjen financiare të tij. Madje, të ardhurat e tyre nga pronat, ishin kaq të ulëta sa që financimet shtetërore ishin jetike për komunitetet fetare.

Megjithëse është pretenduar se reforma i zhveshi komunitetet fetare nga një pjesë e mirë e të ardhurave të tyre,<sup>40</sup> fakt është se edhe pa shpronësimet, komunitetet fetare ishin të varura nga subvencionet e dhëna nga shteti. Subvencionet nga jashtë nuk mund të pranoheshin prej cilitdo institucion kulti dhe një gjë e tillë ishte e përcaktuar qysh në ligjin fetar të Zogut të vitit 1929, ligj i cili vazhdonte të ishte në fuqi. Neni 20 i këtij ligji i ndalonte komunitetet fetare të pranonin ndihma nga jashtë pa miratimin e shtetit.<sup>41</sup>

Më 26 nëntor 1949, hyri në fuqi dekret-ligji për komunitetet fetare. Nga ligji kërkohej besnikëria e plotë e klerit ndaj shtetit dhe udhëheqësve të tij, në të kundërt ligji i jepte gjithë fuqinë shtetit të merrte masa si ndaj klerikëve të veçantë ashtu edhe ndaj komuniteteve fetare en bloc.<sup>42</sup> Ndërkaq në ligjin e ri, ndryshe nga ligji i mëparshëm, parashikohej edhe dhënia e subvencioneve për komunitetet fetare, vetëm se një gjë e tillë ishte

<sup>40</sup> Nicholas Pano, "The Albanian Orthodox Church," në Leustean, Eastern, 145.

<sup>41</sup> Dekret-Ligjë mbi formimin e Komuniteteve Fetare," Fletorja Zyrtare, 1 shkurt 1930, 1.

<sup>42</sup> AQSh, F. PPSH, nr. 14, viti 1949, d. 65, fl. 12.

fakultative.<sup>43</sup> Kjo pikë e ligjit ishte në përputhje me nenin 16 të Kushtetutës, sipas të cilit “*Shteti mund të ndihmojë materialisht komunitetet fetare*”.<sup>44</sup> Pra shteti nëse nuk i nxirrte jashtë ligjit komunitetet fetare, mund t’i linte ato pa asnjë të ardhur duke i çuar në falimentim.

Në datë 10 prill të vitit 1963, u bë ndryshimi i ligjit të vitit 1949 “Mbi komunitetet fetare”, i justifikuar ky me faktin se disa prej dispozitave të tij të fundit u kishte kaluar koha.<sup>45</sup> Ndryshimet e fundit ligjore jo vetëm që rritën jashtë mase aftësinë e shtetit për të ndërhyrë në jetën e komuniteteve fetare, por edhe synuan shkurtimin e organikës klerikale dhe censurimin e predikimeve fetare.

Ndryshimet ligjore të vitit 1963, të para tanimë nga një prizëm post facto, paralajmëruan për fillimin e fundit të jetës së komuniteteve fetare. Këto ndryshime ligjore u përdorën si një fasadë nga regjimi komunist për të kryer një hap të tillë. Megjithëse në vitin 1963 shteti regjistroi pasuritë e paluajtshme të komuniteteve fetare, në vitin 1964, Komuniteti i Kulteve propozoi konfiskimin nga shteti të pjesës më të madhe të pronave të komuniteteve fetare, përfshirë këtu edhe tokat që shërbenin për varreza, me pretendimin që ky shërbim (varrimi), administrohej prej shtetit.<sup>46</sup> Në këtë mënyrë jo vetëm që pushteti u mori komuniteteve fetare edhe ato pak prona që u kishin mbetur, por ndërhyri dhe në çështjet e fesë duke marrë apo transferuar në drejtim të tij administrimin e varrezave, përgjegjësi kjo që i kishte takuar deri atëherë sferës së komuniteteve fetare.

Si përfundim, goditja e bazës ekonomike të komuniteteve fetare nëpërmjet shpronësimit, ishte mjaft e rëndë, pasi i ndërpreu atyre vetëfinancimin për të mbajtur në këmbë strukturën organizative, përpos pamundësisë së komuniteteve për të marrë ndihma financiare nga jashtë. Shteti nëpërmjet këtyre masave synoi vendosjen e komuniteteve fetare nën varësinë e financimeve shtetërore, të cilat do të tkurrëshin ngadalë deri në mbylljen e tyre në vitin 1967.<sup>47</sup>

<sup>43</sup> AQSh, F. PPSH, nr. 14, viti 1949, d. 65, fl. 12.

<sup>44</sup> AQSh, F. Kryeministria, nr. 490, viti 1946, d. 51, fl. 7.

<sup>45</sup> AQSh, F. Kuvendi Popullor, nr. 489, viti 1963, d. 40, fl. 1.

<sup>46</sup> AQSh, F. Kryeministria, nr. 490, viti 1963, d. 1073, fl. 36.

<sup>47</sup> Dekretet nr.4252 dhe nr.4253, datë 11.04.1967, të Presidiumit të Kuvendit të Shqipërisë “Për shtetëzimin e pasurive të paluajtshme të komuniteteve fetare”.

Nga 2.169 institucione fetare të rrënuara, të mbyllura dhe të shndërruara në objekte për përdorim laik, 1.270 i takonin besimit mysliman (740 xhami dhe 530 teqe, tyrbe, mekame etj.), 608 të besimit ortodoks dhe 157 kisha katolike.

Nga objektet e kultit fetar të besimit ortodoks u ruajtën si “monument kulture” gjithsej 14 objekte, 4 xhami të besimit mysliman, dhe objekte kulturi nga të besimit katolik, vetëm një.

## **1.2 Kuadri ligjor dhe politik mbi të drejtën e pronësisë të komuniteteve fetare në Shqipëri**

Garantimi i të drejtës së pronësisë së komuniteteve fetare ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në respektimin e lirisë në ushtrimin e besimit fetar dhe për këtë arsye, si aktet ndërkombëtare ashtu dhe legjislacioni i brendshëm, i kanë kushtuar rëndësi si në këndvështrimin e garantimit dhe respektimit të të drejtave dhe lirive themelore, ashtu edhe në rregullimin e posaçëm të tyre.

Për të vlerësuar rëndësinë e kuadrit ndërkombëtar të poshtëshënuar duhet të mbahet në konsideratë roli i të drejtës ndërkombëtare dhe raporti i saj me të drejtën e brendshme. Ky raport, hierarkia, statusi dhe efekti i normave ligjore rregullohet nga vetë Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.<sup>48</sup> Bazuar në Kushtetutë, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara zënë një vend të rëndësishëm në rendin ligjor duke u radhitur në hierarkinë e normave menjëherë pas Kushtetutës, duke pasur në këtë mënyrë epërsi mbi ligjet e brendshme që nuk pajtohen me to.

Analiza e kuadrit ligjor dhe politik do të pasqyrojë se si të drejtat dhe liritë themelore që implikohen në çështjen e pronësisë së komuniteteve fetare janë trajtuar nga legjislacioni në fuqi apo edhe nga politikat e Qeverisë shqiptare.

### **1.2.1 Kuadri ligjor ndërkombëtar**

Siç u përmend më lart në Republikën e Shqipërisë e drejta ndërkombëtare gëzon një pozitë të privilegjuar në raport me të drejtën e brendshme.<sup>49</sup>

---

<sup>48</sup> Neni 116, 121-124 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

<sup>49</sup> Bazuar në Kushtetutë, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara zënë një vend të rëndësishëm në rendin ligjor duke u radhitur në hierarkinë e normave menjëherë pas Kushtetutës e duke pasur në këtë mënyrë epërsi mbi ligjet e brendshme që nuk pajtohen me to.

Mbi këtë bazë, konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të cilat garantojnë ushtrimin e të drejtave, pa asnjë diskriminim në bazë të kombësisë, prejardhjes etnike ose sociale, gjinisë, racës, ngjyrës, gjuhës, fesë, besimit, opinionit publik ose çdo opinion tjetër, pasurisë, lindjes, paaftësisë, moshës ose ndonjë instrument tjetër, ku Republika e Shqipërisë ka aderuar apo ratifikuar, janë pjesë e legjislacionit të brendshëm.

Në themel të instrumenteve kryesorë ndërkombëtarë që kanë objekt mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut është Karta e Kombeve të Bashkuara.<sup>50</sup> Që në hyrje të saj Karta e Kombeve të Bashkuara shpall se shtetet anëtare shprehin vendosmërinë për të forcuar besimin e tyre në të drejtat themelore të njeriut.

Një ndër qëllimet kryesore të Kombeve të Bashkuara është *nxitja e bashkëpunimit ndërkombëtar ... për të mbështetur dhe forcuar respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut për të gjithë, pa dallim race, seksi, gjuhe apo besimi fetar*.<sup>51</sup> Duke iu referuar Kartës, Asambleja e Përgjithshme ngarkohet për të iniciuar procese hetimore dhe për të dhënë rekomandime, ndër të tjera *për të mbështetur bashkëpunimin ndërkombëtar në fushat e ekonomisë, sistemit social, kulturës, edukimit dhe shëndetësisë si dhe për të kontribuar në realizimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të tij pa dallim race, gjinie, gjuhe apo besimi fetar*.<sup>52</sup>

Instrumenti i parë që Asambleja e Kombeve të Bashkuara miratoi në fushën e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut ishte Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut.<sup>53</sup> Pavarësisht se ishte një instrument me karakter politik dhe jo juridik, Deklarata Universale listoi për herë të parë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, përfshirë këtu edhe të drejtat lidhur me gëzimin e pronësisë/pasurisë dhe të lirisë së besimit.

Deklarata në nenin 17 të saj parashikon se *“Gjithkush ka të drejtën të ketë pasuri, si vetëm ashtu edhe në komunitet me të tjerët. Asnjëri nuk duhet të privohet arbitrarisht nga pasuria e tij.”* Në vijim neni 18 parashikon:

---

<sup>50</sup> Shqipëria u bë anëtare e Kombeve të Bashkuara në vitin 1955.

<sup>51</sup> Neni 1 i Kartës.

<sup>52</sup> Neni 13 i Kartës.

<sup>53</sup> U miratua nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 10 dhjetor 1948.

*“Gjithkush ka të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe besimit; kjo e drejtë përfshin lirinë e ndryshimit të besimit ose bindjeve dhe lirinë që njeriu, qoftë vetë ose në komunitet me të tjerët, të shfaqë publikisht ose privatisht, besimin ose bindjen e vet me anë të dhënies së mësimeve, kryerjes së kultit dhe ceremonive fetare.”*

Një instrument juridik ndërkombëtar shumë i rëndësishëm në fushën e të drejtave të njeriut është Pakti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Civile dhe Politike.<sup>54</sup> Ky është një ndër instrumentet e para juridike ndërkombëtare ku Shqipëria u bë palë pas fillimit të proceseve demokratike.<sup>55</sup> Pakti përmban disa dispozita që kanë të bëjnë me lirinë e ushtrimit të besimit fetar dhe të drejtën e pronës, si dhe me detyrimin e shteteve palë për të marrë masa efektive për garantimin e këtyre lirive dhe të drejtave.

Neni 18 i këtij Pakti sanksionon të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë. Kjo e drejtë përfshin lirinë për të pasur ose për të adoptuar një fe ose një besim prej tij, si dhe lirinë për të manifestuar fenë apo besimin e vet, qoftë individualisht apo së bashku me të tjerët, si publikisht ashtu edhe privatisht, nëpërmjet kultit dhe kryerjes së riteve, praktikave dhe arsimit. Shteti duhet të garantojë ushtrimin e këtyre të drejtave pa asnjë lloj diskriminimi dhe në barazi të plotë.

Të njëjtat garanci ofrohen dhe nga Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial<sup>56</sup> e vitit 1969, ku Shqipëria u bë palë në vitin 1994. Shteti shqiptar raporton rregullisht para mekanizmit ndërkombëtar të ngritur për monitorimin e zbatimit të saj.

Si anëtare e Këshillit të Europës, Shqipëria është bërë palë në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe protokollat shtesë.<sup>57</sup> Ky instrument paraqet një rëndësi shumë të madhe në drejtim të mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të njeriut në Shqipëri në disa aspekte. Kushtetuta shqiptare i referohet drejtpërdrejtë kësaj konvente dhe parashikon se *kufizimet e të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë nuk mund të çënojnë*

<sup>54</sup> U hap për nënshkrim më 16 dhjetor 1966 dhe hyri në fuqi më 23 mars 1976.

<sup>55</sup> Shqipëria aderoi më 4 tetor 1991 dhe Pakti hyri në fuqi për të më 4 janar 1992.

<sup>56</sup> Neni 3.

<sup>57</sup> U ratifikua me ligin nr 8137, datë 31.7.1996.

*thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut.<sup>58</sup>*

Konventa parashikon në mënyrë specifike ushtrimin e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë individualisht ose në mënyrë kolektive, publikisht ose privatisht pa asnjë lloj diskriminimi të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.<sup>59</sup>

Përveç sa më sipër, neni 1 i Protokollit Shtesë të Konventës sanksionon mbrojtjen e pronës: *“Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.”* Në këtë kuptim, komunitetet fetare në Shqipëri, si subjekte me personalitet juridik mbrohen posaçërisht nga dispozitat e këtij protokollit.

Në dallim nga konventat e tjera ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut ka krijuar një mekanizëm efektiv që siguron zbatimin e dispozitave të saj nga shtetet palë që është Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut. Numri i çështjeve që ka shqyrtuar ose që janë në pritje shqyrtimi nga Gjykata ku shteti shqiptar është palë e paditur është shumë i madh. Një pjesë të konsiderueshme të këtyre çështjeve e përbëjnë çështjet e kthimit dhe kompensimit të pronave të subjekteve shqiptare. *Deri tani nuk ka asnjë çështje të paraqitur në Gjykatën e Strasburgut me objekt kthimin ose kompensimin e pronave të komuniteteve fetare.*

### **1.2.2 Kuadri ligjor i brendshëm**

Pas rrëzimit të diktaturës komuniste në vitin 1990 Shqipëria hyri në një proces të pakthyeshem demokratizimi të shoqërisë në themel të të cilit ishte mbrojtja dhe respektimi i lirive dhe të drejtave themelore të njeriut. Respektimi dhe mbrojtja nga shteti i lirisë së ushtrimit të besimit fetar dhe së drejtës së pronës private mund të konsiderohen si gurët themelitarë të këtij procesi demokratizues.

---

<sup>58</sup> Neni 17.

<sup>59</sup> Nenet 9 dhe 14.

## i. Kuadri Kushtetues i respektimit dhe mbrojtjes së lirisë së ushtrimit të besimit fetar dhe së drejtës së pronës

### *Ligji për dispozitat kryesore kushtetuese.*<sup>60</sup>

Menjëherë pas rrëzimit të regjimit komunist filloi puna për hartimin e kuadrit të ri kushtetues në Shqipëri bazuar mbi parimet demokratike dhe të shtetit të së drejtës. Në vitin 1991 u miratua nga parlamenti i parë pluralist shqiptar Ligji “Për dispozitat kryesore kushtetuese”. Ky ligj krijoi një kuadër themelor të përkohshëm kushtetues mbi të cilin do të funksiononte shteti demokratik deri në hartimin e kushtetutës së re. Ai sanksionoi për herë të parë se: *“Republika e Shqipërisë është shtet juridik dhe demokratik. Dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, zhvillimi i lirë i personalitetit të tij si dhe rendi kushtetues, barazia para ligjit, drejtësia shoqërore e përkrahja shoqërore dhe pluralizmi janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t’i respektojë e mbrojë ato.*<sup>61</sup>

Një pjesë e dispozitave të këtij ligji sanksionojnë liritë dhe të drejtat themelore të njeriut. Kështu neni 4 sanksiononte se: *“Republika e Shqipërisë njuh dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të pakicave kombëtare, të pranuar në dokumentat ndërkombëtare”.* Kjo dispozitë duhet parë e lidhur ngushtë me nenin 8, pika 1, sipas të cilit: *“Legjislacioni i Republikës së Shqipërisë merr parasysh, njuh dhe respekton parimet dhe normat përgjithësisht të pranuar të së drejtës ndërkombëtare.”*

Në këtë kuptim dispozitat e lartpërmendura iu referoheshin instrumenteve juridike dhe politike ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut ku Republika e Shqipërisë ishte bërë ose do të bëhej palë në të ardhmen, sikurse Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, Pakti për të Drejtat Civile dhe Politike, Akti Final i Helsinkit, etj.

Në mënyrë specifike Ligji “Për dispozitat kryesore kushtetuese” i referohej lirisë së besimit fetar. Neni 7 parashikonte se *“Republika e Shqipërisë është shtet laik dhe se shteti respekton lirinë e besimit fetar dhe krijon kushte për ushtrimin e tij”.* Ky formulim ishte shumë i rëndësishëm jo vetëm sepse sanksionoi lirinë e besimit fetar, por e vendosi shtetin para detyrimit për të

<sup>60</sup> Ligji nr. 7491, datë 29.4.1991.

<sup>61</sup> Neni 2 i Ligjit “Për dispozitat kryesore kushtetuese”.



krijuar të gjitha kushtet për ushtrimin e kësaj lirie në mënyrë individuale ose kolektive. Pjesë e këtij detyrimi ishte marrja e masave të nevojshme ligjore dhe ekzekutive që komunitetet fetare të rifitonin të drejtën për të pasur dhe gëzuar në pronësi objektet e kultit ku praktikohet besimi fetar.

Në nenin 10 të saj përcaktohej se: *“Ekonomia e vendit bazohet në shumëllojshmërinë e pronave, iniciativën e lirë të të gjitha subjekteve ekonomike në rolin rregullues të shtetit....”*, ndërkohë që në nenin 11 theksohej se *“Subjekte të së drejtës së pronësisë janë shteti, personat juridikë dhe fizikë. Të gjitha llojet e pronësisë gëzojnë mbrojtje të barabartë me ligj.....”*. Paralelisht me garantimin e lirisë fetare dhe tërësisë së elementëve përbërës të saj, Ligji “Për dispozitat kryesore kushtetuese” garantoj dhe të drejtën e pronës private të personave juridikë ku nënkuptohen dhe komunitetet fetare.

Gjatë kësaj periudhe, u ngrit Sekretariati Shtetëror për Fenë,<sup>62</sup> duke pasur si objekt të punës së tij marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe komuniteteve fetare, plotësimin e kuadrit ligjor mbi marrëdhëniet e shtetit me fenë, si dhe ruajtjen dhe zhvillimin e harmonisë ndërfitare në vend. Ringritja shpirtërore dhe infrastrukturore (objektet e kultit, sistemi arsimor etj) u bë e mundur si rrjedhojë e mbështetjes së vazhdueshme të shumë shteteve dhe organizatave të huaja, pasi komunitetet fetare nuk e kishin mundësinë financiare për të ringritur nga themelet të gjithë infrastrukturën e nevojshme për të mundësuar ushtrimin e besimit fetar, ndërkohë që edhe shteti shqiptar nuk e kishte mundësinë për të asistuar në këtë drejtim.

Ligji “Për dispozitat kryesore kushtetuese” i shtriu efektet e tij deri në hyrjen në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.<sup>63</sup> Ai shërbeu si bazë për miratimin e ligjeve të rëndësishme në fushën e mbrojtjes dhe respektimit të lirisë dhe të drejtave themelore të njeriut apo edhe për bërjen palë të Republikës së Shqipërisë në një numër të madh konventash ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut.

<sup>62</sup> U krijua në vitin 1992, ndërkohë që me miratimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM Nr. 459, datë 23.09.1999), emërtohet Komiteti Shtetëror për Kultet, pranë Këshillit të Ministrave. Për disa vjet kjo strukturë ishte në varësi të Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë dhe me vendimin nr. 602, datë 19.9.2014 kaloi në varësi të Kryeministrit.

<sup>63</sup> Miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 të Kuvendit Popullor. Miratuar me referendum më 22.11.1998.

### ***Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë***

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, si akti themeltar i shtetit shqiptar, përmban një numër dispozitash të cilat shërbejnë si referencë për lirinë e ushtrimit të besimit fetar në përgjithësi dhe të drejtën e pronësisë së komuniteteve fetare, në veçanti. Që në hyrje të saj Kushtetuta shpall vendosmërinë e popullit shqiptar *“për të ndërtuar një shtet të së drejtës, demokratik e social, për të garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, me frymën e tolerancës dhe të bashkëjetesës fetare”*.

Në nenin 3 sanksionohet, ndër të tjera se: *“...dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, ... bashkëjetesa fetare, si dhe bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t’i respektojë dhe t’i mbrojë”*. Nga kjo pikëpamje shteti shqiptar ka detyrimin pozitiv për të marrë të gjitha masat e nevojshme për t’i krijuar mundësitë qytetarëve për lirinë e ushtrimit të besimit fetar individualisht ose kolektivisht.

Kushtetuta i referohet në mënyrë të posaçme marrëdhënieve të shtetit me fenë, komunitetet fetare dhe statusit ligjor të tyre, si dhe garanton asnjëanësinë në çështjet e besimit. Neni 10 parashikon si më poshtë:

- 1. Në Republikën e Shqipërisë nuk ka fe zyrtare.*
- 2. Shteti është asnjëanës në çështjet e besimit e të ndërgjegjes dhe garanton lirinë e shprehjes së tyre në jetën publike.*
- 3. Shteti njeh barazinë e komuniteteve fetare.*
- 4. Shteti dhe komunitetet fetare respektojnë në mënyrë të ndërsjellë pavarësinë e njëri-tjetrit dhe bashkëpunojnë në të mirë të secilit dhe të të gjithëve.*
- 5. Marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe komuniteteve fetare rregullohen mbi bazën e marrëveshjeve të lidhura ndërmjet përfaqësuesve të tyre dhe Këshillit të Ministrave. Këto marrëveshje ratifikohen në Kuvend.*
- 6. Komunitetet fetare janë persona juridikë. Ato kanë pavarësi në administrimin e pasurive të tyre sipas parimeve, rregullave dhe kanuneve të tyre, për sa nuk cënohen interesat e të tretëve.*

Pikat 5 dhe 6 të këtij neni lidhen në mënyrë më specifike me çështjet pronësore të komuniteteve fetare në Shqipëri. Ndërmjet qeverisë shqiptare dhe komuniteteve fetare kryesore janë lidhur marrëveshje të posaçme që

rregullojnë marrëdhëniet e ndërsjellta përfshirë çështjen e rikthimit të pronave të komuniteteve fetare. Gjithashtu, komuniteteve fetare u njihet personaliteti juridik dhe u garantohen të gjitha të drejtat pronësore në mënyrë të papenguar nga cilido subjekt, përfshirë këtu edhe shtetin, me përjashtim të rasteve kur cënohen palët e treta.

Pjesa e dytë e Kushtetutës i kushtohet të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Në nenin 15 sanksionohet se: *“Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik. Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.”* Formulimi i këtij neni, pavarësisht se është i përgjithshëm, nënkupton se shteti (organet e pushtetit publik) duhet të marrë të gjitha masat për ushtrimin efektiv të të drejtave dhe lirive themelore përfshirë lirinë e ushtrimit të besimit fetar në institucionet e komuniteteve fetare.

Kushtetuta garanton lirinë e ndërgjegjes dhe fesë.<sup>64</sup> Neni 24 përcakton se: *“secili është i lirë të zgjedhë ose të ndryshojë fenë ose bindjet, si dhe t'i shfaqë ato individualisht ose kolektivisht, në publik ose në jetën private, nëpërmjet kultit, arsimimit, praktikave ose kryerjes së riteve. Askush nuk mund të detyrohet ose të ndalohet të marrë pjesë në një komunitet fetar ose në praktikat e saj, si dhe të bëjë publike bindjet ose besimin e tij”*.

E drejta e pronësisë e komuniteteve fetare është e lidhur ngushtësisht me dispozitat kushtetuese që garantojnë të drejtën e pronës private e cila mund të fitohet sipas të gjitha formave të parashikuara nga Kodi Civil shqiptar.<sup>65</sup> Ligji mund të parashikojë shpronësime ose kufizime në ushtrimin e së drejtës së pronës vetëm për interesa publikë. Shpronësimet ose ato kufizime të së drejtës së pronës që barazohen me shpronësimin, lejohen vetëm përkundrejt një shpërblimi të drejtë.

Vlen të theksohet, gjithashtu, se Kushtetuta shqiptare krijon garancitë e nevojshme për ndalimin e diskriminimit për shkak të përkatësisë së individit në një komunitet fetar apo besimit që ai praktikon.<sup>66</sup> Këto garanci

---

<sup>64</sup> Neni 24 i Kushtetutës.

<sup>65</sup> Neni 42

<sup>66</sup> Neni 18.

i ofrohen dhe personave që i përkasin pakicave kombëtare: “*Ata kanë të drejtë të shprehin lirisht, pa u ndaluar as detyruar, përkatësinë e tyre etnike, kulturore, fetare e gjuhësore.*”<sup>67</sup>

## ii. **Kuadri ligjor që garanton të drejtën e pronës**

Fryma e Kushtetutës, në kuptimin e rregullimit të përmbajtjes së pronës private dhe rivendosjes së të drejtës të saj shkelur në vite, respekton barazinë para ligjit, shpalosjen e lirë të personalitetit të pronarëve legjitim dhe shtetin e së drejtës. Nga gjithë kompleksiteti i kësaj të drejte/ajo e kthimit apo kompensimit të saj tek të shpronësuarit nga sistemi i kaluar, mbetet ana më e ndjeshme e saj.

Karakterit dhe përmbajtja e së drejtës së pronësisë në kuptimin juridiko-civil është sanksionuar dhe në Kodin Civil<sup>68</sup> të Republikës së Shqipërisë, sipas të cilit “...*Pronësia është e drejta për të gëzuar dhe disponuar lirisht sendet, brenda kufijve të caktuar nga ligji...*”<sup>69</sup> Pronësia është e drejtë subjektive me karakter pasuror, absolut, real, të qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm. Objekt i së drejtës së pronësisë janë sendet. Titullari i së drejtës së pronësisë ka si të detyruar një numër të pakufizuar personash dhe e realizon të drejtën e tij pa ndërmjetësinë e personave të tjerë dhe ka të drejtë të kërkojë sendin nga çdo posedues apo mbajtës i paligjshëm, qoftë ai dhe me mirëbesim.<sup>70</sup>

Ndërhyrjet dhe ndryshimet në legjislacionin përkatës, prej vitit 1991 e në vazhdim, kanë sjellë miratimin e një numri aktesh ligjore dhe nënligjore, për zbatimin e të cilave janë ngritur edhe institucionet dhe instrumentet përkatëse, detyrë funksionale e të cilave mbetet kthimi apo kompensimi i pronës ndaj pronarëve të ligjshëm, zgjidhja e konflikteve administrative brenda juridiksionit të ushtrimit të kompetencave të tyre.

Në funksion të dispozitave kushtetuese dhe të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, janë miratuar një sërë aktesh ligjore dhe nënligjore në të cilat parashikohen të drejtat dhe detyrimet e organit të caktuar me ligj, për njohjen, kthimin apo kompesimin e pronës, privatizimin, kalimin në

<sup>67</sup> Neni 20.

<sup>68</sup> Miratuar me ligjin nr.7850, datë 29.7.1994, i ndryshuar.

<sup>69</sup> Neni 149.

<sup>70</sup> Po aty.

pronësi, shitblerjen e pasurive të paluajtshme, etj. Lista e këtyre akteve është paraqitur në Aneksin e bashkëlidhur të këtij studimi.

Të drejtat e pronësisë në Shqipëri me rastin e ndryshimit të rendit në vitet 1990, kanë qenë në qendër të reformave të ndërmarra prej qeverive, duke iu nënshtruar një procesi dinamik përse i përket ndryshimeve legislative dhe tyre institucionale.

Edhe pse ekziston një numër i konsiderueshëm dokumentesh strategjike, që përmendin në mënyrë të fragmentuar çështjet e pronësisë, në VKM Nr.405, datë 27.06.2012, *”Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale “Reforma në fushën e të drejtave të pronësisë, 2012-2020” dhe të planit të saj të veprimit”*, evidentohen se në to nuk është dhënë zgjidhje shteruese dhe gjithëpërfshirëse e kësaj të drejte. Në këtë Strategji nuk është trajtuar në mënyrë të posaçme çështja e pronësisë së komuniteteve fetare.

Fakt është që problematika me çështjen e pronave vazhdon të mbetet një pikë kyçe dhe sensitive e politikës dhe reformave shoqërore dhe ekonomike në Shqipëri. Megjithë përpjekjet e vazhdueshme për zgjidhjen e problemit të pronësisë, përfshirë këtu edhe ato që lidhen me komunitetet fetare, rezultatet e deritanishme kanë treguar se ka patur mangësi dhe mungesa të theksuara në hartimin e një baze ligjore të qartë, të konsoliduar dhe efektive, si dhe në zbatimin e duhur të kësaj baze ligjore nga ana e institucioneve përgjegjëse. Për pasojë, gjatë gjithë këtyre viteve që pas rënies së komunizmit e deri më sot, janë krijuar praktika jouniforme ekzekutive dhe gjyqësore në drejtim të procesit të garantimit të të drejtës së pronës. Në këtë situatë, gjykohet se përfshirja e çështjes së pronësisë së komuniteteve fetare si dhe parashikimi i masave konkrete në strategjinë ndërsektoriale të sipërpërmendur, duhet mbajtur në konsideratë gjatë rishikimit të saj.

### **iii. Marrëveshjet ndërmjet Qeverisë shqiptare dhe komuniteteve fetare**

Siç u përmend më lart, Kushtetuta parashikon se marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe komuniteteve fetare rregullohen me marrëveshje të veçanta të cilat marrin vlerën e ligjit duke qenë se ratifikohen nga Kuvendi i Shqipërisë. Marrëveshja e parë e lidhur në zbatim të nenit 10 të Kushtetutës ishte ajo “Ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Selisë së Shenjtë për rregullimin

e marrëdhënieve të ndërsjella”.<sup>71</sup> Kjo ishte marrëveshja e parë mes shtetit shqiptar dhe një komuniteti fetar që i hapi rrugën edhe marrëveshjeve të tjera analoge mes komuniteteve dhe shtetit shqiptar. Duhet theksuar se kjo marrëveshje bazohet dhe në nenin 121 të Kushtetutës duke qenë se është lidhur ndërmjet shtetit shqiptar dhe një shteti, subjekt i së drejtës ndërkombëtare siç është Selia e Shenjtë, pra trajtohet nga e drejta ndërkombëtare.

Vlen të ndalemi këtu në vendin e rëndësishëm që zënë marrëveshjet ndërkombëtare në sistemin ligjor të Republikës së Shqipërisë sipas Kushtetutës shqiptare. Në bazë të nenit 5 të Kushtetutës, Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të.

Pjesa VII e Kushtetutës i kushtohet në mënyrë të posaçme marrëveshjeve ndërkombëtare. Sipas nenit 116/1 *“marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara renditen nga pikëpamja hierarkike e normave menjëherë pas Kushtetutës. Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të”*.<sup>72</sup>

Ndërkohë, neni 121 i Kushtetutës rendit marrëveshjet ndërkombëtare që i nënshtrohen detyrimisht ratifikimit dhe që kanë të bëjnë me:

- a) territorin, paqen, aleancat, çështjet politike dhe ushtarake;
- b) të drejtat dhe liritë e njeriut, si edhe detyrimet e shtetasve, siç parashikohen në Kushtetutë;
- c) anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare;
- ç) marrjen përsipër të detyrimeve financiare nga Republika e Shqipërisë;
- d) miratimin, ndryshimin, plotësimin ose shfuqizimin e ligjeve.

<sup>71</sup> Ratifikuar me Ligjin nr. 8902, datë, 23.5.2002.

<sup>72</sup> Neni 122 i Kushtetutës.

Sa më sipër, duke qenë se marrëveshja me Selinë e Shenjtë ka të bëjë me të drejtat dhe liritë e njeriut dhe ka efekte financiare për shtetin shqiptar, ajo i është nënshtruar ratifikimit nga Kuvendi. Në bazë të kësaj marrëveshjeje shteti shqiptar njeh personalitetin juridik të Kishës Katolike. Ai merr përsipër të kthejë pronat e Kishës Katolike, në përputhje me legjislacionin shqiptar, dhe të asistojë në reregjistrimin e tyre në emër të Kishës Katolike në zyrat kompetente shtetërore.<sup>73</sup> Prej kësaj marrëveshjeje lind detyrimi ligjor i shtetit shqiptar që t'i rikthejë pa asnjë kushtëzim të gjitha pronat e kishës katolike të shtetëzuara gjatë periudhës së sistemit komunist dhe t'i garantojë komunitetit katolik të gjitha të drejtat pasurore në lidhje me këto prona.

Në vijim të kësaj marrëveshjeje, Kuvendi i Shqipërisë miratoi në vitin 2005 Ligjin “Për procedurat e njohjes së zotësisë juridike të personave juridikë kishtarë të kishës katolike”.<sup>74</sup> Në bazë të marrëveshjes “*personat juridikë kishtarë gëzojnë të gjitha të drejtat dhe përmbushin detyrimet e parashikuara në dispozitat e Kodit Civil dhe në aktet e tjera ligjore në fuqi për të gjithë personat juridikë*”.<sup>75</sup> Pra, ligji i garanton komunitetit katolik në Shqipëri gëzimin e të gjitha të drejtave në fushën e pronësisë njësoj si personat e tjerë fizikë e juridike.

Në vijim, shteti shqiptar lidhi në vitin 2009 marrëveshje për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella me tre komunitete të tjera: Komunitetin Mysliman të Shqipërisë (KMSH),<sup>76</sup> Kishën Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë (KOASH)<sup>77</sup> dhe Kryegjyshatën Botërore Bektashiane (KBB),<sup>78</sup> e më pas në vitin 2011 u lidh marrëveshja me Vëllazërinë Ungjillore të Shqipërisë.<sup>79</sup>

<sup>73</sup> Neni 8 i Marrëveshjes.

<sup>74</sup> Ligji Nr. 9365, datë 31.3.2005.

<sup>75</sup> Neni 4 i Ligjit.

<sup>76</sup> Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Mysliman të Shqipërisë për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella, ratifikuar me Ligjin nr.10 056, datë 22.1.2009.

<sup>77</sup> Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella, ratifikuar me Ligjin nr.10 057, datë 22.1.2009.

<sup>78</sup> Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kryegjyshatës Botërore Bektashiane Shqipërisë për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella”, ratifikuar me Ligjin nr.10 058, datë 22.01.2009.

<sup>79</sup> Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Fetare “Vëllazëria Ungjillore e Shqipërisë” për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella”.

Këto marrëveshje u bazuan në nenin 10 dhe 24 të Kushtetutës dhe morën fuqinë e ligjit pas ratifikimi nga Kuvendi i Shqipërisë.

Qëllimet kryesore të këtyre marrëveshjeve janë:

- *garantimi i realizimit të të drejtave të sanksionuara nga Kushtetuta dhe ligjet në fuqi në lidhje me lirinë e ndërgjegjes dhe të fesë;*
- *njohja dhe garantimi i respektimit të të drejtave të komuniteteve fetare, lidhur me të drejtat dhe detyrimet e besimtarëve, respektimin e riteve dhe praktikave tradicionale, të institucioneve dhe strukturave të tij, si dhe personave juridikë të themeluar prej tij, për të zhvilluar lirisht misionin e tyre fetar, edukativ e bamirës;*
- *njohja dhe garantimi i paprekshmërisë së institucioneve fetare për aq sa veprimtaria e tyre nuk vjen në kundërshtim me ushtrimin e lirisë së ndërgjegjes dhe të fesë, me kushtetutën e ligjet në fuqi;*
- *garantimi i lirisë së individit për të ushtruar besimin fetar, për ta shfaqur atë individualisht ose kolektivisht në institucionet fetare ose jashtë tyre, nëpërmjet kultit, arsimit, praktikave ose kryerjes së riteve përkatëse fetare;*
- *sigurimi i lirisë së individit për të mos u ndaluar dhe as detyruar të bëjë pjesë në komunitetin fetar;*
- *njohja e personalitetit juridik të tyre, etj.*

Këto marrëveshje sanksionojnë të drejtën e pronësisë së komuniteteve fetare ndërkohë që tre marrëveshjet e para vendosin shtetin para detyrimit për kthimin e kompensimin e pronave të tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në të gjitha marrëveshjet përcaktohet se në rastet kur objektet e kultit të komuniteteve fetare nuk gjenden të regjistruara në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave-(sot Agjencia e Trajtimit të Pronës), si institucion përgjegjës për verifikimin, kthimin dhe kompensimin e pronave, merr përsipër detyrimin për ta vërtetuar pronësinë mbi objektin e kultit nëpërmjet dokumenteve të Arkivit Qendror të Shtetit.<sup>80</sup>

Në këto marrëveshje parashikohet, gjithashtu, që objektet e kultit të cilat gëzojnë statusin e Monumentit të Kulturës, t'i kthehen në pronësi komuniteteve fetare dhe të mbrohen e trajtohen nga ligji për trashëgiminë kulturore.

<sup>80</sup> Neni 22 i marrëveshjeve të Qeverisë me komunitetet fetare.



Është interesant fakti që marrëveshjet e lidhura me KOASH dhe me KBB parashikojnë kompesimin e të gjitha pronave, ndërsa marrëveshja me KMSH nuk është shumë e qartë mbi këtë çështje. Nga ana tjetër, marrëveshja me KMSH ka disa elementë që nuk janë parashikuar në dy marrëveshjet e tjera, si më poshtë:

- *Trajtimi me përparësi i kërkesave të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë në lidhje me kthimin dhe kompesimin e pronave;*
- *Kthimi i pronave “me të gjithë përbërësit e tyre”, dhe*
- *Rinjohjen e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë si “trashëgimtar të pasurisë së tij”.*

Në zbatim të marrëveshjeve të lartpërmendura Këshilli i Ministrave ka miratuar disa vendime në lidhje me kthimin dhe kompesimin e pronave për të katër komunitetet fetare. Pavarësisht ekzistencës së këtyre marrëveshjeve, procesi i kthimit dhe kompesimit të pronave të komuniteteve fetare ka hasur mjaft vështirësi.

Në bazë të marrëveshjeve të nënshkuara me katër komunitetet fetare shteti shqiptar angazhohet që të mbështesë financiarisht ose materialisht këto komunitete, duke përcaktuar që “...modalitetet dhe kriteret për sigurimin e kësaj mbështetjeje financiare duhet të përcaktohen me një ligj specifik...”.<sup>81</sup> Mbështetur në detyrimet që burojnë nga këto marrëveshje, me propozim të Qeverisë shqiptare, në maj të vitit 2009, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin “Për financimin nga buxheti i shtetit të komuniteteve fetare, që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave”.<sup>82</sup>

Nga vetë emërtesa e këtij ligji, kuptohet qartë se financimi nga buxheti i shtetit do t’u ofrohet vetëm komuniteteve fetare që kanë lidhur marrëveshje me Këshillin e Ministrave. Në bazë të këtij ligji “Shteti mund të financojë pjesërisht komunitetet fetare për ndërtimin, mirëmbajtjen e objekteve të kultit, si edhe në ringritjen e restaurimin e qendrave të pelegrinazhit e të infrastrukturës së tyre ndihmëse, për objektet që lidhen me turizmin fetar, sipas projekteve, që paraqiten nga komunitetet fetare....”.<sup>83</sup>

<sup>81</sup> Neni 13 i Marrëveshjeve të nënshkuara me Komunitetin Musliman Shqiptar, Kishën Ortodokse Autoqefale dhe Kryegjyshatën Botërore Bektashiane.

<sup>82</sup> Ligji nr.10 140, datë 15.5.2009.

<sup>83</sup> Neni 2.

Dispozitat e këtij ligji parashikojnë angazhimin e shtetit për të financuar komunitetet fetare deri në gjysmën e pagës minimale buxhetore, për punonjës të personelit të administratës,<sup>84</sup> pagat e arsimtarëve të institucioneve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe universitar, që zotërohen drejtpërdrejtë ose përmes organizatave jofitimprurëse, të krijuara e të administruara nga komunitetet fetare.<sup>85</sup>

Gjithashtu, dispozitat e këtij ligji krijojnë edhe mundësitë që shteti, duke mbajtur parasysh rrethanat dhe nevojat konkrete, t'i japë objekte ose ndërtesa, në përdorim ose me qira, një komuniteti fetar, për plotësimin e nevojave në fushën e arsimit.<sup>86</sup>

Ky ligj parashikon edhe lehtësira financiare që lidhen me legalizimin e objekteve të kultit, të institucioneve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe universitar, objekteve me destinacion për shërbime sociale a shëndetësore. Më konkretisht, komunitetet fetare përjashtohen nga pagesat, që rrjedhin nga zbatimi i ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar.<sup>87</sup>

Ligji ngarkon Këshillin e Ministrave që të përcaktojë fondet për mbështetjen financiare dhe shpërndarja e këtyre fondeve shtetërore, sipas nevojave dhe kërkesave të secilit komunitet fetar, në bazë të propozimit të bërë nga ministri përgjegjës për kultet.<sup>88</sup> Në zbatim të këtyre dispozitave, duke nisur që nga buxheti i vitit 2010<sup>89</sup> e në vazhdim, Qeveria shqiptare ka miratuar vendimet përkatëse që lidhen me masën e financimit për komunitetet tradicionale fetare.

---

<sup>84</sup> Neni 3.

<sup>85</sup> Neni 4.

<sup>86</sup> Neni 4.

<sup>87</sup> Neni 12 i ligjit “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar .

<sup>88</sup> Neni 6 i ligjit “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar .

<sup>89</sup> VKM nr.278, datë 28.04.2010.

Nga këto vendime konstatohet se masa e financimit ka ardhur relativisht në rritje,<sup>90</sup> dhe se KMSH ka përfitur më shumë nga fondet e financimit krahasuar me komunitetet e tjera fetare për të cilat masa e financimit është pak a shumë në të njëjtat nivele. Kjo dhe për arsye se KMSH është komuniteti fetar më i madh në vend.

### 1.2.3 KUADRI POLITIK

#### i. Strategjitë

Në programin politik të qeverisë shqiptare, për periudhën 2013-2017,<sup>91</sup> një vëmendje e veçantë i kushtohet çështjes së respektimit të pronës private në Shqipëri. Në këtë program konstatohet se “mekanizmat që garantojnë respektimin e pronës publike dhe private në Shqipëri janë sot të bllokuara. Menaxhimi i pronave publike është kaotik, nuk ka strategji që e udhëheq, bëhet pa transparencë dhe është shpesh pre e korrupsionit.”

Qeveria angazhohet t’i vërë këto mekanizma në lëvizje, duke zhbllokuar dhe bërë funksionale katër shtyllat, mbi të cilat do të mbështetet ngrehina pronësore e shtetit:

- a. *Procesi i kthimit-kompensimit të pronave private;*
- b. *Procesi i legalizimeve;*
- c. *Procesi i regjistrimit dhe*
- d. *pronat publike në nivel të qeverisjes qendrore dhe vendore.*

Qeveria angazhohet se do të ndërmarrë një ristrukturim të gjerë të sistemit të menaxhimit të pronës në Shqipëri, për ta kthyer atë në një sistem modern, efikas dhe transparent në përputhje me praktikatat më të mira të vendeve të tjera europiane. Kjo reformë ka nisur me riorganizimin e të gjitha agjencive që merren me administrimin, regjistrimin dhe dokumentimin e pronave.

Në të njëjtën kohë, Qeveria angazhohet se do të rishikojë Strategjinë Ndërsektoriale në fushën e të Drejtave të Pronësisë 2012 – 2020, për të përcaktuar hapat konkretë dhe prioritarë për t’i dhënë fund kaosit në

<sup>90</sup> Që nga buxheti i vitit 2010, masa më e pakët e financimit ka qenë në vitin 2012, në shumën prej 99 milionë e 243 mijë, ndërkohë që masa më e lartë e financimit për komunitetet fetare është buxheti i vitit 2015, në shumën prej 109 milionë lekësh.

<sup>91</sup> [www.akti.gov.al/dokumenta/programi\\_qeverise\\_2013\\_2017.pdf](http://www.akti.gov.al/dokumenta/programi_qeverise_2013_2017.pdf)

administrimin e pronave publike dhe private dhe ngritjen në këmbë të një sistemi sa më të përshtatshëm për mbrojtjen e të drejtës së pronësisë, si një prej të drejtave themelore të individit.

Gjithashtu, qeveria angazhohet të zgjidhë çështjen e pronarëve të vjetër duke:

- a. *i dhënë përparësi kompensimit në natyrë/pra atij fizik, në raport me kompensimin financiar, në mënyrë që të ulet fatura financiare për shtetin;*
- b. *e orientuar procesin e privatizimit të pasurive publike drejt kompensimit të ish-pronarëve;*
- c. *saktësuar fondin e kompensimit për ish-pronarët, i cili do të operojë në mënyrë transparente sipas një skeme të qartë dhe të barabartë për të gjithë të interesuarit; dhe*
- ç. *eliminuar me ligj dhe në praktikë zvarritjet burokratike, si bazë për praktika jo të qarta dhe që mund të çojnë në afëra korruptive lidhur me procesin e kthim-kompensimit të pronave.*

Për të zgjidhur me efektivitet çështjen e kthimit dhe kompensimit të pronave, Qeveria angazhohet të nisë punën me “*kryerjen e një analize të plotë dhe gjithëpërfshirëse të kuadrit normativ në fuqi për kthimin dhe kompensimin e pronave dhe të institucioneve përgjegjëse për zbatimin e tij*”. Kjo analizë synon të identifikojë problemet reale që e pengojnë këtë proces dhe do të rekomandojë nisma ligjore e politike për ta përfunduar procesin e kthim-kompensimit brenda një kohe të përshtatshme, në përgjigje të rekomandimeve të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

### **Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2013-2020<sup>92</sup>**

Strategjia Kombëtare për zhvillim dhe integrim 2013-2020, është një dokument i miratuar nga Qeveria shqiptare, dhe që synon të shërbejë si një vizion afatmesëm për planifikimin e politikave, si dhe afatgjatë për zhvillimin kombëtar.

Në këtë dokument një vëmendje e veçantë i kushtohet edhe të drejtave së pronësisë, duke u referuar se “*Menaxhimi i të drejtave të pronësisë është*

---

<sup>92</sup> Miratuar në dhjetor 2011.

*një shqetësim i veçantë për shkak të rëndësisë së tokës dhe tregjeve të kreditit si dhe ndikimit të tyre mbi ecurinë e ekonomisë”.*

Rezultatet që priten të arrihen nga zbatimi i kësaj strategjie në këtë fushë është përmirësimi i menaxhimit të të drejtave të pronësisë dhe në përputhje me jurisprudencën përkatëse të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Gjithësesi, ky dokument, nuk përmban ndonjë paragraf që përmend në mënyrë të drejtpërdrejtë kthimin dhe kompesimin e pronave komuniteteve fetare si një prioritet i qeverisë shqiptare.

### **Strategjia ndërsektoriale “Reforma në fushën e të drejtave të pronësisë 2012-2020”**

Këshilli i Ministrave ka miratuar strategjinë ndërsektoriale “Reforma në fushën e të Drejtave të pronësisë 2012-2020”.<sup>93</sup> Në preambulën e këtij dokumenti theksohet se *“hartimi i kësaj strategjie, megjithë problemet komplekse që mbartin të drejtat e pronësisë, bazohet në vullnetin politik të orientuar drejt një qasjeje gjithpërfshirëse, në mënyrë që të përmbushen standartet ndërkombëtare ekzistuese, si dhe të barazpeshohen interesat dhe nevojat e grupeve të ndryshme të interesit në shoqëri”.*

Kjo strategji kombëtare synon të adresojë problemet e shumëfishta dhe të identifikojë mënyrat për të balancuar titujt kontradiktorë mbi pronën në një mënyrë të drejtë. Parimet që udhëheqin strategjinë janë të dimensionit kushtetues dhe lidhen me interesin publik, shpërblimin e drejtë, parimin e drejtësisë, të proporcionalitetit dhe të shtetit social, duke u bazuar jo vetëm në shtjellimin e vendimeve të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, por edhe nga jurisprudenca, tashmë e pasur, e Gjykatës Kushtetuese.<sup>94</sup>

Strategjia merr në konsideratë edhe parimet e sigurisë juridike dhe të qartësisë së legjislacionit, si premisa thelbësore të forcimit të të drejtave themelore, paralelisht me zhvillimin e vendit dhe tërheqjen e investimeve të huaja. Natyra strategjike e dokumentit ka shtruar detyrën e koordinimit të tekstit të saj me dokumentet kyçe ekzistuese të vendit, në të cilat materializohen angazhime dhe detyrime për t’u përmbushur. Koordinimi synon sheshimin e kundërthënieve dhe evitimin e mbivendosjeve të panevojshme.

---

<sup>93</sup> VKM nr. 405, datë 27.06.2012.

<sup>94</sup> Strategjia ndërsektoriale “Reforma në fushën e të drejtave të pronësisë 2012-2020”

Ky dokument ndjek objektivat afatgjatë të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim për periudhën 2013-2020.<sup>95</sup> Përparësitë e Strategjisë për të Drejtat e Pronësisë janë:

- a. futja në rrugën e duhur të zgjidhjes përfundimtare të procesit të kthimit dhe kompensimit të pronave;
- b. integrimin e zonave dhe ndërtimeve informale të legalizuara;
- c. përfundimi i regjistrimit fillestar të gjitha pasurive;
- ç. dixhitalizimi i sistemeve.

Strategjia shfrytëzon gjetjet dhe rekomandimet e Memorandumit të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës, nga analiza e të cilit del e nevojshme një zgjidhje gjithëpërfshirëse e problemit të të drejtave të pronësisë, bazuar jo vetëm në sfidat aktuale që Shqipëria po kalon, por edhe në eksperiencat e ngjashme të vendeve të tjera anëtare të Këshillit të Europës në zbatim të vendimeve të GJEDNJ-së.

Strategjia mban në konsideratë tipologjinë e problematikave shqiptare, duke bërë një ndarje midis proceseve të përkohshme (kthimi/kompensimi i pronës; vlefshmëria e titujve të pronësisë apo legalizimi i ndërtimeve informale) dhe proceseve të përhershme (regjistrimi i titujve të pronësisë apo zbatimi i vendimeve gjyqësore), në funksion të planifikimit të masave dhe parimeve të duhura për adresimin e tyre.

Gjithsesi, strategjia nuk përmend në mënyrë të veçantë problematikat që lidhen me pronat e komuniteteve fetare. Pavarësisht se kjo strategji ka kaluar në disa procese konsultimi që prej vitit 2011, asnjëherë nuk është marrë në konsideratë propozimi i organizatave ndërkombëtare që mbështesin Qeverinë shqiptare në reformën pronësore, për të përfshirë çështjen e kthimit dhe kompensimit të pronave të komuniteteve fetare si pjesë e planit të veprimit të kësaj strategjie.

---

<sup>95</sup> Miratuar në mbledhjen e Komitetit të Planifikimit Strategjik, 20 dhjetor 2011.

## ii. Vlerësime të raporteve të Organizatave Ndërkombëtare

### *Raporti i Komisionit European i vitit 2015 për Shqipërinë*

Raporti i Komisionit European i vitit 2015 për Shqipërinë,<sup>96</sup> paraqet një tablo të qartë të progresit të arritur nga institucionet shqiptare dhe problematikat e konstatuara në fusha të ndryshme, në kuadër të monitorimit të përmbushjes së kriterëve politike dhe ekonomike të integritimit në Bashkimin European. Ky raport mbulon periudhën nga qershor 2014 deri në shtator 2015, dhe bazohet në të dhëna të marra nga një larmi burimesh, përfshirë kontributet e Qeverisë shqiptare, shtetet anëtare të BE-së, raportet e Parlamentit European dhe informacione nga organizata të ndryshme ndërkombëtare dhe jo-qeveritare.

Kur flitet për të drejtat e njeriut, raporti përmend, ndër të tjerash, faktin se ka mangësi në “*garantimin e ekzekutimit të të drejtave të pronësisë*”, dhe se “*procesi për regjistrimin, kthimin dhe kompensimin e pronës nuk ka përfunduar*”.

Raporti ndalet edhe tek instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të ratifikuar nga Shqipëria, duke theksuar se: “*Nga shtatori 2014, Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) ka konstatuar se vendi ka shkelur Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) në tre raste lidhur me të drejtën për gjykim të drejtë, mbrojtjen e pronës, të drejtën e lirisë dhe sigurisë dhe të drejtën për kompensim. 130 aplikime të reja i janë alokuar një organi vendimmarrës, duke çuar numrin e aplikimeve në 402*”.<sup>97</sup>

Vazhdon të ketë vonesa në ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, *sidomos në lidhje me të drejtat e pronësisë, ...*”.

Përsa i përket lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe besimit, raporti thekson se “*është respektuar në përgjithësi dhe toleranca fetare ka mbizotëruar. ... Në gusht, një Kishë Ortodokse në Dhërmi u prish nga autoritetet shqiptare me arsyetimin se ishte ndërtuar pa leje, duke nxitur protesta nga Komuniteti i Kishës*”.

<sup>96</sup> Raporti u bë publik më datë 11 nëntor 2015.

<sup>97</sup> Po aty.

Raporti ndalet në mënyrë të veçantë në nevojën për më shumë përpjekje për të përditësuar dhe zbatuar strategjinë 2012 - 2020 për të drejtat e pronësisë dhe për të përfunduar procesin e regjistrimit të pronave, për të siguruar zbatimin e vendimeve gjyqësore dhe vazhduar procesin e kthimit dhe kompensimit të pronave.

Raporti përmend, gjithashtu, faktin se për të zbatuar planin e veprimit 2014 të rënë dakord me Komitetin e Ministrave të Këshillit Europian, qeveria po finalizon ligjin e ri për ngritjen e një mekanizmi për ekzekutimin e vendimeve për kthimin apo kompensimin e pronave, të shtetëzuara gjatë regjimit komunist.

Në përfundim raporti përsa i përket çështjeve të pronave, e vë theksin në nevojën se *“Shqipëria duhet të përmirësojë zbatimin e strategjisë për të drejtat e pronësisë 2012-2020 dhe procesin e regjistrimit, kthimit dhe kompensimit të pronave”*.<sup>98</sup>

Megjithëse raporti nuk identifikon në mënyrë të veçantë problematikat që lidhen me pronat e komuniteteve fetare, është e rëndësishme të theksohet se në çdo vit çështja e problematikës së pronave është në fokusin e vlerësimit të strukturave të Komisionit Europian. Ky i fundit, ka qenë dhe një nga kontribuesit e rëndësishëm në kuadër të procesit të regjistrimit fillestar në zonat e jugut.<sup>99</sup>

### ***Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit për të Drejtat e Njeriut (2014)***<sup>100</sup>

Në Raportin për të Drejtat e Njeriut në vitin 2014 për Shqipërinë, të Departamentit Amerikan të Shtetit<sup>101</sup> një vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe problemit të kompensimit të pronës. Në këtë raport, ndërmjet të tjerash, është theksuar se një numër i madh pretendimesh kundërshtuese për prona private dhe fetare të konfiskuara gjatë epokës komuniste mbetën të pazgjidhura. Ekspertët e Bankës Botërore deklaruan se *“duke pasur parasysh ritmin e ulët të kthimit, qeverisë do t’i duheshin*

---

<sup>98</sup> Po aty.

<sup>99</sup> Immovable property registration and road signage in priority coastal areas of Albania, EU Project

<sup>100</sup> [albanian.tirana.usembassy.gov/key\\_reports/raporte-t-rndsishm.html](http://albanian.tirana.usembassy.gov/key_reports/raporte-t-rndsishm.html)

<sup>101</sup> Publikuar në qershor 2015



*38.6 miliardë dollarë dhe 30 vjet për ta përfunduar procesin. Deri në shtator, mbi 7,000 çështje kthimi pronash prisnin zgjidhje në Agjencinë shtetërore për Kthimin e Pronës”.*

Në korrik, GJEDNJ-ja refuzoi kërkesën e autoriteteve për të shtyrë afatin e saj të qershorit për ngritjen e një mekanizmi të efektshëm për të kompensuar ish pronarët për pronat e tyre. GJEDNJ nxori vendime në një numër çështjesh të profilit të lartë që kërkonin nga qeveria t’u paguante paditësve dhjetëra miliona dollarë si kompensim për prona të konfiskuara. Deri në shtator qeveria kishte miratuar katër vendime për ekzekutimin e gjykimeve të GJEDNJ-së të cilat kërkonin kompensimin financiar të pretenduesve. Megjithatë, disbursimi i fondeve mbeti i pasigurt deri në shtator.

Raporti përmend edhe një rast konkret që lidhet me ekzekutimin e një vendimi gjyqësor për largimin e katërmbëdhjetë familjeve nga një kompleks apartamentesh dhe kthimin e pronës tek pronari i para periudhës komuniste.<sup>102</sup>

### ***Raporti Ndërkombëtar për Lirinë e Fesë për vitin 2013<sup>103</sup>***

Në raportin ndërkombëtar për lirinë e fesë në Shqipëri, për vitin 2013, të hartuar nga qeveria e SHBA-së, theksohet se: *“Qeveria përparoi pak në shqyrtimin e pretendimeve nga grupet fetare për kthimin ose kompensimin e pronave të shtetëzuara gjatë periudhës së mëparshme komuniste dhe shumë prej këtyre pretendimeve për pronën mbetën të pazgjidhura”.*

Raporti përmend faktin se *“Qeveria vijoi të shqyrtonte si pretendimet ekzistuese edhe pretendime të reja nga grupe fetare në lidhje me kthimin dhe kompensimin e pronave marrë gjatë periudhës së komunizmit”.* Megjithatë, shumë pretendime pronash mbetën të pa zgjidhura. Agjencia Shtetërore për Kthimin dhe Kompesimin e Pronës duhet me ligj t’i japë përparësi pronave në zotërim të komuniteteve fetare, megjithëse komunitetet fetare raportuan se përparimi në zgjidhjen e këtyre ka qenë i ngadaltë.

<sup>102</sup> Në vitin 2013, një zyrë përmbarimi private nxori 14 familje nga një kompleks apartamentesh në Tiranë, sipas pretendimeve në zbatim të një urdhëri gjykate që urdhëronte. Familjet filluan një grevë urie duke kërkuar që qeveria t’u gjente zgjidhje dhe prokuroria e Tiranës filloi ndjekje penale kundër agjencive të qeverisjes së qytetit që kishin nxjerrë urdhrin fillestar të gjykatës. Familjet e dëbuara filluan procedim civil kundër zyrës së përmbarimit privat. Në qershor, prokuroria e Tiranës e pushoi çështjen.

<sup>103</sup> [albanian.tirana.usembassy.gov/key\\_reports/](http://albanian.tirana.usembassy.gov/key_reports/)

Raporti ndalet edhe në rastet ku Qeveria dha grante për tokë në vend të kthimit të pronës, duke dalë në konkluzionin se “*Sfidat administrative dhe ligjore lidhur me pretendimet për pronësi në përgjithësi e kanë vështirësuar kthimin e pronës për individët dhe organizatat, përfshirë edhe komunitetet fetare*”.

Raporti përmend, se gjatë vitit 2013, qeveria përfundoi kthimin e katër ndërtesave në Durrës dhe Korçë kishës ortodokse nëpërmjet procesit të rikthimit, por afro 435 pretendime mbetën të pa zgjidhura. Ky raport përmend gjithashtu rastin në Bashkinë e Përmetit ku përmbaues privatë nxorrën me forcë disa klerikë ortodoksë dhe disa objekte fetare nga një pronë e diskutueshme.<sup>104</sup>

Në raport theksohet, gjithashtu, se mosmarrëveshjet mbi zotërimin e pronës dhe problemet me gjetjen dhe regjistrimin e pronësisë së tokës e vështirësuan marrjen e tokës së re për ndërtime vendesh adhurimi për grupet fetare.<sup>105</sup>

### ***Dokumenti i Bashkëpunimit Këshilli i Europë-Shqipëri, 2015-2017***<sup>106</sup>

Dokumenti i Bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Europës dhe Shqipërisë është një instrument strategjik që mundëson një qasje gjithpërfshirëse dhe koherente të bashkëpunimit. Ky dokument synon të mbështesë Shqipërinë në plotësimin e detyrimeve specifike si vend anëtar i KE-së si dhe të ndihmojë më tej në përjasjen e legjislacionit shqiptar, institucioneve dhe praktikave me standarde europiane në fushën e të drejtave të njeriut, shtetit të së drejtës dhe demokracisë.

Fushat prioritare të dokumentit të bashkëpunimit derivojnë nga një tërësi burimesh: prioritetet politike të vendit (përfshirë kriteret e anëtarësimit

<sup>104</sup> Kisha ortodokse kishte përdorur një kishë në këtë pronë si vend adhurimi që prej shekullit të shtatëmbëdhjetë deri në vitin 1962, kur regjimi komunist e ktheu këtë ndërtesë në qendër kulturore. Në vitin 1998 kisha e kërkoi pronën mbi bazën e ligjit të vendit për rikthim prone. Gjykatat në fillim morrën vendim në favor të kishës, por më vonë e rrëzuan vendimin dhe ia dhanë pronën bashkisë, në vitin 2002

<sup>105</sup> Për shembull, Vëllazëria Ungjillore e Shqipërisë mori me qera ndërtesa ekzistuese, por raportoi se vështirësitë për marrjen e tokës dhe ndërtimin e një ndërtese të tyren i penguan në mbajtjen e shërbesave fetare. Komuniteti Islamik Shqiptar (KISH) vazhdoi të provonte të merrte lejen e ndërtimit nga qeveria për një xhami të re në Tiranë, në tokën që po i kthehej komunitetit nëpërmjet procesit të rikthimit. Tërheqja e licencës për të ndërtuar një qendër tregtare në tokën pranë vendit ku do të ndërtohet xhamia ngriti pikëpyetje edhe mbi ndërtimin e xhamisë.

<sup>106</sup> [www.coe.int/sq/web/tirana](http://www.coe.int/sq/web/tirana)

në BE), standartet e KE-së dhe rekomandimet e strukturave monitoruese të saj, si dhe eksperiencës së zbatimit të programeve të bashkëpunimit në Shqipëri, të mëparshme apo në zbatim.

Një nga elementët e bashkëpunimit është edhe forcimi i mbrojtjes së të drejtave të pronësisë në një linjë me vendimet e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut (Pika 4.2.12), në të cilën parashikohet:

- Ofrimi i asistencës dhe ekspertizës për zbatimin e vendimeve të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut në lidhje me të drejtat e pronësisë;
- Forcimi i kapaciteteve të strukturave përkatëse për të zbatuar standartet europiane në proceset e brendshme gjyqësore;
- Ofrimi i ndihmës për Qeverinë shqiptare për t'u mbështetur në vendimet e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut në lidhje me të drejtat e pronësisë.

Sipas këtij dokumenti, Këshilli i Europës mund të ofrojë ekspertizë shtesë në lidhje me kuadrin legjislativ dhe institucional, si dhe në zbatimin e reformave strukturore.

### **1.3 Institucionet përgjegjëse për çështjet e pronësisë**

Shqipëria, aktualisht ka mbi tetë institucione që veprojnë mbi të drejtat e pronësisë, në varësi të ministrive të ndryshme përgjegjëse, veprimtaria e të cilave rregullohet nga pjesë të ndryshme të legjislacionit. Ato trajtojnë në mënyrë të fragmentarizuar çështje të fitimit të pronësisë dhe të regjistrimit të titujve të pronësisë. Numri i lartë i institucioneve dhe legjislacioni rregullator i shumë, kompleks dhe shpesh herë i ndryshueshëm, krijojnë mbivendosje të proceseve që lidhen me të drejtat e pronësisë.

Reformat e njëpasnjëshme gjatë këtyre viteve dhe ndryshimet e shumta institucionale si në drejtim të ngritjes së institucioneve, në drejtim të ndryshimeve në struktura dhe stafe, ashtu dhe në drejtim të transferimit të përgjegjësive nga një organ tek tjetri, kanë ndikuar negativisht në procesin e reformës pronësore.

Institucionet kryesore që operojnë në Shqipëri për t'i dhënë zgjidhje procesit të kthimit dhe kompensimit të pronave, por edhe reformës pronësore në tërësi janë:

1. **Agjencia e Kthimit dhe e Kompensimit të Pronës (AKKP)** – organ i krijuar në vitin 2006 pas suprimimit të Komitetit Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronës. AKKP, së bashku me zyrat rajonale në qarqe, u krijua në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, për të siguruar një organizim të centralizuar, efektiv dhe të shpejtë vendimmarrës. Zyrat Vendore të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave në secilin qark të vendit u suprimuan me ndryshimet ligjore të vitit 2009 dhe tashmë i gjithë procesi administrativ i shqyrtimit dhe vendimmarrjes është përqendruar në AKKP-në Tiranë, që drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm i cili në zbatim të përgjegjësive për kompensimin, shqyrtimin dhe zgjidhjen e ankimeve, ndaj vendimeve për njohjen, kthimin dhe kompensimin e pronave, shprehet me vendim. Me reformat e fundit ligjore, AKKP kthehet në Agjencinë e Trajtimit të Pronave
2. **Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme** – përbëhet nga zyra qendrore dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për regjistrimin e të gjitha pasurive të paluajtshme që shtrihen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, bazuar në akte të fitimit të pronësisë apo krijimit të të drejtave reale mbi to, sipas kërkesave të paraqitura nga persona juridikë/fizikë, vendas apo të huaj. Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme administron sistemin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për regjistrimin e titujve të pronësisë dhe të të drejtave të tjera reale mbi pasuritë e paluajtshme, në bazë të dokumenteve ligjore, që vërtetojnë pronësinë mbi pasuritë e paluajtshme.
3. **Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave Informale (ALUIZNI)** – është institucioni përgjegjës për realizimin e procesit të legalizimit, urbanizimit dhe integritit të ndërtimeve informale. ALUIZNI, së bashku me zyrat rajonale në qarqe, kryen fushatën kombëtare të informimit dhe të sensibilizimit të qytetarëve, në bashkëpunim me mjetet e informimit të gjerë publik, në nivel kombëtar, ngritjen e bazës së të dhënave për ndërtimet pa leje dhe ecurinë e legalizimit, si dhe përgatitjen e manualeve të procedurave, udhëzimeve dhe formularëve.
4. **Shërbimi Përmbartimor Gjyqësor (shtetëror apo privat)** – janë strukturat që kryejnë veprimet e tyre procedurale për ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutivë, sipas dispozitave të Kodit të

Procedurës Civile, Kodit Civil, akteve të tjera ligjore dhe nënligjore, për subjektet e tjera private dhe shtetërore, që përfshihen në procesin e ekzekutimit.

5. **Avokatura e Shtetit** – është një strukturë e organizuar në varësi të Ministrisë së Drejtësisë që e ushtron veprimtarinë e saj në nivel qëndror dhe nivel vendor. Avokatura e Shtetit është institucion qëndror i administratës publike, i ngarkuar ekskluzivisht për dhënien e ndihmës juridike për institucionet shtetërore dhe entet publike. Ndihma juridike përfshin shërbimin këshillimor dhe të përfaqësimit.
6. **Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pasurive të Paluajtshme** – është një strukturë në varësi të Ministrisë së Brendshme që kryen procesin e inventarizimit dhe transferimit të pronave të paluajtshme shtetërore publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore, drejton procesin e inventarizimit të pasurive të paluajtshme publike që administrohen nga institucionet e pushtetit qendror, dhe bën përgatitjen e akteve që dërgohen për miratim në Këshillin e Ministrave.
7. **Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike në Ministrinë e Financave** – është organi, që kryen procedurat e shitjes së pronës shtetërore, që privatizohet, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe me ligj. Këtë funksion e ka kryer më parë ish-Agjencia Kombëtare e Privatizimit dhe ish- Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronës Publike.
8. **Komisioni Qeveritar i Tokës dhe Komisionet Vendore pranë Prefektit të çdo Qarku** – është një strukturë në varësi të Ministrisë së Bujqësisë që ka si qëllim drejtimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së komisionit vendor të vlerësimit të titujve të pronësisë (KV) për verifikimin e vlefshmërisë së titujve të pronësisë, nëpërmjet marrjes së vendimeve për zgjidhjen e konflikteve territoriale ndërmjet qarqeve për kufijtë e zërit kadastral të tokës bujqësore.

## 1.4 Vendime të Gjykatës Kushtetuesedhe Gjykatës së Lartëmbi të drejtën e pronës

Për shtetet ish-komuniste, prona e shpronësuar gjatë periudhës së regjimit komunist u bë një çështje drejtësie. Të shumta kanë qenë rastet kur Gjykata Kushtetuese është vënë në lëvizje për të vendosur nëse dispozitat e ligjit janë në përputhje me Kushtetutën apo kur Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë bërë interpretimin e dispozitave ligjore mbi të drejtën e pronësisë.

### 1.4.1 Vendime të Gjykatës Kushtetuese

Gjykata Kushtetuese ka interpretuar në mjaft raste dispozitat e kuadrit ligjor që rregullon dhe parashikon procedurat e kthimit dhe kompesimit të pronës, duke analizuar natyrisht edhe kushtetueshmërinë e normave në raport me Kushtetutën.

Në lidhje me ligjin e kthimit dhe kompesimit të pronës, Gjykata Kushtetuese shprehet mbi këtë çështje se qëllimi i këtij ligji është të ndreqë “...brenda mundësive dhe kushteve ekonomiko-sociale të vendit, padrejtësitë e regjimit të kaluar, të kryera në dëm të pronës private, nëpërmjet shtetëzimeve, shpronësimeve, konfiskimeve ose me çdo mënyrë tjetër të padrejtë”.<sup>107</sup> Gjykata Kushtetuese, e çmon, gjithashtu, se e drejta e ish-pronarëve të truallit, e vlerësuar ekonomikisht, nuk duhet të jetë “nën nivelin e kërkesës kushtetuese për një shpërblim të drejtë”.

Gjykata Kushtetuese, me vendimin e saj të muajit maj 2010, shprehet se “Për sa më sipër, vendimet e organeve administrative, që kanë pasur si kompetencë kthimin dhe kompesimin e pronave, në vite, nuk mund të konsiderohen akte administrative, në kuptimin normal juridik të termit (*strictu sensu*), por akte sui generis të nxjerra nga një organ sui generis, për të cilin Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut ka përdorur termin leksikor, quasi gjykate....”.

Nisur nga sa më sipër, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se “KKKP nuk ishin organe administrative në kuptimin klasik juridik të termit. Ato nuk ishin të përfshira në piramidën e ekzekutivit, dispononin në lidhje me të drejta

<sup>107</sup> Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.4/1994, faqe 5.

*subjektive të shtetasve dhe vendimet e tyre kontrolloheshin drejtpërdrejt nga gjykatat në një gjykim të zakonshëm që nuk ishte i njëjtë me atë në lidhje me pavlefshmërinë e aktit administrativ. Për rrjedhojë, edhe vendimet e KKKP nuk ishin akte administrative në kuptimin juridik të termit”.*<sup>108</sup>

Gjithashtu, Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj, të majit 2010 dhe të tetorit 2011,<sup>109</sup> shfuqizoi si të papajtueshme me Kushtetutën disa nga dispozitat e Ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004 “*Për kthimin dhe kompensimin e pronës*”, i ndryshuar, që autorizonin drejtorin e Agjencisë qendrore të rishqyrtonte, anulonte dhe shfuqizonte kryesisht vendimet e Komisionit.

Duke patur parasysh, ndër të tjera, vendimet në çështjet Ramadhi dhe Hamzaraj kundër Shqipërisë,<sup>110</sup> Gjykata Kushtetuese ka rikonfirmuar faktin se “*vendimet e Komisionit ishin të afta të vendosnin ndaj individëve pritshmëri ligjore të barabarta me atë të krijuar në bazë të një vendimi gjykate që njuh të drejtat e pronësisë të një individi*”. Rrjedhimisht, ato vendime që nuk ishin akte administrative brenda kuptimit të këtij nocioni ligjor, ishin drejtpërdrejtë subjekt rishikimi gjyqësor.

Për më tepër, meqë këto vendime ishin bërë “*përfundimtare dhe të zbatueshme*”, nuk mund t’i nënshtroheshin rishikimit nga drejtori i Agjencisë, i cili nuk “*mishëronte karakteristikat e një organi gjyqësor ose organi quasi gjyqësor*”.<sup>111</sup>

Në vendimin e shkurtit 2007, Gjykata Kushtetuese përcakton “*të drejtën e pronarit të ligjshëm për të gëzuar i qetë pronën pas një vendimi të formës së prerë. E parë në këndvështrimin e palës humbëse në një gjykim i cili është zgjidhur me vendim të formës së prerë, ky argumentim i Gjykatës nuk mund të lexohet ndryshe përveçse si detyrim i palës humbëse për të mos shqetësuar pronarët e ligjshëm të sendit objekt gjykimi pasi i mungon legjitimiteti për të bërë diçka të tillë*”.<sup>112</sup>

<sup>108</sup> Vendimi nr.27, datë 26.05.2010.

<sup>109</sup> Vendimi nr.43, datë 06.10.2011.

<sup>110</sup> Nr. 45264/04, 3 shkurt 2009.

<sup>111</sup> Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.6 datë 07.03.2011 ku është vendosur shfuqizimi si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, i neneve 2, 3 dhe 5 të ligjit nr.10308, datë 22.07.2010 “*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin pronës, i ndryshuar*”.

<sup>112</sup> Vendimi nr.9, datë 26.02.2007.

Në vendimin e majit 2010, Gjykata Kushtetuese përforcon vendimin e lartpërmendur, duke u shprehur, gjithashtu, se “...*nuk mund të cënohet situata juridike dhe faktike e palëve, e krijuar nga vendimi gjyqësor i formës së prerë, as me vendime të mëvonshme gjyqësore dhe as me akte të ndonjë lloj organi tjetër shtetëror*”.

Në kontekstin e shqyrtimit të rishikimit të kushtetutshmërisë së legjislacionit për pronën, Gjykata Kushtetuese është vënë në lëvizje disa herë për të vendosur nëse dispozitat e ligjit janë në pajtim me Kushtetutën. Gjatë funksionimit të saj, rezulton se Gjykata Kushtetuese është shprehur përmes 39 vendimeve lidhur me çështje të respektimit të të drejtës së pronës, ku përfshihet edhe një çështje që lidhet me pronat e komuniteteve fetare.<sup>113</sup>

Në lidhje me këtë çështje, Gjykata Kushtetuese u vu në lëvizje nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë në lidhje me pretendimin e tij për një pronë në qytetin e Tiranës, pronë e cila me vendim gjyqësor i ishte dhënë në pronësi një personi fizik. Me vendimin e saj, të datës 25 janar 2010<sup>114</sup> Gjykata Kushtetuese vendosi pranimin e kërkesës së Komunitetit Mysliman dhe shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në këtë gjykatë.

Pas rishqyrtimit të saj, Gjykata e Lartë vendosi ndryshimin e vendimeve të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës së Shkallës së Parë për kalimin në pronësi të personit fizik.<sup>115</sup> Po në lidhje me këtë çështje, Gjykata Kushtetuese është investuar përsëri, bazuar në kërkesën e bërë nga personi fizik në fjalë, kërkesë e cila u refuzua nga kjo Gjykatë.<sup>116</sup>

Tashmë Gjykata Kushtetuese është vënë përsëri në lëvizje lidhur me kushtetueshmërinë e ligjit të ri nr. 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”.

---

<sup>113</sup> Vendimi nr.1, datë 25.01.2010.

<sup>114</sup> Vendimi nr.1, datë 25.01.2010.

<sup>115</sup> Vendimi nr.424, datë 06.10.2011.

<sup>116</sup> Vendimi nr.7, datë 10.02.2014.



#### 1.4.2 Vendime të Gjykatës së Lartë

Në kuadër të unifikimit të praktikës gjyqësore, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë bërë një interpretim sistematik të dispozitave ligjore mbi të drejtën e pronës private dhe atë të kthimit dhe të kompensimit të pronave ish-pronarëve.<sup>117</sup>

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë vlerësuar se pavarësisht se procesi i njohjes, kthimit apo kompensimit të pronave rezulton t'i jetë besuar një organi administrativ sikurse ishin më parë Komisionet e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve dhe aktualisht Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, veprimtaria e këtyre organeve administrative nuk është konsideruar asnjëherë si veprimtari e mirëfilltë administrative, por si një veprimtari e cila paraqiste dhe paraqet karakteristikat e një veprimtarie gjyqësore.<sup>118</sup>

Në vendimin unifikues të vitit 2004, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, do të mbanin qëndrimin se *“Procesi i kthimit dhe kompensimit të pronave ish-pronarëve për sa parashikohet në ligjin nr.7698, datë 15.04.1993 “Për Kthimin dhe Kompensimin e pronave ish-pronarëve”, nuk janë forma të reja të fitimit të pronësisë, pasi pronarët nuk e kanë humbur asnjë herë titullin e së drejtës së pronësisë mbi sendet e tyre, por vetëm posedimin”*.<sup>119</sup>

Këtë parim Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë e kishin konfirmuar edhe në vendimin e muajit mars 2002, ku shpreheshin se Ligji nr. 7698, datë 15.4.1993, *“Për kthimin dhe kompensimin e pronave”, “...nuk janë mënyra të reja të fitimit të pronësisë, por korrigjim i padrejtësisë së bërë, dhe për këtë qëllim, shfuqizojnë ipso lege gjithë aktet e mëparshme ligjore, me të cilat u ishte marrë prona pronarëve padrejtësisht. Ato nuk krijojnë një situatë të re, (nuk kanë efekt konstitutiv), por stabilizojnë ligjshmërinë dhe drejtësinë”*.<sup>120</sup>

Më poshtë, Kolegjet e Bashkuara shprehen së këto akte normative *“...ipso lege kanë shfuqizuar efektet e akteve ligjore e nënligjore si dhe vendimet e gjykatave të tjera..”*.

<sup>117</sup> Shih vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë nr.4 datë 10.12.2013.

<sup>118</sup> Po aty.

<sup>119</sup> Vendimi unifikues nr.5/2004.

<sup>120</sup> Vendimi nr. 24, dt. 13.03.2002.

Po në këtë vendim, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë analizuar dhe interpretuar natyrën dhe qëllimin e ligjit “*Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve*” si dhe nocionin kthim i pronës të përdorur si në titullin e ligjit (rubrica legis fit lex), ashtu edhe në përmbajtjen e tij. Kolegjet e Bashkuara janë shprehur konkretisht se: “...*Ligjvënësi me këto akte të rëndësishme normative ka njohur padrejtësinë, shkeljen e të drejtave të pronësisë ish-pronarëve dhe ka vendosur të rinjohë të drejtën e pronësisë së tyre duke ju kthyer pronat e shtetëzuara, të shpronësuara, të konfiskuara apo të marra pa të drejtë në forma të tjera, dhe në pamundësi, duke i kompensuar ato. Këto ligje, duke konsideruar të padrejtë atë që kishte ndodhur më parë, parashikuan kthimin e të drejtave të pronarëve mbi pronën, kur objekt i saj ishin sende të paluajtshme...*”.<sup>121</sup>

Në këtë kuadër, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë i kanë konsideruar këto akte ligjore që u drejtohen ish-pronarëve apo trashëgimtarëve të tyre, jo si mënyrë të re të fitimit të pronësisë në favor të tyre, por si mjete që mbrojnë dhe garantojnë të drejtën e pronësisë dhe e bëjnë efektive atë duke e bazuar edhe në argumente analogjike.<sup>122</sup>

Kthimi i pronave ish-pronarëve ose trashëgimtarëve të tyre është thelbi dhe qëllimi i këtyre ligjeve (*anima legis dhe ratio legis*). Ky është edhe thelbi i mbrojtjes dhe garantimit të të drejtës së pronësisë jo vetëm në rrugë gjyqësore, por edhe në atë administrative.

Nga ana e Gjykatës së Lartë është analizuar jo vetëm e drejta e pronësisë, por edhe mënyra e fitimit të pronësisë duke i’u referuar për këtë qëllim instituteve të së drejtës civile që kanë rregulluar të drejtën e pronësisë në kohë të ndryshme.

Në Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara nr.25/2003 lidhur me subjektet që legjitimohen proceduralisht si paditës, thuhet se: “... *ndërsa në grupin e parë përfshihen subjektet që kërkojnë rivendosjen apo kompensimin e të drejtave të tyre si ish-pronarë (trashëgimtarë të ish-pronarëve), në grupin e dytë të subjekteve të legjitimuar proceduralisht përfshihen ato subjekte që kundërshtojnë, në emër të së drejtave apo interesave të tyre*

---

<sup>121</sup> Po aty.

<sup>122</sup> Po aty.

*të ligjshme, përfitimet e paligjshme që mund të kenë realizuar subjektet e grupit të parë nëpërmjet vendimeve të komisioneve të pronave”.*

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin nr.4/2005 kanë arritur në përfundimin unifikues se: *“Pavarësisht nga momenti i regjistrimit të çështjes për gjykim (para apo pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri), në të gjithë rastet kur padia për kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Kthimit të Pronave është ngritur nga persona të tjerë që kanë fituar të drejta pronësie mbi pronat e trajtuara nga ky vendim, është gjykata ajo që ka juridiksionin për shqyrtimin e këtyre çështjeve”.*

Në Vendimin Unifikues nr.7/2005, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin unifikues se: *“... të gjitha çështjet, të cilat kanë të bëjnë me kundërshtimin e vendimeve të Komisioneve të Kthimit e Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve, që janë marrë në zbatim të Ligjit nr.7698, datë 15.04.1993 dhe që janë kundërshtuar në gjykatë përpara hyrjes në fuqi të Ligjit nr.9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, janë në juridiksionin gjyqësor dhe jo në atë administrativ”.*

Në Vendimin Unifikues nr. 2/2009, Kolegjet e Bashkuara kanë mbajtur qëndrimin se: *“Ankimi administrativ parashikuar në nenin 18 të Ligjit “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” duhet kuptuar dhe zbatuar njëjloj si për ankimet nga subjekti kërkuar që ndjek procedurën e plotë administrative dhe nuk paraqiten subjekte të tjerë kërkuese, ashtu dhe për ankimet nga një subjekt i ri pretendues kundër aktit administrativ të dhënë në favor të një subjekti tjetër; por që prek interesat e tij për të njëjtën pronë dhe nuk ka qenë palë në procedurën e plotë administrative të nxjerrjes dhe ankimimit të aktit. Në të dyja rastet, subjektet e shpronësuar janë të detyruar të ndjekin procedurat e ankimit administrativ dhe vetëm pasi të jetë ezauruar plotësisht kjo rrugë ligjore, mund t’i drejtohen gjykatës”.*

Ndërsa në Vendimin Unifikues nr. 2/2011, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë ndryshuar qëndrim nga vendimi unifikues nr.2/2009 duke unifikuar praktikën me sentencën unifikuese se: *“...subjektet e shpronësuar kanë detyrimin që t’i drejtohen organit administrativ, pra A.K.K.P.-së, vetëm në dy situata.”*

Në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me pronat e komuniteteve fetare, vlen të përmendet këtu vendimi i Kolegjit të Bashkuar të Gjykatës së Lartë<sup>123</sup>, në lidhje me pretendimet e KMSH (Myftinia Gjirokastrë) ndaj një prone e cila me vendim gjykate i ishte dhënë në pronësi një tjetër komuniteti fetar (KOASH).

Në lidhje me këtë çështje, Kolegjet e Bashkuara në vendimin e tyre janë ndaluar në mënyrë të veçantë në parimin e sigurisë juridike. Kolegjet e Bashkuara shprehen se *“Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, në disa çështje kundër Shqipërisë, ka evidentuar rëndësinë e sigurisë juridike në procesin e kthimit dhe kompensimit të pronave, veçanërisht për sa i përket të drejtave të fituara nga vendimet që kanë njohur të drejta pronësie, dhe të ruajtjes së garancive që lidhen me këto të drejta”*.<sup>124</sup>

Kolegjet e Bashkuara theksojnë më tej se: *“Siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit tek shteti, institucionet e tij dhe aktet që ato nxjerrin. Ndërsa në kontekstin e çështjes në shqyrtim, siguria juridike nënkupton, që në rastet kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje (mbi mungesën e së drejtës së pronësisë), vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim”*<sup>125</sup>.

Më tej, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë theksojnë se *“Në rastin në gjykim, duke qenë se kërkuesi nuk disponon dokumente origjinale të periudhës para daljes së ligjit nr.108, datë 29.08.1945 “Për reformën agrare”, është e domosdoshme që të bëhet vërtetimi i faktit “juridik” të pronësisë sipas kërkesave të nenit 388 të Kodit të Procedurës Civile dhe vendimi gjyqësor që vërteton këtë fakt duhet të paraqitet pranë Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave së bashku me dokumentet e tjera për realizimin e të drejtave pasurore sipas përcaktimeve të legjislacionit për kthimin dhe kompensimin e pronave ish pronarëve”*.

---

<sup>123</sup> Nr.00-2014 - 2173 i Vendimit (368)

<sup>124</sup> Shih Ramadhi dhe të tjerë kundër Shqipërisë, datë 13.11.2007; Hamzaraj kundër Shqipërisë (nr.1), datë 03.02.2009; Manushaqe Puto dhe të tjerë kundër Shqipërisë, datë 31.07.2012.

<sup>125</sup> Shih, Vendimi Brumarescu k. Rumanisë, i 28 Tetor 1999, par. 61 deri 63.

## **KAPITULLI II**

### **VLERËSIM I SITUATËS AKTUALE TË ÇËSHTJES SË PRONËSISË TË KOMUNITETEVE FETARE**

Kjo analizë ligjore synon të ofrojë një bazë të nevojshme në punën kërkimore të mëtejshme, dhe të parashikojë hapat që do të hidhen në të ardhmen për trajtimin e duhur dhe efikas të këtij problemi. Me qëllim identifikimin dhe diskutimin e problematikave, si dhe adresimin e tyre me rrugëzgjdhje, ALTRI ndërmoi një vlerësim të gjendjes aktuale të çështjes së pronësisë së komuniteteve fetare nëpërmjet diskutimit në fokus grupe me palët e interesuara.

Qëllimi i fokus grupeve ishte diskutimi rreth zbatimit të legjislacionit në praktikë, identifikimi i saktë i problematikave me të cilat hasen komunitetet fetare por edhe institucionet publike, mbledhja e të dhënave lidhur me situatën e pronave të këtyre komuniteteve, bashkëpunimi i deritanishëm me institucionet publike, si edhe diskutimi lidhur me mekanizmat/instrumentet që mund të ndihmonin në zgjidhjen e kësaj problematike. Pikat e diskutimit u përcaktuan paraprakisht nga Qendra A.L.T.R.I dhe iu dërguan pjesëmarrësve në fokus grup përpara zhvillimit të takimit. Në varësi të përbërjes së çdo fokus grupi u përcaktuan edhe temat e diskutimit.

Janë zhvilluar gjithësej 6 fokus grupepërkatesisht me:

- institucionet publike (një fokus grup),
- komunitetet fetare (një fokus grup me secilin komunitet: mysliman, katolik, ortodoks dhe bektashi) dhe
- një fokus grup i përbashkët me institucionet publike dhe komunitetet fetare.

Në këto fokus grupe u diskutua rreth zbatimit në praktikë të legjislacionit në fuqi lidhur me çështjet e pronës së komuniteteve fetare, por edhe mbledhjen e të dhënave të nevojshme dhe të sakta lidhur me vendimet e dhëna, dosjet në shqyrtim dhe problematikën e tyre. Përballja e këndvështrimeve të ndryshme (ato shtetërore dhe të komuniteteve) ndihmoi për një kuptim

më të qartë të disa problematikave, identifikimin e pikave ku duhej bashkëvepruar më shumë si dhe sugjerimin e disa gjetjeve të caktuara.

Pas zhvillimit të fokus grupeve, etapa vijuese po aq e rëndësishme ishte përpunimi i të dhënave që rezultojnë prej këtyre takimeve. Transkriptimet e çdo fokus grupi u zbardhën nga ekspertët e Qendrës A.L.T.R.I. Produkt i këtij përpunimi është Analiza e të dhënave të mbledhura nga fokus grupet, e paraqitur më poshtë. Nga përpunimi i transkriptimeve të çdo fokus grupi, Qendra A.L.T.R.I zhvilloi një analizë cilësore dhe sasiore duke ofruar krahas analizave racionale e narrative, edhe të dhëna faktike/numerike.

## **2.1 Analiza e të dhënave të mbledhura nga fokus grupet**

Ndonëse kanë kaluar mbi gjashtë vjet nga nënshkrimi i marrëveshjeve të ratifikuara me ligj midis Qeverisë shqiptare dhe komuniteteve fetare në Shqipëri dhe angazhimit të marrë për një qasje prioritare ndaj pronave të këtyre komuniteteve, përsëri kthimi dhe kompensimi i pronave për këto komuniteteve vazhdon të mbetet i ngadaltë dhe i përealizuar plotësisht.

Megjithëse ishte perceptuar se hartimi dhe nënshkrimi i këtyre marrëveshjeve do të lehtësonte dhe përmirësonte në mënyrë kapilare procesin e kthimit dhe kompensimit të pronave, realiteti tregon më së miri se zbatimi i këtyre marrëveshjeve nuk ka qenë i plotë dhe konform dispozitave përkatëse. Mosadresimi i duhur i kësaj çështjeje, në kundërshtim me vetë kuadrin ligjor të miratuar, ka ndikuar dhe mund të ndikojë më tej drejtpërdrejtë në cenimin e ushtrimit të lirisë fetare të këtyre komuniteteve.

### ***2.1.1 Zbatimi i legjislacionit në fuqi***

Deri më sot legjislacioni në fushën e pronësisë nuk ka parashikuar ndonjë dispozitë të veçantë ku i jep përparësi trajtimit ligjor të pronave të komuniteteve fetare. Ligji nr.9235, datë 29.07.2004 “Mbi kthimin dhe kompensimin e pronave”, i ndryshuar, përcakton faktin që të gjithë subjektet e shpronësuara gëzonin të drejtën për të kërkuar të drejtën e pronësisë dhe të kthimit/kompensimit të pronave të tyre, nëse prona iu është marrë nga shteti pas 29 nëntorit 1994.<sup>126</sup>

---

<sup>126</sup> Neni 2 i ligjit nr.9235, datë 29.07.2004 “Mbi kthimin dhe kompensimin e pronave”, i ndryshuar .

Edhe ligji i ri i miratuar së fundmi dhe i shumëdebatuar për përmbajtjen e tij<sup>127</sup> për kthimin dhe kompensimin e pronave, nuk përmend në asnjë dispozitë të tij në mënyrë specifike çështjen e kthimit dhe kompesimit të pronave të komuniteteve fetare apo përparësinë që këto komunitete duhet të kenë në raport me subjektet e tjera të shpronësuara, si në procesin e njohjes ashtu dhe në procesin e trajtimit të kërkesave e më pas. Në këtë kuptim, komunitetet fetare nuk kanë qenë pjesë aktive e rishikimeve ligjore, madje megjithëse janë pjesë e grupeve të interesit, nuk janë ftuar asnjëherë dhe nuk u bënë aktorë të tryezave të diskutimit dhe dhënies së opinionëve në lidhje me këtë ligj.

Pavarësisht sa më sipër, është për t'u përmendur edhe fakti që vetë komunitetet fetare janë përpjekur individualisht që të ngrenë shqetësimet e tyre që vijnë si pasojë e moszbatimit të plotë të marrëveshjeve me Qeverinë shqiptare, por që në unison, si komunitete dhe palë interesi, nuk e kanë adresuar asnjëherë këtë çështje para strukturave shtetërore.

Marrëveshjet e lidhura me komunitetet fetare, përcaktojnë dhënien e të drejtës së komuniteteve fetare për kthimin dhe kompesimin e pronave që lidhen me objektet e kultit, ndërkohë që komunitetet fetare zotërojnë edhe prona të tjera të paluajtshme të tilla si pyje, kullota, apo toka bujqësore. Po kështu, secila marrëveshje ka specifikën e saj në lidhje me detyrimin që ka shteti kundrejt komuniteteve. Kështu në marrëveshjen me Selinë e Shenjtë, në nenin 8 thuhet shprehimisht se *“Republika e Shqipërisë do të kthejë pronat e Kishës Katolike, në përputhje me legjislacionin shqiptar, dhe do të asistojë riregjistrimin e tyre në emrin e Kishës Katolike në zyrat kompetente shtetërore”*. Pa diferencuar këtu, llojet e pronave (nëse përfshihen vetem objekte kulti apo jo).

Megjithatë, po kjo marrëveshje në nenin 9 të saj identifikon dhe mundësinë e ngritjes së mekanizmave përkatës, në rast se ka çështje të dyshimta, të pazgjidhura (rasti i pronave) dhe të diskutueshme. Kështu neni 9 përcakton se Kisha Katolike në Shqipëri dhe autoriteti kompetent në Republikën e Shqipërisë do të krijojnë një komision ad hoc të përbashkët me detyrën për të gjetur zgjidhje të pranueshme nga të dyja palët. Deri më sot, duket se

<sup>127</sup> Ligji nr. 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”.

ngritja e një komisioni të tillë për çështje që lidhen me të drejtat pronësore të komunitetit katolik nuk është mundësuar.

Në një mënyrë më të veçantë, Marrëveshja me Komunitetin Mysliman të Shqipërisë përcakton duke shkuar më tej në procesin e legalizimit. Kështu në nenin 21 pika 3, thuhet se *“Këshilli i Ministrave merr përsipër që për objektet e kultit të paregjistruara të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë të ndihmojë në procesin e legalizimit, i cili do të kryhet me regjistrim në bazë të kërkesës dhe dokumentacionit teknik të paraqitur nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, në bazë të legjislacionit në fuqi”*. Ndërkohë në nenin 22 të po kësaj marrëveshjeje shteti shqiptar angazhohet të trajtojë me përparësi kërkesat e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë për kthimin dhe kompensimin e pronave të veta.

Po kështu, parashikohet edhe në marrëveshjen me Kryegjyshatën Botërore Bektashiane, në nenin 22 të saj thuhet se *“Shteti do t’i kthejë dhe kompensojë Kryegjyshatës Botërore Bektashiane të gjitha pronat, me përparësi objektet e kultit tashmë të njohura nga të gjithë, të cilat kanë qenë për shekuj qendra shpirtërore dhe kulturore të komunitetit bektashian dhe përbëjnë historinë e këtij komuniteti, si objektet e kultit, vendet e shenjta, sendet e kultit dhe arkivat e saj të konfiskuara nga regjimi komunist”*.

Nëse për KMSH trajtimi i kërkesave do të kryhet me përparësi për të gjitha pronat, në marrëveshjet me komunitetet e tjera, shteti shqiptar e vë përparësinë në objektet e kultit dhe nuk është e qartë nëse edhe pasuritë e tjera mund të kenë po të njëjtën përparësi. Por në një interpretim më të detajuar, por edhe me një dëshirë të mirë institucionale, përparësia mund t’u jepet edhe pronave të tjera të tyre.

Po kështu, e njëjta dispozitë parashikohet në nenin 22 të marrëveshjes me Kishën Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, në të cilin theksohet se shteti do t’i kthejë dhe kompensojë Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë të gjitha pronat, me përparësi objektet e kultit tashmë të njohura nga të gjithë, të cilat kanë qenë për shekuj qendra shpirtërore dhe kulturore të komunitetit ortodoks dhe përbëjnë historinë e këtij komuniteti, si objektet e kultit, manastiret e shenjta, pasuritë, arkivat e saj, të konfiskuara nga regjimi komunist, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Me pjesën e “pasurisë”,



mund të përfshihen të dyja kuptimet, si të sendeve të luajtshme, ashtu dhe atyre të paluajtshme. Ndaj dhe ky nen lë mundësi për interpretim ligjor.

Të gjitha marrëveshjet, me përjashtim të asaj me Selinë e Shenjtë, parashikojnë angazhimin e shtetit shqiptar, konkretisht të Agjencisë për Trajtimin e Pronave që në rastet kur objektet e kultit nuk gjenden të regjistruara në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Agjencia do ta vërtetojë (provojë) nëpërmjet dokumenteve të Arkivit Qendror të Shtetit ekzistencën e pronësisë. Lidhur me këtë të fundit, komunitetet përkatëse janë shprehur mirënjohës për ndihmën e pakursyer të dhënë nga institucionet në fjalë, përfshirë këtu edhe Arkivin Qendror të Shtetit. Dhe kjo gadishmëri është vërejtur pavarësisht kapaciteteve të reduktuara të një pjese të institucioneve të cilat janë ngarkuar me ligj për zbatimin e legjislacionit në fuqi në fushën e të drejtës pronësore.

Marrëveshjet u kanë akorduar këtyre komuniteteve një status special, edhe për sa i përket detyrimeve të tyre financiare sidomos atyre lidhur me procesin e regjistrimit.<sup>128</sup> Kështu komunitetet përjashtohen nga të gjitha llojet e taksave për ndërtimin e objekteve të reja, ndërtesave në pronësi ose në përdorim të komuniteteve fetare, ose të personave juridikë të themeluar prej saj të regjistruar pranë organeve kompetente shtetërore, në rastet kur ato përdoren pa qëllim fitimi për ushtrimin e besimit, drejtimin dhe administrimin fetar, veprimtarinë baritore, humanitare e bamirëse, formimin e klerikëve, mësimin e teologjisë dhe shkencave të tjera fetare, si dhe të personelit fetar dhe laik në shërbim të komuniteteve fetare. Gjithashtu komunitetet përjashtohen edhe nga taksat që lidhen me trashëgimin ose me të drejtën e kalimit të pasurisë në procesin e regjistrimit të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, të cilat i dhurohen përkatësisht komuniteteve në fjalë. Në takimet në fokus grupe përfaqësuesit e komuniteteve fetare shprehën kërkesën për përjashtimin nga të gjitha llojet e tarifave në lidhje me procedurat për rifitimin e së drejtës së pronësisë (depozitimi i vendimeve në gjykatë, aplikimeve në hipotekë, aplikimeve në ATP, etj.)

---

<sup>128</sup> Neni 15 i marrëveshjeve të lidhura ndërmjet Këshillit të Ministrave dhe komuniteteve fetare.

### ***2.1.2 Situata e kthimit dhe kompensimit të pronave të komuniteteve fetare***

Në vitin 2012, në sajë të një vendimi pilot të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut,<sup>129</sup> Agjencia për Trajtimin e Pronave (dikur AKKP) nisi punën për verifikimin e gjithë situatës së procesit të kthimit dhe kompensimit të pronave, që nënkuptonte: vendimet e miratuara, pronat e kthyera, kompensimet, sipërfaqen e tyre, si dhe dosjet që janë në shqyrtim dhe të patrajuara nga kjo agjenci.

Nga informacionet e dhëna nga ATP, rezulton se janë rreth 236 kërkesa nga komunitetet fetare nga rreth 10 000 mije dosje që kjo Agjenci ka në trajtim për të gjithë subjektet e shpronësuara. Nga rreth 26 000 mijë vendime për kthim dhe kompensim, 276 prej tyre i përkasin komuniteteve fetare.<sup>130</sup> Ndërkohë që konstatohet se prej vitit 2013, nga ATP nuk është shqyrtuar asnjë dosje dhe nuk është nxjerrë asnjë vendim lidhur me të drejtën e kthimit dhe kompensimit për komunitetet fetare.

Mungesa e mekanizmave zbatues të nevojshëm për jetësimin e marrëveshjeve të nënshkruara me komunitetet fetare, si dhe nevoja për ofrimin e burimeve të nevojshme njerëzore dhe financiare për Agjencinë e Trajtimin të Pronave, në mënyrë që të jetë në gjendje të kryejë funksionet e saj brenda afateve të duhura, mbeten sfidat kryesore me qëllimin që të ketë një proces të suksesshëm të kthimit dhe kompensimit të pronave për komunitetet fetare. Për këtë qëllim nevojitet përcaktimi i një fondi dhe skeme të veçantë kompensimi financiar për komunitetet fetare, pasuritë e paluajtshme të cilave, preken nga ndërtimet informale (ALUIZNI).

Pavarësisht më sipër, mungesat financiare apo mungesat e kapaciteteve në ATP nuk duhen parë si argumente justifikuese, por si argumente që duhen trajtuar seriozisht për realizimin e procesit nga Qeveria shqiptare. Mungesa në burime njerëzore dhe financiare të ATP-së nuk mundësojnë realizimin dhe trajtimin në tërësi të çështjeve brenda afateve të përcaktuara, dhe vonesat e gjata, mbivendosjet e pasurisë dhe inkosistenca e vendimeve të

<sup>129</sup> Vendimi i GJEDNJ, Çështja Manushaqe Puto dhe të tjerë kundër Shqipërisë, 31 korrik 2012.

<sup>130</sup> Në muajin Maj 2015, ATP përfundoi procesin e identifikimit të gjithë dosjeve pjesë e Arkivës së vet, të cilat nuk kanë kaluar në fazën e shqyrtimit administrativ dhe marrjen e një vendimi përfundimtar.

marra në lidhje me pronat e komuniteteve fetare, kanë krijuar probleme të cilat kanë rezultuar në debate të forta politike, madje dhe në përplasje ndërmjet institucioneve. Një nga rastet më të njohura është çështja e një prone në qendër të Tiranës, e cila me vendim të Këshillit të Ministrave iu dha në fillim Komunitetit Mysliman Shqiptar, vendim i cili u shfuqizua më vonë dhe rezultoi në një përplasje ndërmjet Policisë së Shtetit dhe Policisë Bashkiake.

Është e rëndësishme të theksohet se Këshilli i Ministrave ka miratuar disa vendime në lidhje me kthimin dhe kompesimin e pronave për të katër komunitetet fetare<sup>131</sup> por që pavarësisht se mbështetur në marrëveshjet midis Qeverisë dhe komuniteteve fetare mund të konsiderohen si raste sporadike krahasuar me numrin e përgjithshëm të çështjeve të pronësisë të këtyre komuniteteve.

Gjatë tre viteve të fundit, janë marrë rreth 148 vendime që lidhen me shpërndarjen e kompensimit financiar për të gjitha subjektet e shpronësuara, nga ku rezulton që të jetë kompesuar një sipërfaqe prej 26,966 m<sup>2</sup>, me një vlerë kompesimi financiar prej 600,869,402 lekë.<sup>132</sup> Nga gjithë kjo shumë kompensimi, rezulton që komunitetet fetare të kenë perfituar, si më poshtë:

- Për KSSH është bërë kompesimi në çmimin e vlerës së tregut për 2220 m<sup>2</sup> sipërfaqe të zënë nga ndërtime informale të cilat janë legalizuar;
- Për KOASH janë 691 m<sup>2</sup>;
- Për KMSH janë 3390 m<sup>2</sup> dhe,
- Për KBB janë vetem 108 m<sup>2</sup>.

### **2.1.3 Situata në procesin e legalizimit të pasurive**

Një problematikë tjetër e konstatuar që lidhet me pronat e komuniteteve fetare është dhe *problemi i legalizimeve të objekteve të kultit*. Në përputhje

<sup>131</sup> Për shembull: VKM nr. 497, datë 21.6.2013 “Për kalimin e sipërfaqes prej 300 m<sup>2</sup>, truall, pronë shtetërore, në pronësi të myftinisë Tiranë, për ndjekjen e procedurave ligjore që nevojiten për ndërtimin e xhamisë “Selitë” dhe VKM nr.273, datë 3.4.2013 “Për kalimin e një sipërfaqeje trualli, pronë shtetërore, në fondin e kompesimit fizik dhe kompesimin e KMSH, si dhe për një ndryshim në VKM nr.834, datë 13.12.2006 “Për miratimin e listës së pjesshme të pronave të paluajtshme shtetërore, në Bashkinë Tiranë të Qarkut të Tiranës”.

<sup>132</sup> Informacion i marrë nga ATP.

me kuadrin ligjor në fuqi, Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave Informale (ALUIZNI), si institucioni përgjegjës për realizimin e procesit të legalizimit, urbanizimit dhe integritit të ndërtimeve informale, në momentin që një objekt apo ndërtim pa leje është i vetëdeklaruar si objekt kulti, përpara se t'i nënshtrohet procedurave të kualifikimit për legalizim, merr paraprakisht miratimin nga Komiteti Shtetëror i Kulteve dhe më pas vazhdon me regjistrimin e objektit.

Gjatë kontakteve të zhvilluara me përfaqësues të këtij institucioni, u nënvizua fakti se kjo strukturë i zbaton me përpikmëri marrëveshjet të cilat janë lidhur ndërmjet qeverisë shqiptare dhe komuniteteve fetare, ku parashikohen procedura lehtësuese përsa i përket legalizimit të objekteve të kultit.<sup>133</sup>

Në bazë të të dhënave të deklaruara nga ALUIZNI nga viti 2006 deri në vitin 2014 rezultojnë 957 objekte kulti dhe objekte ndihmëse informale të ndërtuara nga komunitetet fetare. Në përputhje me procedurat dhe rregullat përkatëse, kur identifikohen si objekte ndihmëse, ALUIZNI bën verifikimet e duhura për të konstatuar nëse rezultojnë si objekte kulti ose jo.

*Nga viti 2006 deri në vitin 2014 janë dhënë vetëm 31 leje legalizimi për komunitetet fetare,<sup>134</sup> një shifër kjo që tregon në realitet numrin e ulët të vendimeve të dhëna për legalizimin e objekteve të kultit. Ndërkohë që ALUIZNI i është drejtuar zyrtarisht të gjitha strukturave të varësisë duke i kërkuar që çështjet e pronave të komuniteteve fetare të trajtohen me përparësi, duke rënë dakord dhe me Komitetin Shtetëror të Kulteve për nënshkrimin e një marrëveshjeje bashkëpunimi në një kohë sa më të shpejtë.*

Duke iu referuar kuadrin ligjor në fuqi, konstatohet se në rast se objekti është i ndërtuar nga subjekte të tjera private mbi truallin në pronësi të komuniteteve fetare, ALUIZNI i skualifikon aplikimet e subjekteve private dhe kalon dokumentat përkatëse të truallit objekt kërkesë për procedurë tek inspektoriati ndërtimor. Ndërsa në rastet kur objektet e kultit janë ndërtuar në pronësi të të tretëve (kryesisht në tokë publike), në këtë rast kalimi i pronësisë bëhet falas në favor të komuniteteve fetare nga ana e shtetit shqiptar, ashtu sikurse është përmendur më sipër.

<sup>133</sup> Nenet 21 të marrëveshjeve ndërmjet Këshillit të Ministrave me komunitetet fetare.

<sup>134</sup> Nga viti 2006 deri në vitin 2013 janë dhënë vetëm 7 leje legalizimi për komunitetet fetare. Nga viti 2013 deri në vitin 2014 janë dhënë 18 leje legalizimi.

Ndërsa në rastet kur një subjekt privat ka ndërtuar në pronësi të komuniteteve por jo në truallin funksional të tyre, atëherë bëhet kalimi i pronësisë me vendim të Këshillit të Ministrave dhe miratohet kompensimi për komunitetet fetare. ATP-ja gjithashtu shpërndan në vijimësi për pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale (ALUIZNI) fondin special jo buxhetor të kompensimit financiar të tyre.<sup>135</sup>

Megjithatë, ndërtimet e paligjshme të ndërtuara në pronat e komuniteteve, ngrenë pikëpyetjen nëse këto ndërtime do të duhen të legalizohen ose jo, duke pasur në konsideratë faktin se pavarësisht se u janë njohur dhe kthyer komuniteteve fetare, ato praktikisht nuk i kanë në administrim dhe nuk arrijnë që t'i shfrytëzojnë në funksion të veprimtarisë së tyre fetare. Për këtë arsye do të ishte e udhës, që identifikimi dhe procedimi i përshpejtuar në këto raste do të mundësonte një zgjidhje të shpejtë dhe efektive në drejtim të procesit.

## **2.2 Situata e pronave të komuniteteve fetare**

Nisur dhe nga qëllimi dhe metodologjia e këtij studimi, një nga faktorët kyç (përveç institucioneve shtetërore) në vlerësimin sa më real të situatës në këtë fushë, janë dhe vetë komunitetet fetare. Për këtë arsye, janë bërë të gjitha përpjekjet maksimale për të marrë të dhëna të sakta në lidhje me procesin e kthimit dhe kompesimit të pronave të komuniteteve fetare, nëpërmjet ballafaqimit të të dhënave dhe problematikave të ngritura nga të gjithë aktorët e përfshirë, duke synuar dhënien e një panorame sa më reale dhe ofrimin e një tërësie rekomandimesh, zbatimi i të cilave mund ta shpejtojë këtë proces. Pavarësisht sa më sipër, vërehet se edhe vetë komunitetet kanë mangësi në bazën e të dhënave të tyre.

### **2.2.1 Komuniteti Mysliman Shqiptar**

Komuniteti Mysliman Shqiptar konsiderohet si një nga pronarët më të mëdhej në rang kombëtar (i dyti pas shtetit), ku përfshihen jo vetëm objektet e kultit por edhe troje, kullota, varreza, pemëtore etj. Nga të dhënat

---

<sup>135</sup> Aktualisht masa e shpërblimit është 57 % e vlerës së miratuar. ATP, pasi siguroi fondet e mjaftueshme, ka bërë gati procedurën për miratimin e kështit të pestë me 13% të vlerës, duke arritur kështu që shpërblimi për këto pronarë të realizohet në masën 70%.

e deklaruara nga përfaqësues të KMSH,<sup>136</sup> rezulton se pranë ATP janë në proces rreth 500 dosje të shpërndara në të gjithë territorin e Republikës,<sup>137</sup> ndërkohë që pranë ALUIZNIT janë paraqitur vetëdeklarime për mbi 700 xhami të palegalizuara, ndërkohë që deri tani vetëm 5 objekte kulti kanë marrë dokumentin e legalizimit.

Në lidhje me procesin e kthimit dhe kompesimit të pronave, konstatohet se nuk ka patur vetëm kthime por edhe kompensime apo marrje vendimi për njohje. Nga aplikimet që janë bërë në ATP, deri më tani janë kthyer rreth 30% e pronave që i përkasin KMSH, kthime të cilat rezultojnë në zona me përparësi si psh, qarku i Tiranës.

Problemi me pronat e kthyera qëndron në faktin se një pjesë e tyre janë sipërfaqe të tëra të zëna me objekte që janë në proces legalizimi dhe praktikisht nuk mund të përdoren apo shfrytëzohen nga KMSH. Ekzistojnë praktika, ku për shkak të procesit të legalizimit të objekteve të ndërtuara në pronat e këtij komuniteti, është bërë kompensimi në vlerë monetare.

Kompensimi financiar dhe në natyrë (fizik) është kryesisht në zonat urbane, për faktin se edhe ndërtimet në proces legalizimi ndodhen në këto zona, kryesisht në Tiranë. Ajo që theksohet nga përfaqësues të këtij komuniteti, është fakti se ekziston një mirëkuptim nga të gjithë institucionet shtetërore për pronat e këtij komuniteti, por për shkak të burokracisë shtetërore dhe problemeve që hasen në të gjithë administratën shqiptare, bën që zgjidhja e këtyre problematikave të zgjaten dhe të mos adresohen në kohën dhe mënyrën e duhur.

Mosrakordimi i shifrave, përsa i përket numrit të dosjeve të paraqitura në institucionet përkatëse, është një tjetër shqetësim që duhet të gjejë një zgjidhje sa më të shpejtë. Ndërkohë që sipas të dhënave të deklaruara nga ATP numërohen rreth 236 dosje të paraqitura për gjithë komunitetet fetare, vetëm KMSH pretendon që janë rreth 500 dosje të paraqitura dhe të patrajtuara nga ATP.

---

<sup>136</sup> Takimi i dates 29.12.2015

<sup>137</sup> Rekord është Shkodra me 133 dosje që janë të pakthyera, vazhdon Elbasani me 70 dosje, Kavaja me 57 dosje.

Sipas argumenteve të paraqitura nga KMSH, kjo kontradiktë në shifra mund të vijë si pasojë e faktit se ATP nuk arrin të evidentojë dosjet e paraqitura nga komuniteti pasi ato mund të jenë hapur në emër të personit fizik<sup>138</sup> dhe jo në emër të KMSH, gjë e cila bën që shifrat të mos jenë të sakta dhe shpesh kontradiktore. Por sikurse është përmendur edhe më sipër, mungesa e një rakordimi apo shkëmbimi dypalësh dhe të shpeshtë të dy palëve, ka çuar në mangësi të konsolidimit të numrit të saktë.

Kohët e fundit, komuniteti mysliman ka kryer një sërë takimesh me përfaqësues të ATP, duke i paraqitur atyre një informacion të saktë mbi numrin e dosjeve dhe datat e sakta kur janë bërë aplikimet, me qëllim rakordimin e plotë për të gjitha dosjet e paraqitura.

Duke qenë se në Arkivën e Shtetit janë të gjithë regjistrat e pronave, komuniteti mysliman bazuar dhe në marrëveshjen e bashkëpunimit që ka me këtë institucion, ka iniciuar fillimin e një projekti për skanimin e të gjithë dokumentacionit që lidhet me të drejtat e pronësisë, me qëllim dixhitalizimin e tyre dhe krijimin e një arkive elektronike.

Një problem tjetër shqetësues për KMSH janë dhe proceset e shumta dhe të tejpgjatuara gjyqësore, sidomos në Tiranë, ku janë 32 sipërfaqe që i janë kthyer KMSH-së (për disa prej tyre bëhet fjalë për sipërfaqe të medha, 2300 hektare). Për këto sipërfaqe të kthyer ka individë që pretendojnë pronësinë dhe për këtë arsye, i kanë çuar çështjet në procese gjyqësore kundrejt KMSH-së.<sup>139</sup>

## **2.2.2 Kryegjyshata Botërore Bektashiane**

Përsa i përket problemit të njohjes së pronës, për pasuritë që janë marrë dhe kanë vërtetim pronësie, nga përfaqësues të këtij komuniteti<sup>140</sup> u

<sup>138</sup> Në shume raste aplikimi është bërë në emër të myftiut të zonës.

<sup>139</sup> Varri i Bamit ka qënë pronë e komunitetit mysliman që i është njohur këtij komuniteti. Mbi këtë janë ngritur pallate që ose janë legalizuar ndërtimet ose janë të zëna në proces legalizimi ose janë dhënë me parashkrim fitues. Ka edhe raste që kur i është kthyer komunitetit, Bashkia ka shitur një sipërfaqe prej 400 m<sup>2</sup> duke krijuar mbivendosje. Mund të përmend rastin tek Pazari i Ri, i është kthyer komunitetit gjithë vargu i dyqaneve ndërkohë që disa prej tyre janë privatizuar nga shitësit duke krijuar kështu një sërë procesesh gjyqësore

<sup>140</sup> Takimi i zhvilluar me datë me 29.12.2015.

theksua se një pjesë e tyre janë të dhëna me qira dhe një pjesë tjetër janë të bllokuara nga ndërtimet informale. Kërkesat e KBB për të liruar pronat e zëna nga ndërtimet informale nuk kanë patur rezultat dhe për shumë prej tyre ato janë në proces gjyqësor. Edhe sipërfaqet e tjera që kanë ngelur të pazaptuara, nuk mund të shfrytëzohen pasi janë rreth e përqark objektit informal.

Problem tjetër i ngritur me shqetësim nga KBB, është dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme. Pavarësisht se KBB disponon vendime të ATP-së të viteve 1994, 1995 dhe 1996 dhe që në këto vendime janë kthyer prona, ky komunitet nuk ka mundur të regjistrojë *më shumë se 100 hektarë pasi pavarësisht se vendimi i kthimit parashikonte 200 hektarë në fakt legjislacioni deri në vitin 1996 kufizonte regjistrimin deri në 100 hektarë.*

Për t'a zgjidhur këtë problematikë, që prej vitit 2001, ky komunitet me sygjërimin e ZRPP, i është drejtuar në mënyrë të përsëritur ATP-së për shtesë vendimi, por deri sot nuk ka asnjë reagim nga kjo strukturë.

Një shqetësim tjetër i ngritur nga përfaqësues të KBB-së është dhe pagimi i kamatë-vonesave (gjobat) për moskryerje regjistrimi nga ZRPP. Në fakt, rezulton se ATP nuk e ka zbatuar detyrimin e saj ligjor që në momentin e marrjes së vendimit të dërgonte një kopje të tij për regjistrim në ZRPP, duke mos qenë e nevojshme që pronari (në këtë rast komuniteti bektashian) të aplikonte për t'u pajisur me çertifikatë pronësie.

Moszbatimi i këtij detyrimi ligjor nga ATP, ka bërë që pasojat t'i vuajë KBB jo vetëm për faktin se që të regjistrosh këto prona duhet të paguash kamat-vonesat, por edhe për shkak të mbivendosjeve që janë krijuar ndër vite. Dhe këto si pasojë e apatisë institucionale.

Sikurse është raportuar nga ana e këtij komuniteti, ka patur raste që janë kryer privatizime (të objektit dhe sipërfaqes së truallit) dhe pavarësisht se KBB e ka patur të regjistruar pronën, nuk ka marrë pjesë në privatizim dhe prona është privatizuar nga persona të tjerë të tretë. Përsa i përket vendimeve për kompensim, përfaqësuesit e këtij komuniteti u shprehën se gjatë gjithë kësaj kohe, *KBB nuk është kompensuar asnjëherë as financiarisht as fizikisht.*



Natyrisht, që ATP ka dhënë përkatësisht vendimet për kthimin dhe kompensimin e pronave dhe vetëm 3 kërkesa (1000 hektarë) janë të trajtuara. Këto janë vendime të trajtuara që nga viti 1994, 1996 deri në 1998, e që mund të shkojnë në rreth 60% e kërkesave të KBB-së, por në rast se do të llogariteshin në bazë sipërfaqe prone përqindja do të ishte më e ulët.

Problem i rëndësishëm që duhet të theksohet është që pavarësisht që këto prona janë marrë me vendim të ATP-së dhe janë regjistruar në ZRPP, Avokatura e Shtetit (të paktën këto 2 vitet e fundit) ka ndërmarrë iniciativën të kundërshtojë në gjykatë këto vendime të ATP-së, gjë që për mendimin e KKB-së është e papranueshme pasi këto vendime kanë kaluar të gjithë hapat ligjorë, dhe Avokatura e Shtetit ka qenë palë deri në momentin e marrjes së këtij vendimi. Edhe për këtë komunitet fetar, proceset e tejkzgjatura gjyqësore mbeten një problematikë më vete, nga ku rezulton se vetëm në vitin 2015 janë rreth 40 procese gjyqësore me individë dhe me shtetin.

Duke qenë se marrëveshja e nënshkruar me qeverinë shqiptare parashikon vetëm përjashtimin nga të gjitha llojet e taksave por jo të tarifave, ky komunitet ka *ndërmarrë iniciativën, në bashkëpunim dhe me komunitetet e tjera fetare, për të propozuar heqjen e tarifave të depozitimit të vendimit në gjykatë, të aplikimeve në hipotekë, të aplikimeve në ATP, tarifën e marrjes së dokumentacionit në drejtoritë e administrimit të pronave publike*. E gjithë kjo, me synim lehtësimin e efekteve financiare të komuniteteve fetare për çështjen e pronave.

### 2.2.3 Kisha Katolike e Shqipërisë

Në marrëveshjen e lidhur ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Selisë së Shenjtë, në nenin 8 të saj përcaktohet se *“Republika e Shqipërisë do t'i kthejë pronat e Kishës Katolike, në përputhje me legjislacionin shqiptar, dhe do të asistojë në reregjistrimin e tyre në emrin e Kishës Katolike, në zyrat kompetente”*.<sup>141</sup>

Nga informacionet e marra nga përfaqësues të KSSH,<sup>142</sup> rezulton se përsa i takon pasurive të paluajtshme, është kthyer një pjesë e vogël, por pjesa

<sup>141</sup> Ratifikuar me ligjin nr. 8902, datë 23.05.2002.

<sup>142</sup> Takimi i zhvilluar më datë 22.01.2016.

më e madhe e pasurive të paluajtshme që ka pasur KKSH nuk është kthyer. Këtu bëhet fjalë për toka bujqësore, pyje, kullota të cilat janë në pronësi të këtij komuniteti, por nuk janë objekte kulturi.

Ligji i miratuar në vitin 2002<sup>143</sup> ka parashikuar lënien në përgjegjësi të Komisionit Ad hoc zgjidhjen e problematikave të ndryshme, përfshirë edhe çështjet e pronësisë, sikurse është cituar më sipër. Për vetë specifikën e këtij komuniteti, KKSH ka edhe një marrëveshje me shtetin shqiptar (2008), e cila është e karakterit ekonomik dhe fiskal, dhe ku parashikohet se *“nëse në një të ardhme do të lindin problematika të ndryshme të cilat nuk janë të karakterit ekonomik, palët bien dakort për të nënshkruar një marrëveshje shtesë”*.

Për rrjedhojë, KKSH vlerëson se zgjidhja e problematikës, për sa i takon kthimit dhe kompensimit të pronave, duhet të vijë përmes vënies në lëvizje të një instrumenti/mekanizmi eficient të tillë si komisioni Ad hoc, nëpërmjet hartimit dhe nënshkrimit të një marrëveshjeje shtesë.

Nga KKSH nuk u ofruan të dhëna konkrete mbi numrin e vendimeve për kthim apo kompensim, por u theksua fakti se pjesa më e madhe e pronave nuk është kthyer. Ndërsa, është akoma edhe më thellë moszbatimi i vendimeve për kompesimin ose që nuk janë trajtuar akoma. Gjithësesi, ky fakt duhet marrë me rezervë, për aq kohë sa përfaqësuesit e komunitetit nuk kanë dhënë shifra të sakta lidhur me këtë çështje.

Sipas KKSH, kompensim ka pasur vetëm në pak raste, ndërkohë që ka pasur kthim pronash, kryesisht objekte kulturi. Në disa vendime ka kthim *de jure*, por *de facto* disa prej tyre nuk posedohen për efekt të mbivendosjeve, ndërtimeve informale, ose për shkak të proceseve të tejzgjatura gjyqësore.<sup>144</sup>

Në lidhje me procesin e legalizimeve, kërkohet që të jetë më i shpejtë ndërkohë që nuk u dhanë shifra konkrete për këtë proces. Edhe për këtë

---

<sup>143</sup> Neni 9 i ligjit nr. 8902, datë 23.05.2002.

<sup>144</sup> Psh, shtëpia kanonike në qytetin e Durrësit nuk është kthyer sepse jetojnë familje. Ka patur edhe rast për kthim objekti tek Rruga e Kavajës “Zemra e Krishtit” ku vendimi është kthyer disa herë që në vitin 1996, 10 vjet gjyqë, vendime gjyqësore, mbivendosje.

komunitet, konstatohet se nuk ka ndonjë trajtim prioritar në krahasim me subjektet e tjera të shpronësuara përsa i përket procesit të legalizimeve.

KKSH posedon një arkivë të plotë dhe një inventar të hollësishëm në lidhje me çështjet e pronësisë, por dhe në rastet e mungesës së ndonjë dokumentacioni në lidhje me këtë çështje, është bashkëpunuar me Arkivin e Shtetit. Problem madhor për KKSH mbetet mosrespektimi i vendimeve të marra apo mosdhënia e zgjidhjeve në rastet e mbivendosjeve. Sidoqoftë do të ishte e udhës që vetë arkivi i KKSH të ndahej me atë të ATP-së dhe të shikohej mundësia e identifikimit të gabimeve në mbivendosje apo mundësia e identifikimit të problematikave të tjera.

Përveç çështjeve të kthimit dhe kompesimit të pronave, problematika të tjera të ngritura nga KKSH lidhen me çështjet fiskale. Vlerësohet se statusi fiskal përsa i përket taksave dhe tatimeve është i zgjidhur nga pikëpamja ligjore, megjithatë kërkohet të realizohet një reduktim i TVSH-së në rastet e zhvillimit të aktiviteteve bamirëse, humanitare, ndërtimit të objekteve të kultit, objekteve kanonike, apo dhe faturave të energjisë elektrike. Sipas marrëveshjes në fjalë, për ndërtimin e objekteve të kultit, këto komunitete janë të përjashtuara nga tatimet.

#### ***2.2.4 Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë***

Sipas përfaqësuesve të KOASH,<sup>145</sup> marrëveshja e nënshkruar në vitin 2009, në një pjesë të mirë të saj mbetet e pazbatuar. Problem kryesor për këtë komunitet mbetet moskthimi i vendeve të shenjta, manastireve dhe kishave. Kryesisht bëhet fjalë për ato objekte që kanë statusin e monumenteve të kulturës dhe që janë në administrim të shtetit.

Theksohet se ATP nuk ka marrë ende në shqyrtim 175 kërkesa të KOASH, nga 890 të paraqitura, dhe vetëm 10% e pronave janë trajtuar në total. Situata vazhdon të mbetet problematike, gjithashtu, edhe për çështjet që trajtohen nga gjykatat të cilat zvarrisin proceset gjyqësoreose nuk i japin të drejtën komunitetit.

Vështirësi janë hasur edhe në apelimet e Avokaturës së Shtetit, ndaj vendimeve për kthimin dhe kompesimin e pronave, nga komisionet e

---

<sup>145</sup> Takimi i zhvilluar me datë 02.02.2016.

mëparshme të kthimit dhe kompesimit duke e bërë, sipas gjykimit të këtij komuniteti, edhe më të pamundur kthimin e tyre.

Në bazë të marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet Këshillit të Ministrave dhe Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë,<sup>146</sup> në nenin 22, pika 2 të saj përcaktohet se “*Shteti do të kthejë dhe kompesojë KOASH të gjitha pronat, me përparësi objektet e kultit tashmë të njohura nga të gjithë...*”. Mos zbatimi i kësaj marrëveshjeje ka bërë që këto objekte kulturi të bëhen objekt administrimi nga individë apo organizata që nuk njihen nga KOASH.<sup>147</sup>

Shqetësim tjetër për KOASH mbetet dhe moskthimi i objekteve të shenjta liturgjike, relikeve, ikonave dhe arkivave të KOASH, të konfiskuara gjatë regjimit komunist. Pavarësisht kërkesave të vazhdueshme të këtij komuniteti, nuk është ndërmarrë asnjë veprim konkret nga ana e institucioneve shtetërore.

---

<sup>146</sup> Ratifikuar me ligjin nr.10057, datë 22.01.2009

<sup>147</sup> Këtu u përmend rasti i kishës në kalanë e Elbasanit

### **KAPITULLI III**

## **KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME**

Duke analizuar të gjithë këtë situatë, vlerësojmë se për këtë çështje kaq jetike për mbarëvajtjen dhe pavarësinë e komuniteteve fetare, siç është ajo e pronave, kthimi dhe kompensimi i tyre vazhdon të mbetet një problematikë më vete.

Megjithëse u mendua se hartimi dhe nënshkrimi i marrëveshjeve do të ishte një shtysë dhe instrument i fuqishëm që do t'i jepte fund zvarritjeve dhe abuzimeve me pronat e komuniteteve, duke pasur parasysh dhe persekutimin e pashembullt që iu bë atyre nga regjimi komunist, konstatohet me keqardhje që këtyre marrëveshjeve iu kanë munguar instrumentat dhe mekanizmat përkatës zbatues për t'i vënë plotësisht në jetë.

Kuadri ligjor, vendas dhe ndërkombëtar, dëshmon rëndësinë që paraqet mbrojtja e lirive dhe të drejtave të komuniteteve fetare, përfshirë të drejtën e tyre të pronësisë dhe, për vetë specifikën e tyre, komunitetet fetare në Shqipëri duhet të trajtohen si kategori me status të veçantë.

Në këtë drejtim, nevojitet që institucionet shtetërore të vendosin dhe fuqizojnë mekanizmat e bashkëveprimit mes tyre në drejtim të një zgjidhjeje të shpejtë dhe efikase të problemit pronësor të komuniteteve fetare. Vendosja e mekanizmave funksionale dhe përmirësimi i bashkëveprimit në kohë, do të mundësojë shkëmbimin e informacionit dhe të dhënave në kohë reale.

Përfshirja dhe adresimi i kësaj çështjeje në dokumentet strategjike të shtetit shqiptar, do të mundësojë priorizimin e zgjidhjeve dhe zbatimin e marrëveshjeve me efikasitet.

Institucionet përgjegjëse duhet të maksimizojnë shërbimet e tyre kundrejt komuniteteve, por edhe kundrejt partnerëve të tyre institucionale. Kështu sistemi i dixhitalizimit i ngritur pranë ATP-së duhet të aktualizohet në

vazhdimësi, por duhet të jetë dhe i përdorshëm e i aksesueshëm edhe nga institucione të tjera të interesit.

Bazuar në marrëveshjet e nënshkruara, konsiderohet e nevojshme vendosja e urave të bashkëpunimit dhe dialogut të vazhdueshëm midis institucioneve shtetërore dhe komuniteteve fetare, në mënyrë që përpjekjet e secilit prej aktorëve në këtë drejtim të bashkohen, për t'u përkthyer në ndryshime ligjore apo administrative.

Komiteti Shtetëror i Kulteve, si një strukturë ndërlidhëse ndërmjet komuniteteve fetare dhe institucioneve shtetërore, duhet të ndërmarrë një rol më proaktiv në drejtim të advokimit pranë institucioneve ligjzbatuese dhe ofrimit të zgjidhjes së problematikave që lidhen me pronat e komuniteteve fetare.

Por, e parë edhe më gjerë, secila palë duhet të marrë përsipër përgjegjësitë dhe detyrat në funksion të përmirësimit të procesit. Kështu, edhe vetë komunitetet fetare duhet të jenë më proaktive në këtë proces. Do të ishte e rëndësishme që këto komunitete të kishin caktuar pikat përkatëse fokale për të vepruar në një lidhje më të ngushtë dhe periodike me strukturat shtetërore. Dalja e komuniteteve si një zë i vetëm në këtë proces, jo vetëm që do të shtynte më tej interesin politik për zgjidhjen e çështjes, por do të përmirësonte edhe pjesëmarrjen e tyre në proceset e konsultimit si palë interesi.

Nga analiza tërësore e legjislacionit, vlerësimit të zbatimit në praktikë të tij, diskutimeve me të gjithë aktorët e përfshirë në procesin e kthimit dhe kompesimit të pronave të komuniteteve fetare, mbledhjes dhe ballafaqimit të të dhënave të nevojshme dhe të sakta në lidhje me statusin e këtyre pronave si dhe problematikave të hasura, rekomandojmë marrjen në konsideratë, në mënyrë më specifike, të hapave të mëposhtëm:

- i. Krijimi i një mekanizmi të ri dhe efikas për kthimin/kompensimin e legalizimin e pronave të komuniteteve fetare, të shpronësuara gjatë regjimit komunist. Ky mekanizëm mund të adresojë specifikisht mundësi të reja për të përshpejtuar procesin e kthimit/kompensimit/legalizimit dhe afatet e realizimit të tij. Ky mekanizëm mund të konsistojë në ngritjen dhe funksionimin e një *Komisioni të*

përbashkët Ad hoc (mes të gjitha komuniteteve) në përbërje të të cilit të ketë përfaqësues të institucioneve publike dhe të komuniteteve fetare respektive. Në këtë komision mund të trajtohen me prioritet të gjitha rastet e pretenduara për kthimin, kompensimin fizik e financiar dhe legalizimin e pronave të komuniteteve fetare dhe të merren vendimet përkatëse. Komisioni do të ndiqte dhe zbatimin e marrëveshjeve të lidhura ndërmjet Qeverisë dhe komuniteteve fetare si dhe do të merrte në konsideratë propozimet për ndryshimet e mundshme të marrëveshjeve apo nënshkrimin e marrëveshjeve të reja me synim zgjidhjen e problematikave që mund të shfaqen.

- ii. Mundësia e përcaktimit të një fondi dhe skeme të veçantë kompensimi financiar për komunitetet fetare, pasuritë e paluajtshme të të cilave, preken nga ndërtimet informale (ALUIZNI).
- iii. Krijimi i një bashkëpunimi të vazhdueshëm midis përfaqësuesve të komuniteteve fetare dhe institucioneve publike përgjegjëse për çështjet e pronësisë me qëllim identifikimin e saktë të numrit të kërkesave për kthim e kompensim të komuniteteve fetare në mënyrë që të përlllogariten kostot e nevojshme për përfundimin e këtyre proceseve.
- iv. Rritja e bashkëpunimit dhe koordinimit ndër-institucional mes ZRPP, ATP dhe ALUIZNI-t për të siguruar një sistem administrimi të shpejtë, mirë-funksionues dhe të pakontestueshëm.
- v. Rritja e aktivizimit të komuniteteve fetare në ndjekjen e zbatimit të marrëveshjeve të lidhura me Qeverinë shqiptare.
- vi. Krijimi i një platforme diskutimi publik mbi të drejtat e pronësisë të komuniteteve fetare e cila do të mundësonte ngritjen e çështjes në nivel më të lartë dhe do ta bënte atë pjesë të diskutimeve reale mes institucioneve, por jo vetëm. Krijimi i një platforme diskutimi publik do të ketë një përfitim të dyanshëm, si në nivel të trajtimit të përshpejtuar të këtij problemi, ashtu dhe në kontekstin e zbatimit të konventave dhe angazhimeve të tjera ndërkombëtare në kuadër të zbatimit të të drejtave të njeriut.
- vii. Në zbatim të marrëveshjeve të lidhura ndërmjet Qeverisë dhe komuniteteve fetare të shikohet mundësia e përshpejtimit të procesit

të kthimit dhe kompesimit të pronave (në tërësi), procesit të legalizimit për komunitetet fetare. Për këtë qëllim është i nevojshëm identifikimi i instrumentave dhe mekanizmave përkatës për prioritarizimin e kërkesave që lidhen me kthimin dhe kompesimin e pronave komuniteteve fetare nga organet ligjzbatuese, të tilla si ATP, ALUIZNI, ZRPP.

- viii. Diskutimi dhe vlerësimi i propozimeve nga komunitetet fetare për lehtësimin e tarifave (të aplikimeve në hipotekë, në ATP, në gjykatë, në drejtoritë e administrimit të pronave publike, pranë shërbimit përmbarrimor etj), me synim lehtësimin e efekteve financiare të komuniteteve fetare për çështjen e pronave.
- ix. Diskutimi dhe vlerësimi i propozimeve për reduktimin e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) në rastet e ndërtimit të objekteve të kultit, objekteve të tjera me karakter fetar dhe edukativ. Natyrisht, ky propozim mund të jenë objekt i diskutimeve që mund të prodhojnë iniciativa të reja ligjore apo nënligjore.
- x. Forcimi i rolit dhe kompetencave të Komitetit Shtetëror të Kulteve, si strukturë ndërlidhëse ndërmjet Qeverisë dhe komuniteteve fetare, në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me këto komunitete, përfshirë edhe çështjet që lidhen me kthimin dhe kompensimin e pronave.
- xi. Rritja e efikasitetit të sistemit të përmbarrimor, privat apo shtetëror, për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore që lidhen me pronësinë e komuniteteve fetare.
- xii. Marrja në konsideratë e parashikimeve të marrëveshjeve lidhur me trajtimin në mënyrë proritare të të drejtave pronësore të komuniteteve fetare gjatë hartimit të akteve të ndryshme ligjore apo nënligjore si dhe përfshirja e komuniteteve fetare si palë në procesin e konsultimit të projekt-akteve me palët e interesuara.



## Shtojca I

### LISTA E AKTEVE LIGJORE DHE NËNLIGJORE PËR PASURITË E PALUAJTSHME

- Ligji nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private dhe nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”.
- Dekreti i Presidentit të Republikës nr. 378, datë 2.12.1992 “Për faljen e studiove të punës piktoreve dhe skulptorëve”.
- Ligji nr. 7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore”.
- Ligji nr. 7665 datë 21.1.1993 “Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin”.
- Ligji nr. 7699, datë 21.04.1993 “Për kompensimin në vlerë të ish-pronarëve të tokës bujqësore”, i ndryshuar.
- Ligji nr.8312, datë 26.3.1993 “Për tokat bujqësore të pandara”.
- Ligji nr. 7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”.
- Ligji nr.7848, datë 16.08.1994 “Për shpronësimin për interes publik, si dhe për marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë së paluajtshme”.
- Ligji nr. 7980, datë 27.7.1995 “Për shitblerjen e tokave”.
- Ligji nr.7983, datë 27.7.1995 “Për shitblerjen e tokës bujqësore, livadheve dhe kullotave”.
- Ligji, nr. 1254, datë 19.10.1995 “Për kompesimin e ish-pronarëve të trojeve të zëna, të tokës bujqësore dhe jobujqësore, me troje në zonat turistike dhe në qendrat e banuara“, i ndryshuar.
- Ligji nr. 8053, datë 21.12.1995 “Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore”, të ndryshuar.
- Ligji nr. 8312, datë 26.3.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”.
- Ligji nr.8318, datë 1.4.1998 “Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore,të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore”, i ndryshuar.

- Ligji nr.8337, datë 30.4.1998 *“Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore pyjore, livadheve dhe kullotave”*.
- Ligji nr.8561, datë 22.12.1999 *“Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohëshëm të pasurisë pronë private për interes publik”*.
- Ligji nr.8743, datë 22.2.2001 *“Për pronat e paluajtshme të shtetit”*, i ndryshuar.
- Ligji nr.8744, date 22.2.2001 *“Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në qeverisjen vendore”*, i ndryshuar.
- Ligji nr. 9482, datë 3.4.2006, *“Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”*, i ndryshuar.
- Ligji nr. 9948, datë 07.07.2008 *“Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”*, i ndryshuar.
- Ligji nr. 10239, datë 25.2.2010 *“Për krijimin e fondit special të kompensimit të pronave”*.
- Ligji nr.256, datë 13.4.2010 *“Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë së Kthimit dhe Kompesimit të Pronave”*.
- Ligji nr. 57/2012 *“Për përfundimin e procesit të kalimit në pronësi përfutuesve të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore”*.
- Ligji nr.33/2012, datë 21.3.2012 *“Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”*.
- Ligji Nr. 133/2015 *“Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”*.
- VKM Nr.452, datë 17.10.1992 *“Për ristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore”*.
- VKM Nr.301 datë 14.6.1993 *“Për masat për zbatimin e Ligjit “Për kthimin dhe kompesimin e pronave ish-pronarëve” të ndryshuar.*
- VKM Nr.528 datë 13.5.1996 *“Për masat për zbatimin fizik të kompesimit të trojeve në zonat turistike, në zbatim të Ligjit Nr.8084, datë 07.03.1996”*.
- VKM Nr. 537 datë 19.8.1996 *“Për përgatitjen e projektzbatimit të projekteve urbanistike të kompensimit fizik me troje në zonat turistike”*.
- VKM Nr. 500, datë 14.8.2001 *“Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”*, të ndryshuar.
- VKM Nr.566, datë 23.8.2006 *“Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Kthimit dhe Kompesimit të Pronave”*.

- VKM Nr.747, datë 9.11.2006 “Për procedurat e mbledhjes, përpunimit dhe administrimit të akteve të subjekteve të shpronësuara, gjatë procesit të njohjes dhe kthimit apo kompesimit të pronës”.
- VKM Nr. 52, datë 07.2.2007 “Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve të komunikimit, ndërmjet AKKP-së dhe institucioneve shtetërore, gjatë procesit të njohjes, kthimit apo kompesimit të pronës”, të ndryshuar.
- VKM Nr.257, datë 11.4.2007 “Për kriteret dhe procedurën e kompesimit fizik me troje shtetërore, të subjekteve të shpronësuara, në disa raste të veçanta”, të ndryshuar.
- VKM Nr.1077, datë 18.6.2008 “Për krijimin e fondit të kompesimit fizik nga fondi pyjor dhe kullësor”.
- VKM Nr.1232, datë 18.6.2008 “Për krijimin e fondit të kompesimit fizik nga objektet shtetërore”.
- VKM Nr.868, datë 18.6.2008 “Për krijimin e fondit të kompesimit fizik nga fondi i tokës bujqësore”, të ndryshuar.
- VKM Nr.1712, date 24.12.2008 “Për dhënien me qira ose enfiteozë të pasurive shtetërore” të ndryshuar.
- VKM Nr.1696, datë 24.12.2008 “Për krijimin e fondit të kompesimit fizik, nga objekte shtetërore të “Albminiera” Sh.a dhe Shërbimit Gjeologjik Shqiptar”.
- VKM Nr.12, datë 7.1.2009 “Për kushtet dhe procedurën e tjetërsimit të sipërfaqeve të tokës me cilësi të veçanta, për llogari të fondit të kompesimit financiar”, të ndryshuar.
- VKM Nr.200, datë 19.2.2009 “Për përcaktimin e kushteve dhe për procedurën e tjetërsimit të oborreve në përdorim, për llogari të fondit të kompesimit financiar”, të ndryshuar.
- VKM Nr.255, datë 13.4.2010 “Për procedurat e mbledhjes, përpunimit dhe administrimit të akteve të subjekteve të shpronësuara, gjatë procesit të njohjes dhe kthimit apo kompesimit të pronës”.
- VKM Nr.256, datë 13.4.2010 “Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjensinë e Kthimit dhe Kompesimit të Pronave”.
- VKM Nr.267, datë 21.4.2010 “Për përcaktimin e rregullave për bashkërendimin e punës së ALUIZI-t me zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe Agjensinë e Kthimit dhe Kompesimit të Pronave, për procedurat e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi truallin shtetëror në zonat me përparësi turizimi”.

- VKM Nr.383, datë 19.5.2010 *“Për përcaktimin e procedurave të shpërndarjes së fondit të kompesimit në vlerë për pronarët e pasurive të paluajtshme, prone private, që preken nga ndërtimet informale”* të ndryshuar.
- Akti normativ, VKM nr. 3, datë 1.3.2012 *“Për lirimin e banesave pronarëve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish-pronë të subjekteve të shpronësuar”*.
- VKM Nr.405, datë 27.06.2012 *“Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale “Reforma në fushën e të drejtave të pronësisë, 2012-202” dhe të planit të saj të veprimit”*.
- VKM Nr. 578, datë 29.8.2012 *“Për përcaktimin e procedurës së kalimit në pronësi të oborreve në përdorim”*, të ndryshuar.
- VKM Nr. 460, datë 22.5.2013 *“Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”*.
- VKM Nr. 770, datë 12.11.2014 *“Për kalimin në fondin e kompesimit fizik, në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompesimit të Pronave, të sipërfaqes së tokës bujqësore prej 23368.8 ha, në pronësi shtetërore, dhënë në përdorim njësisive të qeverisjes vendore”*.
- VKM Nr.155 date 4.3.1996 *“Për dhënien me qira të objekteve pronë shtetërore dhe privatizimin e objekteve me pronar trualli”*.
- Udhëzim i Këshillit të Ministrave Nr. 15 datë 15.11.1993 *“Për një ndryshim në udhëzimin e këshillit të Ministrave Nr.13, datë 18.10.1993 “Për zbatimin e Ligjit “Për kthimin dhe kompesimin e pronave ish-pronarëve” dhe disa ndryshime në Udhëzimin e Këshillit të Ministrave Nr.3, datë 21.6.1993”*, të ndryshuar.
- Udhëzim i Këshillit të Ministrave Nr. 3, datë 21.6.1993 *“Për zbatimin e Ligjit “Për kthimin dhe kompesimin e pronave ish-pronarëve”*, të ndryshuar.
- Udhëzim i Këshillit të Ministrave Nr.385, datë 16.1.2009 *“Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.1638, datë 17.12.2008 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe për procedurën e shitjes.”*

## **Shtojca 2**

### **LIGJI NR. 8902, DATE 23.5.2002 PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SELISË SË SHENJTË PËR RREGULLIMIN E MARRËDHËNIEVE TË NDËRSJELLA”**

Në mbështetje të neneve 10 pika 5, 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

#### **KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË V E N D O S I:**

##### **Neni 1**

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Selisë së Shenjte për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella”.

##### **Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare. Shpallur me dekretin nr. 3371, datë 14.6.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

#### **MARRËVESHJE NDËRMJET REPUBLIKES SË SHQIPËRISË DHE SELISË SË SHENJTË, PËR RREGULLIMIN E MARRËDHËNIEVE RECIPROKE**

Republika e Shqipërisë dhe Selia e Shenjtë, duke pasur dëshirën e përbashkët për të forcuar dhe zhvilluar, në frymën e miqësisë, marrëdhëniet ekzistuese midis tyre, dhe me qëllimin për të rregulluar përmes një marrëveshjeje të përbashkët statusin juridik të Kishës Katolike në Shqipëri, bien dakord si më poshtë:

### Neni 1

Republika e Shqipërisë garanton lirinë për të shpallur dhe praktikuar në publik Fenë Katolike. Kisha Katolike në Shqipëri ka të drejte të organizohet dhe të plotësojë misionin e saj.

### Neni 2

Republika e Shqipërisë njih zotësinë juridike të personave ligjore për entitete të tilla të Kishës Katolike, të cilat janë të parashikuara në të Drejtën Kanonike, si arkidieqezat, dieqezat apo administratat apostolike famullitë, bashkësitë fetare, misionet, shoqatat, seminarët, shkollat dhe institucionet arsimore të të gjitha niveleve, institucionet shëndetësore, pas regjistrimit të tyre nga organet e drejtësisë.

### Neni 3

Selia e Shenjte dhe Kisha Katolike në Shqipëri gëzojnë lirinë e plotë të komunikimit dhe të korrespondencës me njëra-tjetrën. Republika e Shqipërisë dhe Selia e Shenjtë do të mbajnë marrëdhënie diplomatike në nivelin e Ambasadës dhe Nunciaturës Apostolike.

### Neni 4

Kisha Katolike ka të drejtën të posedojë mjete të veta të komunikimit masiv dhe ka të drejtën të përdorë mjetet publike të komunikimit masiv, në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

### Neni 5

Autoriteti kompetent kishtar ka të drejtë të krijojë strukturat përkatëse të Kishës, e në veçanti, të krijojë dhe të modifikojë personat juridike kishtarë, në përputhje me të Drejtën Kanonike dhe duke respektuar ligjet shqiptare.

Selia e Shenjte është e lirë të zgjedhë një klerik në detyrën e Ipeshkvit ose të Administratorit Apostolik, i cili mund të jetë dhe Ipeshkëv.

Përpara se të publikojë emërimin e Ipeshkvit apo të Administratorit Apostolik, Selia e Shenjtë, për mirësjellje dhe në konfidencë, do të

informojë Presidentin e Republikës së Shqipërisë nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme.

#### Neni 6

Për të plotësuar përgjegjësitë që rrjedhin nga funksioni baritor, Ipeshkvi ose Administratori Apostolik ka të drejtë të ftojë në Shqipëri priftërinj, anëtarë të kongregacioneve rregullatorë dhe persona laike, të cilët nuk kanë nënshtetësinë shqiptare dhe të rekomandojë kërkesën e tyre për leje për rezidence dhe për leje për pune drejtuar autoriteteve shqiptare, në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.

Me kërkesën formale të Ipeshkvit ose të Administratorit Apostolik, leja për rezidence dhe leja për punë, e nënkuptuar kjo për ushtrimin e aktivitetit baritor, do të lëshohen kundrejt një pagese minimale sipas legjislacionit dhe rregullave shqiptare.

#### Neni 7

Kisha Katolike ka të drejtë të hapë dhe të drejtojë shkollat, klinikat dhe qendrat sociale të saj sipas të Drejtës Kanonike dhe në përputhje me ligjet përkatëse të Republikës së Shqipërisë.

#### Neni 8

Republika e Shqipërisë do të kthejë pronat e Kishës Katolike, në përputhje me legjislacionin shqiptar, dhe do të asistojë riregjistrimin e tyre në emrin e Kishës Katolike në zyrat kompetente shtetërore.

#### Neni 9

Në rastet e çështjeve të dyshimta, të pazgjidhura dhe të diskutueshme, të cilat kanë të bëjnë me Kishën Katolike në Shqipëri në përgjithësi ose me komunitetet apo institucionet katolike në veçanti, Kisha Katolike në Shqipëri dhe autoriteti kompetent në Republikën e Shqipërisë do të krijojnë një komision “ad hoc” të përbashkët me detyrën për të gjetur zgjidhje të pranueshme nga të dyja Palët.

### Neni 10

Nëse në të ardhmen do të lindin vështirësi në lidhje me dispozitat e mësipërme, që do të kenë të bëjnë me interpretimin apo aplikimin e tyre, Republika e Shqipërisë dhe Selia e Shenjtë do të procedojnë një marrëveshje të përbashkët për një zgjidhje miqësore.

### Neni 11

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në momentin e njoftimit reciprok për plotësim nga Palët të procedurave të tyre të brendshme të kërkuara për hyrjen e saj në fuqi.

Kjo Marrëveshje mund të zgjidhet prej secilës nga Palët që do të njoftojë Palën tjetër për vendimin e saj me shkrim. Marrëveshja do të pushoje së ekzistuari nëntëdhjetë (90) ditë pas ditës së njoftimit.

PËR REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

PËR SELINË E SHENJTË



## **Shtojca III**

### **LIGJ NR.10 056, DATË 22.1.2009 PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMUNITETIT MYSLIMAN TË SHQIPËRISË PËR RREGULLIMIN E MARRËDHËNIEVE TË NDËRSJELLA”**

Në mbështetje të neneve 10 pika 5, 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

#### **KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË VENDOSI:**

##### **Neni 1**

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Mysliman të Shqipërisë për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

##### **Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6032, datë 29.1.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi.

### **MARRËVESHJE NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMUNITETIT MYSLIMAN TË SHQIPËRISË PËR RREGULLIMIN E MARRËDHËNIEVE TË NDËRSJELLA**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, bazuar nëparimet e lirisë së ndërgjegjes dhe të besimit fetar,

të sanksionuara e garantuara në nenet 10 e 24 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, si dhe në ligjet e tjera në fuqi (më poshtë sipas rastit do të citohen Kushtetuta, ligjet dhe/ose legjislacioni në fuqi), lidhin marrëveshjen si më poshtë (më poshtë do të citohet “Marrëveshja”):

## KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

### Neni 1 Objekti

Kjo Marrëveshje rregullon çështje të marrëdhënieve e të bashkëpunimit midis shtetit dhe Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, në të mirë të secilit dhe të të gjithëve, mbi bazën e parimeve kushtetuese që garantojnë lirinë e shfaqjes dhe të ushtrimit të fesë dhe të bindjeve fetare, si dhe të dëshirës së përbashkët për të forcuar dhe zhvilluar marrëdhëniet e ndërsjella.

### Neni 2 Kuptimi

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë është bashkësi fetare në të cilën përfshihen edhe tarikatet që kanë qenë pjesë e këtij Komuniteti deri në vitin 1967, kur dekretet për komunitetet fetare ushfuqizuan me dekretin nr.4337, datë 13.11.1967.

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë është organizim i personave besimtarë myslimanë që shfaqin, shprehin dhe/ose ushtrojnë bindjet, parimet dhe praktikat fetare të përcaktuara në burimet elegjislacionit islam, shkollën juridike fetare “Hanefi” dhe statutin e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë.

### Neni 3 Qëllimi

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është:

- a) të garantojë realizimin e të drejtave të sanksionuara nga Kushtetuta dhe ligjet në fuqi në lidhje me lirinë e ndërgjegjes dhe të fesë;
- b) të njohë e të garantojë respektimin e të drejtave të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, të statutit dhe traditave të tij, lidhur me

- të drejtat dhe detyrimet e besimtarëve, respektimin e riteve dhe praktikave tradicionale, të institucioneve dhe strukturave të tij, si dhe personave juridikë të themeluar prej tij, për të zhvilluar lirisht misionin e tyre fetar, edukativ e bamirës;
- c) të njohë dhe të garantojë paprekshmërinë e institucioneve myslimane të kultit, për aq sa veprimtaria e tyre nuk vjen në kundërshtim me ushtrimin e lirisë së ndërgjegjes dhe të fesë, me Kushtetutën e ligjet në fuqi, si dhe traditën dhe statutin e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë;
  - d) të garantojë lirinë e individit për të ushtruar fenë islame, për ta shfaqur atë individualisht ose kolektivisht në institucionet fetare myslimane, ose jashtë tyre, nëpërmjet kultit, arsimimit, praktikave ose kryerjes së riteve përkatëse fetare;
  - e) të sigurojë lirinë e individit për të mos u ndaluar dhe as detyruar të bëjë pjesë në bashkësinë fetare myslimane, për të marrë pjesë në praktikat, ritet dhe në strukturat drejtuese të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë;
  - f) të njohë e të garantojë reagimet dhe veprimet e vetë Komunitetit Mysliman të Shqipërisë ndaj deformimeve, prirjeve ekstremizuese apo çdo shfaqjeje tjetër ashpërsie në mjediset e besimtarëvetë vet. Për të gjitha rastet e kësaj natyre, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë njofton organet përkatëse.

Me anë të kësaj Marrëveshjeje, palët angazhohen në sigurimin e lirisë së mendimit, të ndërgjegjes dhe të fesë. Kjo liri nuk mund të bëhet objekt i kufizimeve të tjera nga ato që, të parashikuara me ligj, përbëjnë masat e nevojshme në një shoqëri demokratike, për sigurimin publik, për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve.

#### Neni 4

#### Zbatimi i Marrëveshjes

1. Kjo Marrëveshje i shtrin efektet mbi të gjitha organet dhe institucionet shtetërore që kanë lidhje me fenë dhe me Komunitetin Mysliman të Shqipërisë, si dhe me institucionet dhe personat juridikë të themeluar prej tij.
2. Individët ose grupimet e tyre përfitojnë nga të drejtat e parashikuara nga kjo Marrëveshje, kur marrin pjesë në këtë bashkësi fetare ose në praktikat e saj.

Neni 5  
Parime të përgjithshme

1. Shteti respekton Komunitetin Mysliman të Shqipërisë dhe njeh si përfaqësues të saj vetëm personat e autorizuar nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë dhe garanton mbrojtjen e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë nga çdo person ose grup që pretendon emrin, objektet e kultit, pronat, simbolet dhe vulën e saj.
2. Komuniteti Mysliman i Shqipërisë respekton bashkësitë e tjera fetare të njohura në Shqipëri, besimtarët e tyre dhe ritet që ata praktikojnë.
3. Komuniteti Mysliman i Shqipërisë ka të drejtë të organizohet dhe të realizojë misionin e tij në mënyrë të pavarur nga shteti, duke respektuar parimin e laicitetit të shtetit, Kushtetutën dhe ligjet në fuqi.

Neni 6  
Bashkërendimi me organet shtetërore

1. Në marrëdhëniet e ndërsjella me Komunitetin Mysliman të Shqipërisë, shteti përfaqësohet nga Komiteti Shtetëror për Kultet. Komuniteti Mysliman Shqiptar bashkëpunon me Komitetin për mundësimin dhe realizimin e një komunikimi aktiv me organet dhe institucionet shtetërore.
2. Në marrëdhëniet me organet dhe institucionet shtetërore, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë përfaqësohet nga organet e caktuara prej tij, si dhe përdor vulën dhe shenjat e tij identifikuese.

KREU II  
ORGANIZIMI DHE PERSONALITETI JURIDIK I KOMUNITETIT  
MYSLIMAN TË SHQIPËRISË

Neni 7  
Komuniteti Mysliman i Shqipërisë dhe personat juridikë

1. Shteti njeh dhe respekton personalitetin juridik të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, të reregjistruar në përputhje me këtë Marrëveshje dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi, si dhe të gjitha veprimet e deritanishme të kryera prej tij, për aq sa ato nuk vijnë në kundërshtim me Kushtetutën dhe legjislacionin.

2. Themelimi, struktura, organizimi, objekti i veprimtarisë, administrimi, rregullimi dhe mbarimi i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë si person juridik realizohet në përputhje me rregullat e traditat e këtij Komuniteti, me këtë Marrëveshje dhe me legjislacionin në fuqi.
3. Shteti i njeh Komunitetit Mysliman të Shqipërisë të drejtën për të krijuar institucione e struktura me karakter fetar ose jofetar, të cilat e fitojnë ose e kanë statusin e personit juridik, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Institucionet e strukturat e krijuara nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë mund të ushtrojnë çdo lloj veprimtarie shoqërore, arsimore, shëndetësore e ekonomike, në përputhje me rregullat e këtij Komuniteti, si dhe me legjislacionin në fuqi, që rregullojnë, ndërmjet të tjerave, edhe pajisjen me licenca dhe lejet përkatëse.
5. Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, me vullnetin e tij të lirë, mund të krijojë bashkime fetare, nëpërmjet bashkimit me bashkësi të tjera fetare, me qëllim që të realizohen synimet e përbashkëta. Këto bashkime, edhe nëse nuk regjistrohen si persona juridikë, e fitojnë personalitetin juridik, automatikisht, pas depozitimit të aktmarrëveshjes për krijimin e tyre në Komitetin Shtetëror për Kultet.
6. Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, bashkimet fetare, si dhe personat e tyre fizikë, në të gjitha format e ligjshme të organizimit të tyre, janë persona juridikë jofitimprurës.

## Neni 8

### Personaliteti juridik i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë

1. Komuniteti Mysliman i Shqipërisë njihet si person juridik me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, bazuar në dokumentet e mëposhtme:
  - a) Kërkesa për regjistrimin e personit juridik, paraqitur nga përfaqësuesi ligjor i bashkësisë;
  - b) Akti i themelimit të personit juridik, i firmosur nga përfaqësuesi ligjor i bashkësisë fetare, sipas rregullave të saj, ku, ndërmjet të tjerave, përcaktohen selia, natyra dhe objekti i veprimtarisë.
  - c) Statuti i personit juridik, sipas rregullave të bashkësisë fetare, ku, ndërmjet të tjerave, përcaktohen struktura e organizimit të bashkësisë, organet, drejtuesit dhe funksionarët, si dhe mënyra e emërimit dhe e zgjedhjes së tyre, përfaqësuesit ligjorë të saj,

detyrat dhe kompetencat përkatëse, burimet e financimit dhe mënyrat e mbarimit të personit juridik.

- d) Mendimi i dhënë nga Komiteti Shtetëror për Kultet, i cili konfirmon njohjen e misionit fetar të kërkuarit.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës, të shoqëruar me dokumentet e sipërpërmendura, bën njohjen e personit juridik dhe regjistrimin e tij, nëpërmjet nxjerrjes së vendimit përkatës.

### Neni 9

#### Afati dhe territori i veprimtarisë së personave juridikë të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë

Personat juridikë të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë mund ta ushtrojnë veprimtarinë e tyre me afat të pakufizuar, në një pjesë ose në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas përzgjedhjes së vetë Komunitetit.

### Neni 10

#### Parimet e organizimit dhe të veprimtarisë së Komunitetit Mysliman të Shqipërisë

1. Palët angazhohen për respektimin e parimeve kushtetuese mbi të cilat ndërtohet kjo Marrëveshje dhe do të punohet së bashku për zbatimin e legjislacionit shqiptar në fuqi.
2. Shteti respekton pavarësinë e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë për t'u organizuar e ushtruar veprimtarinë e tij, si dhe për të administruar pasuritë që zotëron, në bazë të parimeve, rregullave, traditave dhe statutit të tij.
3. Parimet , rregullat dhe statuti i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë dhe veprimtaria e tij duhet të respektojë interesat kombëtarë dhe traditën shqiptare, bashkëjetesën dhe tolerancën fetarendërmjet bashkësive fetare në Shqipëri.

### Neni 11

#### Organizimi i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë

1. Në marrëdhëniet me organet, institucionet dhe organizatat e tjera laike e fetare, brenda dhe jashtë vendit, besimtarët e Komunitetit Mysliman

të Shqipërisë përfaqësohen nga organet, funksionarët dhe drejtuesit e formuar, të emëruar a zgjedhur në përputhje me statutin.

2. Komuniteti Mysliman i Shqipërisë ka të drejtë të formojë organet e tij, të emërojë funksionarët dhe drejtuesit e tyre në mënyrë të pavarur, si dhe në përputhje me dispozitat e parashikuara në statutin e tij. Titullari i Komunitetit Mysliman Shqiptar caktohet sipas procedurave dhe kritereve të parashikuara në statutin e këtij Komuniteti.
3. Komuniteti Mysliman i Shqipërisë njofton Komitetin Shtetëror të Kulteve për emërimin e titullarëve të tij.
4. Funksionarëve, drejtuesve dhe organeve të bashkësisë u garantohet liri e plotë e ushtrimit të veprimtarisë fetare, organizative e administrative, në përputhje me aktet e këtij Komuniteti, për aq sa kjo veprimtari nuk vjen në kundërshtim me dispozitat kushtetuese dhe ligjore.

## Neni 12

### Marrëdhëniet me bashkësitë e huaja fetare

1. Komuniteti Mysliman i Shqipërisë ka të drejtë të krijojë dhe të mbajë kontakte me bashkësi fetare të një vendi tjetër ose ndërkombëtare, të marrë pjesë në veprimtaritë e tyre fetare e bamirëse, për aq sa këto kontakte nuk bien ndesh me rendin e brendshëm kushtetues.
2. Komuniteti Mysliman i Shqipërisë ka të drejtë të përfitojë mbështetje financiare dhe/ose materiale nga entitete dhe/ose individë të huaj, për aq sa kjo mbështetje nuk bie ndesh me këtë Marrëveshje dhe me legjislacionin në fuqi.

## KREU III

### STATUSI FINANCIAR

## Neni 13

### Mbështetja financiare ose materiale shtetërore

1. Shteti shqiptar mund t'i japë Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, apo subjekteve juridike të themeluara prej saj, mbështetje financiare ose materiale.
2. Modalitetet dhe kriteret për sigurimin e kësaj mbështetjeje financiare duhet të përcaktohen menjë ligj specifik për mbështetje financiare nga buxheti i shtetit për kultet fetare.

Neni 14  
Regjistrimi në organet tatimore

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, si dhe personat e tij juridikë, duhet të regjistrohen në organet tatimore, sikurse çdo person juridik jofitimprurës, në përputhje me legjislacionin përkatës.

Neni 15  
Statusi juridik dhe fiskal

1. Komuniteti Mysliman i Shqipërisë njeh dhe respekton kuadrin ligjor në Republikën e Shqipërisë në fushën financiare, duke ruajtur tërësisht pavarësinë në administrimin e buxhetit të tij financiar, të krijuar qoftë nga burime të brendshme edhe nga ato të jashtme, në formë dhuratash nga organizma ndërkombëtarë simotra.
2. Përfshihen nga të gjitha llojet e taksave:
  - a) Subvencionet financiare të çfarëdo lloji dhe çdo e ardhur tjetër e ligjshme, si edhe donacionet materiale të destinuara për të realizuar misionin e vet, kur këto të ardhura apo donacione nuk përdoren për përfitime nga organizatorët.
  - b) Ndërtimi i objekteve të reja, ndërtesat në pronësi ose në përdorim të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, ose të personave juridikë të themeluar prej tij të regjistruara pranë organeve kompetente shtetërore, në rastet kur ato përdoren pa qëllim fitimi për ushtrimin e besimit, drejtimin dhe administrimin fetar, veprimtarinë fetare, humanitare e bamirëse, formimin e klerikëve, mësimin e teologjisë dhe shkencave të tjera fetare, si dhe të personelit fetar dhe laik në shërbim të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë.
  - c) Taksa e trashëgimisë ose e kalimit të pasurisë në procesin e regjistrimit të pasurive të luajtshme të paluajtshme të cilat i dhurohen Komunitetit Mysliman të Shqipërisë ose kur ato kalojnë mes entiteteve të vetë Komunitetit Mysliman.
3. Personat juridikë të themeluar nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, por që nuk e kanë zotësinë juridike ose nuk janë regjistruar si organizata jofitimprurëse përpara ratifikimit të kësaj Marrëveshjeje, gëzojnë të drejtën që të regjistrohen në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë sipas nenit 8 të kësaj Marrëveshjeje, brenda dy vjetëve nga dita e hyrjes së saj në fuqi.



4. Përjashtohen nga detyrimi i derdhjes së kontributeve për sigurim shoqëror dhe shëndetësor personeli fetar dhe laik në shërbim të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, me kombësi të huaj, me banim të rregullt në Shqipëri, të cilët nuk përfitojnë asnjë të ardhur apo shpërblim për kryerjen e veprimtarisë së tyre dhe që i kanë derdhur këto kontribute në vendet e origjinës.
5. Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, për personelin klerik dhe laik të tij, si kategori profesionale krejt e veçantë, ka të drejtë shkallëzimin e diferencuar për nivelin e pagës, për efekt kontributeshtë sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe tatimi mbi të ardhurat e personit.
6. Për veprimtaritë me karakter institucional, si: ushtrimi i kultit, drejtimi dhe administrimi i komunitetit, veprimtaria fetare, humanitare dhe bamirëse, formimi i klerit, mësimi i teologjisë dhe i shkencave fetare, Komuniteti Mysliman dhe personat juridikë të themeluar prej tij nuk janë të detyruar të mbajnë regjistër kontabël dhe t'u nënshtrohen standardeve administrative, të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për këtë çështje. Si pasojë, për të tilla veprimtari ato nuk e kanë detyrim që të paraqesin bilancin kontabël vjetor tek organet kompetente shtetërore dhe as ta depozitojnë atë pranë organizmave shtetërorë të caktuar nga legjislacioni në fuqi.

## KREU IV BASHKËPUNIMI NË TË MIRË TË SHTETASVE

### Neni 16 Festat fetare

1. Ditët e festave fetare që do të jenë ditë pushimi vendosen me ligj. Komuniteti Mysliman i Shqipërisë mund të propozojë festa fetare që, sipas mendimit të tij, mund të shpallen ditë pushimi.
2. Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, në përputhje me nevojat fetare të besimtarëve, ka të drejtë të përcaktojë edhe festa të tjera, veç atyre që do të trajtohen me ligj si festa zyrtare, të cilat nuk janë të detyrueshme për sektorin shtetëror publik dhe privat.

### Neni 17

#### Institucionet edukative dhe arsimore të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë

1. Komuniteti Mysliman i Shqipërisë ka të drejtë, në përputhje me kriteret e parashikuara nga legjislacioni në fuqi, të ngrejë dhe të administrojë institucione edukative dhe arsimore të të gjitha niveleve.
2. Komuniteti Mysliman i Shqipërisë dhe shteti angazhohen të respektojnë të drejtën e prindërve për të siguruar edukimin e fëmijëve në përputhje me bindjet e tyre fetare.
3. Shteti e njeh vlefshmërinë e dokumenteve të lëshuara nga këto institucione, sipas kriterëve të caktuar nga legjislacioni në fuqi për arsimin.
4. Komuniteti Mysliman i Shqipërisë dhe shteti hartojnë kurrikulat përkatëse për shkollat fetare jopublike, si dhe bëjnë vlerësimin dhe certifikimin e personelit pedagogjik. Për miratimin e tyre ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës.
5. Gjatë procesit mësimdhënës, shteti dhe Komuniteti Mysliman i Shqipërisë angazhohen që arsimimi i fëmijëve të bazohet mbi të drejtat e njeriut dhe parimet demokratike, të drejtohet në përgatitjen e fëmijëve për një jetë të përgjegjshme në një shoqëri të lirë në frymën e mirëkuptimit, paqes, tolerancës, barazisë gjinore dhe vëllazërisë midis njerëzve, grupeve etnike, kombëtare dhe fetare, ose personave me origjinë tjetër, duke iu kundërvënë racizmit e fanatizmit.

### Neni 18

#### Kryerja e veprimtarive sociale

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë ka të drejtë të ushtrojë veprimtari sociale me karakter ekonomik, edukativ e shëndetësor. Kjo e drejtë përfshin edhe krijimin e mjediseve sociale të përshtatshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### Neni 19

#### Organizatat bamirëse

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë mund të themelojë organizata bamirëse, duke respektuar rregullat e përgjithshme dhe legjislacionin në fuqi.

## Neni 20

### Liria e shprehjes dhe e drejta për informim

1. Shteti dhe Komuniteti Mysliman i Shqipërisë njohin dhe pranojnë mjetet e informimit publik si një element të rëndësishëm për mbrojtjen e lirisë së shprehjes dhe të ndërgjegjes.
2. Komuniteti Mysliman i Shqipërisë ka të drejtë të shprehë dhe të përhapë lirisht bindjet e fesë islame nëpërmjet mjeteve të komunikimit publik, medias së shkruar dhe asaj pamore, si dhe në çfarëdo forme tjetër të njohur ose që do të njihet në të ardhmen.
3. Komuniteti Mysliman i Shqipërisë ka të drejtë të themelojë struktura të komunikimit publik në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në çdo rast përmbajtja që jepet përmes mjeteve të komunikimit masiv nuk duhet të përshkohet nga ide që cenojnë rendin kushtetues, tolerancën fetare, ose që diskriminojnë bashkësitë fetare dhe nxisin grindje ndërfetare.
4. Komuniteti Mysliman i Shqipërisë ka të drejtë të shprehet nëpërmjet mjeteve të komunikimit dhe informimit publik.
5. Komiteti Shtetëror i Kulteve bashkëpunon me Komunitetin Mysliman të Shqipërisë për shkëmbimin e të dhënave dhe informacioneve për nevoja studimore.

## Neni 21

### Objektet e kultit

1. Ndërtesat dhe objektet që shërbejnë për kryerjen e ceremonive fetare konsiderohen të shenjta nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë. Ndërhyrja e autoriteteve në to është e ndaluar, me përjashtim të rasteve të flagrancës, kur një gjë e tillë kërkohet në zbatim të një urdhri të prokurorisë, të një vendimi gjyqësor ose titulli ekzekutiv, ose në rast të kanosjes së një rreziku të afërm.
2. Institucionet përkatëse e në veçanti Komiteti Shtetëror i Kulteve, bashkëpunojnë me bashkësitë fetare për të përcaktuar vendin për ndërtimin e objekteve fetare, në përputhje me nevojat fetare të personave, si dhe mbi bazën e planeve rregulluese urbanistike.
3. Këshilli i Ministrave merr përsipër që për objektet e kultit të përgjithshme të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë të ndihmojë në procesin e legalizimit, i cili të kryhet me regjistrim në bazë të kërkesës dhe dokumentacionit teknik të paraqitur nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, në bazë të legjislacionit në fuqi.

## KREU V ÇËSHTJET E PRONËSISË

### Neni 22 E drejta e pronës

1. Shteti i njeh Komunitetin Mysliman të Shqipërisë të drejtën e pronës mbi sende të luajtshme dhe të paluajtshme me të gjitha elementet përbërëse të saj. Komuniteti Mysliman i Shqipërisë rinjohet sipas kësaj Marrëveshjeje si trashëgimtar i pronave përkatëse të tij.
2. Në përputhje me legjislacionin në fuqi, shteti trajton me përparësi kërkesat e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë për kthimin dhe kompensimin e pronave të veta.
3. Në rastet kur objektet e kultit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë nuk gjenden të regjistruara në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, pronësinë do ta vërtetojë (provojë) nëpërmjet dokumenteve të Arkivit Qendror të Shtetit.

### Neni 23 Mbrojtja e trashëgimisë kulturore fetare

1. Objektet e kultit që kanë statusin e Monumentit të Kulturës t'i kthehen në pronësi Komunitetit Mysliman të Shqipërisë dhe të mbrohen e trajtohen nga ligji për trashëgiminë kulturore.
2. Shteti mund të marrë në përdorim një objekt të kultit vetëm për nevoja e interesa madhorë dhe vetëm pasi të ketë marrë paraprakisht pëlqimin e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë.
3. Këshilli i Ministrave dhe Komuniteti Mysliman i Shqipërisë bien dakord të bashkërendojnë përpjekjet në të ardhmen për të evidentuar, vlerësuar e mbrojtur pasuritë kulturore, si dhe godinat e kultit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, të cilat bartin vlera të kulturës kombëtare materiale e shpirtërore.
4. Instituti i Monumenteve të Kulturës merr pjesë në restaurimin, projektimin dhe ndërtimin e objekteve të kultit në marrëveshje me bashkësitë fetare përkatëse, duke respektuar ligjin nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”.

5. Komuniteti Mysliman i Shqipërisë paraqet në MTKRS (Drejtorinë e Turizmit) listën e objektevetë kultit që janë monumente kulture, për t'u përfshirë ato në planin e turizmit kulturor. Përparësi në planin e turizmit kulturor duhet të kenë ato objekte që janë më të frekuentueshme.

## KREU VI DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

### Neni 24

#### Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Interpretimi dhe zbatimi i kësaj Marrëveshjeje, si dhe zgjidhja e çështjeve të diskutueshme, bëhen mbi bazën e mirëkuptimit midis palëve.
2. Ndryshimet e kësaj Marrëveshjeje mund të bëhen me marrëveshje ndërmjet palëve, në përputhje me Kushtetutën, ligjet në fuqi, si dhe me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

### Neni 25

#### Dispozita të fundit

1. Shteti i njeh Komunitetin Mysliman të Shqipërisë të drejtën të lidhë marrëveshje të veçanta për zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.
2. Kjo Marrëveshje shërben si akt bazë për nënshkrimin e marrëveshjeve të veçanta me Komunitetin Mysliman të Shqipërisë, që ratifikohen në Kuvend.
3. Komuniteti Mysliman i Shqipërisë mund të tërhiqet nga kjo Marrëveshje duke paraqitur një kërkesë me shkrim. Hollësitë rregullohen me marrëveshje të veçantë.

Bërë në Tiranë, më 24.10.2008, në dy ekzemplarë origjinalë.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE  
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

PËR KOMUNITETIN  
MYSLIMANTË SHQIPËRISË

## **Shtojca IV**

**LIGJ NR.10 057, DATË 22.1.2009  
PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET  
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË  
SHQIPËRISË DHE  
KISHËS ORTODOKSE AUTOQEFALE  
TË SHQIPËRISË PËR RREGULLIMIN E  
MARRËDHËNIEVE TË NDËRSJELLA”**

Në mbështetje të neneve 10 pika 5, 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
VENDOSI:**

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6033, datë 29.1.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

**MARRËVESHJE**  
**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS**  
**SË SHQIPËRISË DHE KISHËS ORTODOKSE AUTOQEFALE TË**  
**SHQIPËRISË PËR RREGULLIMIN E MARRËDHËNIEVE**  
**TË NDËRSJELLA**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë, bazuar në parimet e lirisë së ndërgjegjes dhe të besimit fetar, të sanksionuara e garantuara në nenet 10 e 24 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, si dhe në ligjet e tjera në fuqi (më poshtë sipas rastit do të citohen Kushtetuta, ligjet dhe/ose legjislacioni në fuqi), lidhin marrëveshjen si më poshtë (më poshtë do të citohet “Marrëveshja”).

**KREU I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Objekti**

Kjo Marrëveshje rregullon çështjet e marrëdhënies dhe të bashkëpunimit midis Shtetit Shqiptar dhe Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, në të mirë të secilit dhe të të gjithëve, mbi bazën e parimeve kushtetuese që garantojnë lirinë e shfaqjes dhe të ushtrimit të besimit fetar, si dhe të dëshirës së përbashkët për të forcuar dhe zhvilluar marrëdhëniet e ndërsjella.

**Neni 2**  
**Kuptimi**

Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë e kupton dhe e shpreh vetveten ashtu siç përcaktohet në nenin 1 të statutit të saj.

**Neni 3**  
**Qëllimi**

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është:

- a) të garantojë realizimin e të drejtave të sanksionuara nga Kushtetuta dhe ligjet në fuqi në lidhje me lirinë e ndërgjegjes dhe të fesë;

- b) të njohë e të garantojë respektimin e të drejtave të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, të institucioneve dhe strukturave të saj, si dhe të personave juridikë të themeluar prej tyre, për të zhvilluar lirisht misionin e tyre fetar, edukativ e bamirës;
- c) të njohë dhe të garantojë paprekshmërinë e institucioneve të kultit, për aq sa veprimtaria e tyre nuk vjen në kundërshtim me ushtrimin e lirisë së ndërgjegjes dhe të fesë, si dhe me Kushtetutën e ligjet në fuqi dhe me kanonet dhe traditën e shenjtë të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë;
- d) të garantojë lirinë e individit për të zgjedhur ose ndryshuar fenë, për ta shfaqur atë individualisht ose kolektivisht në institucionet fetare, ose jashtë tyre, nëpërmjet kultit, arsimimit, praktikave ose kryerjes së riteve fetare;
- e) të sigurojë lirinë e individit për të mos ndaluar dhe as detyruar të bëjë pjesë në një bashkësi fetare, ose të marrë pjesë në praktikat, ritet dhe në strukturat drejtuese të saj.

Me anë të kësaj Marrëveshjeje, palët angazhohen në sigurimin e lirisë së mendimit, të ndërgjegjes dhe të fesë. Kjo liri nuk mund të bëhet objekt i kufizimeve të tjera nga ato që, të parashikuara me ligj, përbëjnë masat e nevojshme në një shoqëri demokratike, për sigurimin publik, për mbrojtjen e rendit, të shtetit, të shëndetit e moralit publik, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve.

#### Neni 4

#### Zbatimi i Marrëveshjes

1. Kjo Marrëveshje i shtrin efektet mbi të gjitha organet dhe institucionet shtetërore që kanë të bëjnë me fenë, me Kishën Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, si dhe me institucionet dhe personat juridikë të themeluar prej saj.
2. Individët ose grupimet e tyre, përfitojnë nga të drejtat e parashikuara nga kjo Marrëveshje, kur marrin pjesë në Kishën Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë ose në praktikat e saj.



## Neni 5

### Parime të përgjithshme

1. Shteti respekton Kishën Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë dhe njeh si përfaqësues të saj vetëm personat e autorizuar nga Sinodi i Shenjtë i kësaj Kise dhe garanton mbrojtjen e Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë nga çdo person ose grup që pretendon emrin, objektet e kultit, pronat, simbolet ose vulën e saj.
2. Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë ka të drejtë të organizohet dhe të realizojë misionin e saj në mënyrë të pavarur nga shteti, duke respektuar parimin e laicitetit të shtetit, Kushtetutën dhe ligjet në fuqi dhe kanonet e traditën e shenjtë të Kishës Ortodokse. Shteti mbron bashkëjetesën fetare.

## Neni 6

### Bashkërendimi me organet shtetërore

Në marrëdhëniet e ndërsjella me Kishën Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, shteti përfaqësohet nga Komiteti Shtetëror për Kultet. Kisha bashkëpunon me Komitetin për mundësimin dhe realizimin e një komunikimi aktiv me organet dhe institucionet shtetërore.

## KREU II

### ORGANIZIMI DHE PERSONALITETI JURIDIK I KISHËS ORTODOKSE AUTOQEFALE TË SHQIPËRISË

## Neni 7

Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë dhe personat juridikë

1. Shteti njeh dhe respekton personalitetin juridik të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, si dhe të gjitha veprimet e deritanishme të kryera prej saj për aq sa ato nuk vijnë në kundërshtim me Kushtetutën dhe legjislacionin.
2. Themelimi, struktura, organizimi, objekti i veprimtarisë, administrimi, rregullimi dhe mbarimi i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, si person juridik, realizohet në përputhje me legjislacionin në fuqi, me këtë Marrëveshje dhe me kanonet dhe traditën e shenjtë të Kishës Ortodokse.

3. Shteti i njeh Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë të drejtën për të krijuar institucione e struktura me karakter fetar ose jofetar, të cilat e sigurojnë statusin e personit juridik, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Institucionet dhe strukturat e krijuara nga Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë mund të ushtrojnë çdo lloj veprimtarie shoqërore, arsimore, shëndetësore e ekonomike, në përputhje me rregullat e saj, si dhe me legjislacionin në fuqi, që rregullon ndërmjet të tjerave edhe pajisjen me licenca dhe lejet përkatëse.
5. Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë, me vullnetin e saj të lirë, mund të krijojë bashkime fetare, nëpërmjet bashkimit të dy ose më shumë bashkësive, me qëllim që të realizohen synimet e përbashkëta. Këto bashkime, edhe nëse nuk regjistrohen si persona juridikë, njihen nga shteti pas depozitimit të aktmarrëveshjes për krijimin e tyre, në Komitetin Shtetëror për Kultet.
6. Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë, si dhe organizatat e tjera që krijon për ushtrimin e veprimtarisë së saj, në të gjitha format e ligjshme të organizimit të tyre, janë persona juridikë jofitimprurës.

## Neni 8

### Personaliteti juridik i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë

1. Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë, e rinjohur dhe rikonfirmuar nga shteti shqiptar, regjistrohet si e tillë me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe i njihen të gjitha veprimet e mëparshme. Për regjistrimin e saj Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë do të paraqesë dokumentet e mëposhtme:
  - a) Kërkesën për regjistrimin e personit juridik, paraqitur nga përfaqësuesi ligjor i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë (Kryepeshkopi i Tiranës, Durrësit dhe i gjithë Shqipërisë).
  - b) Statutin e Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë.
2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës, të shoqëruar me dokumentet e sipërpërmendura, bën njohjen e personit juridik dhe regjistrimin e tij, nëpërmjet vendimit përkatës.

## Neni 9

### Afati dhe territori i veprimtarisë së personave juridikë të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë

Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë dhe personat juridikë të krijuar prej saj, mund ta ushtrojnë veprimtarinë e tyre me afat të pakufizuar, në një pjesë ose në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas përzgjedhjes së vetë Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë.

## Neni 10

### Parimet e organizimit dhe të veprimtarisë së Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë

1. Palët angazhohen për respektimin e parimeve kushtetuese mbi të cilat ndërtohet kjo Marrëveshje dhe do të punojnë së bashku për zbatimin e legjislacionit shqiptar në fuqi.
2. Shteti respekton pavarësinë e Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë për t'u organizuar e ushtruar veprimtarinë e saj, si dhe për të administruar pasuritë që zotëron, në bazë të parimeve, rregullave, traditave, kanoneve dhe statutit të saj.
3. Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë respekton interesat kombëtarë dhe bashkëjetesën e tolerancën fetare në Shqipëri.

## Neni 11

### Organizimi i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë

1. Në marrëdhëniet me organet, institucionet dhe organizatat e tjera laike e fetare, brenda dhe jashtë vendit, besimtarët e Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë përfaqësohen nga organet, funksionarët dhe drejtuesit e formuar, të emëruar a zgjedhur në përputhje me statutin.
2. Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë ka të drejtë të formojë organet e saj, të emërojë funksionarët dhe drejtuesit në mënyrë të pavarur, në përputhje me dispozitat e parashikuara në statutin e saj. Titullari i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë caktohet sipas procedurave dhe kriterëve të parashikuara në statutin e saj.
3. Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë njofton Komitetin Shtetëror për Kultet për emërimin e titullarit të saj.
4. Funksionarëve, drejtuesve dhe organeve të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë u garantohet liri e plotë e ushtrimit të

veprimtarisë fetare, organizative e administrative, në përputhje me aktet e Kishës, por aq sa kjo veprimtari nuk vjen si kundërshtim me rendin kushtetues dhe ligjor.

#### Neni 12

##### Marrëdhëniet me bashkësitë e huaja fetare

1. Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë ka të drejtë të krijojë dhe të mbajë kontakte me bashkësi fetare të një vendi tjetër ose ndërkombëtare, të marrë pjesë në veprimtaritë e tyre fetare e bamirëse, për aq sa këto kontakte nuk bien ndesh me rendin e brendshëm kushtetues.
2. Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë ka të drejtë të përfitojë mbështetje financiare dhe/ose materiale nga entitete dhe/ose individë të huaj, për aq sa kjo mbështetje nuk bie ndesh me këtë Marrëveshje dhe me legjislacionin në fuqi.

### KREU III

#### STATUSI JURIDIK DHE FINANCIAR

#### Neni 13

##### Mbështetja financiare ose materiale shtetërore

1. Shteti shqiptar mund t'i japë Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, apo subjekteve juridike të themeluara prej saj, mbështetje financiare ose materiale.
2. Modalitetet dhe kriteret për sigurimin e kësaj mbështetjeje financiare duhet të përcaktohen në një ligj specifik për mbështetje financiare nga buxheti i shtetit për kultet fetare.

#### Neni 14

##### Regjistrimi në organet tatimore

Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë, si dhe personat e saj juridikë duhet të regjistrohen në organet tatimore, sikurse çdo person juridik jofitimprurës, në përputhje me legjislacionin përkatës.

## Neni 15

### Statusi juridik dhe fiskal

1. Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë njeh dhe respekton kuadrin ligjor në Republikën e Shqipërisë në fushën financiare, duke ruajtur tërësisht pavarësinë në administrimin e buxhetit të saj financiar, të krijuar qoftë nga burime të brendshme edhe nga ato të jashtme, në formë dhuratash nga kisha dhe organizma ndërkombëtarë simotra.
2. Përfshihen nga të gjitha llojet e taksave:
  - a) Subvencionet financiare të çfarëdo lloji dhe çdo e ardhur tjetër e ligjshme, si edhe donacionet materiale të destinuar për të realizuar misionin e vet, kur këto të ardhura apo donacione nuk përdoren për përfitime nga organizatorët.
  - b) Ndërtimi i objekteve të reja, ndërtesat në pronësi apo në përdorim të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, ose të personave juridikë të themeluar prej saj të regjistruara pranë organeve kompetente shtetërore, në rastet kur ato përdoren pa qëllim fitimi për ushtrimin e besimit, drejtimin dhe administrimin kishtar, veprimtarinë baritore, humanitare e bamirëse, formimin e klerikëve, mësimin e teologjisë dhe shkencave të tjera kishtarë, si dhe të personelit fetar dhe laik në shërbim të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë.
  - c) Taksa e trashëgimisë ose e kalimit të pasurisë në procesin e regjistrimit të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, të cilat i dhurohen Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë ose kur ato kalojnë mes entiteteve të vetë Kishës.
3. Personat juridikë të themeluar nga Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë, por që nuk e kanë zotësinë juridike ose nuk janë regjistruar si organizata jofitimprurëse përpara ratifikimit të kësaj Marrëveshjeje, gëzojnë të drejtën që të regjistrohen në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, sipas nenit 8 të kësaj Marrëveshjeje, brenda dy vjetëve nga dita e hyrjes së saj në fuqi.
4. Përfshihen nga detyrimi i derdhjes së kontributeve për sigurim shoqëror dhe shëndetësor personeli fetar dhe laik në shërbim të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, me kombësi të huaj, me banim të rregullt në Shqipëri, të cilët nuk përfitojnë asnjë të ardhur apo shpërblim për kryerjen e veprimtarisë së tyre dhe që i kanë derdhur këto kontribute në vendet e origjinës.

5. Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë, për personelin klerik dhe laik të saj, si kategori profesionale krejt të veçanta, ka të drejtë shkallëzimin e diferencuar për nivelin e pagës, për efekt kontributesh të sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe tatimi mbi të ardhurat e personit.
6. Për veprimtaritë me karakter institucional, si: ushtrimi i kultit, drejtimi dhe administrimi kishtar, veprimtaria baritore, humanitare dhe bamirëse, formimi i klerit, mësimi i teologjisë dhe i shkencave fetare, kisha dhe personat juridikë të themeluar prej saj nuk janë të detyruar të mbajnë regjistër kontabël dhe t'u nënshtrohen standardeve administrative të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për këtë çështje. Si pasojë, për të tilla veprimtari ato nuk e kanë detyrim që të paraqesin bilancin kontabël vjetor tek organet kompetente shtetërore dhe as ta depozitojnë atë pranë organizmave shtetërorë të caktuar nga legjislacioni në fuqi.

#### KREU IV BASHKËPUNIMI NË TË MIRË TË SHTETASVE

##### Neni 16 Festat fetare

1. Ditët e festave fetare që do të jenë ditë pushimi, vendosen me ligj. Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë mund të propozojë festa fetare që, sipas mendimit të saj, mund të shpallen ditë pushimi.
2. Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë, në përputhje me nevojat fetare të besimtarëve, ka të drejtë të përcaktojë edhe festa të tjera, veç atyre që do të trajtohen me ligj si festa zyrtare, të cilat nuk janë të detyrueshme për sektorin shtetëror publik dhe privat.

##### Neni 17 Institucionet edukative dhe arsimore të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë

1. Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë ka të drejtë, në përputhje me kriteret e parashikuara nga legjislacioni në fuqi, të ngrejë dhe të administrojë institucionet edukative dhe arsimore të të gjitha niveleve.

2. Shteti dhe Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë angazhohen të garantojnë të drejtën e individëve për t'u arsimuar, pa asnjë dallim, duke respektuar të drejtën e prindërve për të siguruar edukimin e fëmijëve në përputhje me bindjet e tyre.
3. Shteti e njëh vlefshmërinë e dokumenteve të lëshuara nga institucionet arsimore fetare, sipas kritereve të caktuara nga legjislacioni në fuqi për arsimin.
4. Shteti dhe Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë hartojnë kurrikulat përkatëse për shkollat fetare jopublike, si dhe bëjnë vlerësimin dhe certifikojnë personelin pedagogjik. Për realizimin e tyre ngarkohet Ministria e Arsimit dhe e Shkencës.
5. Gjatë procesit mësimdhënës, shteti dhe Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë angazhohen që arsimimi i fëmijëve të bazohet mbi të drejtat e njeriut dhe parimet demokratike, të drejtohet në përgatitjen e fëmijëve për një jetë të përgjegjshme në një shoqëri të lirë, në frymën e mirëkuptimit, paqes, tolerancës, barazisë gjinore dhe vëllazërisë midis njerëzve, grupeve etnike, kombëtare dhe fetare ose personave me origjinë tjetër, duke iu kundërvënë racizmit e fanatizmit.

#### Neni 18

##### Kryerja e veprimtarive sociale

Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë ka të drejtë të ushtrojë veprimtari sociale me karakter ekonomik, edukativ e shëndetësor. Kjo e drejtë përfshin edhe krijimin e mjediseve sociale të përshtatshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### Neni 19

##### Organizatat bamirëse

Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë mund të themelojë organizata bamirëse, duke respektuar rregullat e përgjithshme dhe legjislacionin në fuqi.

#### Neni 20

##### Liria e shprehjes dhe e drejta për informim

1. Shteti dhe Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë njohin dhe pranojnë mjetet e informimit publik, si një element të rëndësishëm për mbrojtjen e lirisë së shprehjes dhe të ndërgjegjes.

2. Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë ka të drejtë të shprehë dhe të përhapë lirisht bindjet e saj, nëpërmjet çfarëdo forme ligjore të njohur, ose që do të njihet në të ardhmen.
3. Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë ka të drejtë të themelojë struktura të komunikimit publik, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në çdo rast, përmbajtja që jepet përmes mjeteve të komunikimit masiv nuk duhet të përshkohet nga ide që cenojnë rendin kushtetues, tolerancën fetare, ose që diskriminojnë bashkësitë fetare dhe nxisin grindje ndërfitare.
4. Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë ka të drejtë të shprehet nëpërmjet mjeteve të komunikimit dhe informimit publik.
5. Komiteti Shtetëror për Kultet bashkëpunon me Kishën Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë për nevoja studimore e informuese.

#### Neni 21

#### Objektet e kultit

1. Ndërtesat dhe objektet që shërbejnë për kryerjen e ceremonive fetare konsiderohen të shenjta nga Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë. Ndërhyrja e autoriteteve shtetërore në to është e ndaluar, me përjashtim të rasteve të flagrancës, kur një gjë e tillë kërkohet në zbatim të një urdhri të prokurorisë, të një vendimi gjyqësor ose titulli ekzekutiv, ose në rast të kanosjes së një rreziku të afërm.
2. Paprekshmëria e hapësirës publike garantohet nga shteti. Shteti mbron objektet dhe vendet e caktuara fetare, në përputhje me ligjin.
3. Për nevojat e saj dhe në përputhje me procedurat ligjore, Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë mund të ndërtojë objekte të reja kulti.

#### KREU V

#### ÇËSHTJET E PRONËSISË

#### Neni 22

#### E drejta e pronës

1. Shteti i njeh Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë të drejtën e pronës mbi sende të luajtshme dhe të paluajtshme.



2. Shteti do t'i kthejë dhe kompensojë Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë të gjitha pronat, me përparësi objektet e kultit tashmë të njohura nga të gjithë, të cilat kanë qenë për shekuj qendra shpirtërore dhe kulturore të komunitetit ortodoks dhe përbëjnë historinë e këtij komuniteti, si objektet e kultit, manastiret e shenjta, pasuritë, arkivat e saj, të konfiskuara nga regjimi komunist, në përputhje me legjisllacionin në fuqi.
3. Në rastet kur objektet e kultit (kishat dhe manastiret) e komunitetit ortodoks nuk gjenden të regjistruara në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, pronësinë do ta vërtetojë (provojë) nëpërmjet dokumenteve të Arkivit Qendror të Shtetit.

#### Neni 23

##### Mbrojtja e trashëgimisë kulturore fetare

1. Objektet e kultit që kanë statusin e monumentit të kulturës t'i kthehen në pronësi Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë dhe do të mbrohen e trajtohen nga ligji për trashëgiminë kulturore.
2. Shteti mund të marrë në përdorim një objekt të kultit vetëm për nevoja e interesa madhorë dhe vetëm pasi të ketë marrë paraprakisht pëlqimin e Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë.
3. Këshilli i Ministrave, duke u bazuar edhe në mendimin e Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, bashkërendon përpjekjet në të ardhmen për të evidentuar, vlerësuar e mbrojtur pasuritë kulturore, si dhe godinat e kultit të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, të cilat bartin vlera të kulturës kombëtare, materiale e shpirtërore.

#### KREU VI

##### DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

#### Neni 24

##### Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Interpretimi dhe zbatimi i kësaj Marrëveshjeje, si dhe zgjidhja e çështjeve të diskutueshme, bëhen mbi bazën e mirëkuptimit midis palëve.

2. Ndryshimet e kësaj Marrëveshjeje mund të bëhen me mirëkuptim e marrëveshje midis palëve.

Neni 25  
Dispozita e fundit

1. Shteti i njeh Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë të drejtën që të lidhin marrëveshje të veçanta për zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.
2. Kjo Marrëveshje shërben si akt bazë për nënshkrimin e marrëveshjeve të veçanta me Kishën Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, që ratifikohen në Kuvend.
3. Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë mund të tërhiqet nga kjo Marrëveshje me anë të denoncimit të marrëveshjes së ratifikuar në Kuvend.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE  
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

PËR KISHËN ORTODOKSE  
AUTOQEFALE

## **Shtojca V**

### **LIGJ NR.10 058, DATË 22.1.2009 PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KRYEGJYSHATËS BOTËRORE BEKTASHIANE PËR RREGULLIMIN E MARRËDHËNIEVE TË NDËRSJELLA”**

Në mbështetje të neneve 10 pika 5, 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

#### **KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË VENDOSI:**

##### **Neni 1**

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kryegjyshitës Botërore Bektashiane për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

##### **Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6034, datë 29.1.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

#### **MARRËVESHJE NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KRYEGJYSHATËS BOTËRORE BEKTASHIANE PËR RREGULLIMIN E MARRËDHËNIEVE TË NDËRSJELLA**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Kryegjyshata Botërore Bektashiane, bazuar në parimet e lirisë së ndërgjegjes dhe të besimit fetar, të sanksionuara e garantuara në nenet 10 e 24 të Kushtetutës

së Republikës së Shqipërisë, në marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, si dhe në ligjet e tjera në fuqi (më poshtë sipas rastit do të citohen Kushtetuta, ligjet dhe/ose legjislacioni në fuqi), lidhin marrëveshjen si më poshtë (më poshtë do të citohet “Marrëveshja”).

## KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

### Neni 1 Objekti

Kjo Marrëveshje rregullon çështje të marrëdhënieve dhe të bashkëpunimit midis shtetit shqiptar dhe Kryegjyshitës Botërore Bektashiane në të mirë të secilit dhe të të gjithëve, mbi bazën e parimeve kushtetuese që garantojnë lirinë e shfaqjes dhe të ushtrimit të besimit fetar, si dhe të dëshirës së përbashkët për të forcuar dhe zhvilluar marrëdhëniet e ndërsjella.

### Neni 2 Kuptimi

Kryegjyshata Botërore Bektashiane dhe organizimi i individëve që shfaqin e shprehin të njëjtat bindje e besime fetare dhe janë të regjistruar në regjistrat përkatës të bashkësive.

### Neni 3 Qëllimi

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është:

- a) të garantojë realizimin e të drejtave të sanksionuara nga Kushtetuta dhe ligjet në fuqi në lidhje me lirinë e ndërgjegjes dhe të fesë;
- b) të njohë e të garantojë respektimin e të drejtave të Kryegjyshitës Botërore Bektashiane, të institucioneve dhe strukturave të saj, si dhe të personave juridikë të themeluar prej saj, për të zhvilluar lirisht misionin e saj fetar, edukativ, bamirës;
- c) të njohë dhe të garantojë paprekshmërinë e institucioneve të kultit, për aq sa veprimtaria e tyre nuk vjen në kundërshtim me ushtrimin e lirisë së ndërgjegjes dhe të fesë, si dhe me Kushtetutën e ligjet në fuqi;
- d) të garantojë lirinë e individit për të zgjedhur ose ndryshuar fenë, për ta shfaqur atë individualisht ose kolektivisht në institucionet

fetare ose jashtë tyre, nëpërmjet kultit, arsimimit, praktikave ose kryerjes së riteve fetare;

- e) të sigurojë lirinë e individit për të mos u ndaluar dhe as detyruar të bëjë pjesë në Kryegjyshatën Botërore Bektashiane, ose të marrë pjesë në praktikat, ritet dhe në strukturat drejtuese të saj.

Me anë të kësaj Marrëveshjeje, palët angazhohen në sigurimin e lirisë së mendimit, të ndërgjegjes dhe të fesë. Kjo liri nuk mund të bëhet objekt i kufizimeve të tjera nga ato që, të parashikuara me ligj, përbëjnë masat e nevojshme në një shoqëri demokratike, për sigurimin publik, për mbrojtjen e rendit, të shtetit, të shëndetit e moralit publik, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve.

#### Neni 4

##### Zbatimi i Marrëveshjes

1. Kjo Marrëveshje i shtrin efektet mbi të gjitha organet dhe institucionet shtetërore që kanë të bëjnë me fenë, Kryegjyshatën Botërore Bektashiane, si dhe me institucionet dhe personat juridikë të themeluar prej Kryegjyshatës Botërore Bektashiane.
2. Individët ose grupimet e tyre përfitojnë nga të drejtat e parashikuara nga kjo Marrëveshje, kur marrin pjesë në Kryegjyshatën Botërore Bektashiane ose në praktikat e saj.

#### Neni 5

##### Parime të përgjithshme

1. Shteti respekton dhe mbron bashkëjetesën fetare.
2. Kryegjyshata Botërore Bektashiane ka të drejtë të organizohet dhe të realizojë misionin e saj në mënyrë të pavarur nga shteti, duke respektuar parimin e laicitetit të shtetit, Kushtetutën dhe ligjet në fuqi.

#### Neni 6

##### Bashkërendimi me organet shtetërore

1. Komiteti Shtetëror për Kultet përfaqëson shtetin në marrëdhëniet e ndërsjella me Kryegjyshatën Botërore Bektashiane, e cila bashkëpunon me Komitetin për realizimin e komunikimit aktiv të bashkësisë me organet dhe institucionet shtetërore.

2. Në marrëdhëniet me organet dhe institucionet shtetërore, Kryegjyshata Botërore Bektashiane përfaqësohet nga organet e caktuara prej saj, si dhe përdor vulën dhe shenjat e saj identifikuese.

## KREU II ORGANIZIMI DHE PERSONALITETI JURIDIK I BASHKËSISË FETARE

### Neni 7

#### Bashkësia fetare dhe personat juridikë

1. Shteti njeh dhe respekton personalitetin juridik të Kryegjyshit Botërore Bektashiane të regjistruar në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe me këtë Marrëveshje, si edhe të gjitha veprimet e deritanishme të kryera prej saj, për aq sa ato nuk vijnë në kundërshtim me Kushtetutën dhe legjislacionin.
2. Shteti shqiptar njeh dhe mbron të drejtat e veprimtarisë së Kryegjyshit Botërore Bektashiane.
3. Kryegjyshata Botërore Bektashiane e ka selinë në Tiranë, kryeqyteti i Republikës së Shqipërisë.
4. Kryegjyshata Botërore Bektashiane është organizuar në bazë të statutit të saj, miratuar me vendim të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Ajo ka degët e saj brenda dhe jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, të cilat drejtohen nga Kryegjyshata Botërore Bektashiane, kreu i së cilës është Kryegjyshi Botëror.
5. Themelimi, struktura, organizimi, objekti i veprimtarisë, administrimi, rregullimi dhe mbarimi i Kryegjyshit Botërore Bektashiane si person juridik realizohen në përputhje me rregullat e traditat e Kryegjyshit, me këtë Marrëveshje dhe me legjislacionin në fuqi.
6. Shteti i njeh Kryegjyshit Botërore Bektashiane të drejtën për të krijuar institucione e struktura me karakter fetar ose jofetar, të cilat e fitojnë ose e kanë statusin e personit juridik, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
7. Institucionet e strukturat e krijuara nga Kryegjyshata Botërore Bektashiane mund të ushtrojnë çdo lloj veprimtarie shoqërore, arsimore, shëndetësore e ekonomike, në përputhje me rregullat e Kryegjyshit Botërore Bektashiane, si dhe me legjislacionin në fuqi, që rregullon

- ndërmjet të tjerave edhe me pajisjen me licenca dhe lejet përkatëse.
8. Kryegjyshata Botërore Bektashiane, me vullnetin e saj të lirë, mund të krijojë bashkime fetare, nëpërmjet bashkimit të dy ose më shumë bashkësive, me qëllim që të realizohen synimet e përbashkëta. Këto bashkime, edhe nëse nuk regjistrohen si persona juridikë, njihen nga shteti pas depozitimit të aktmarrëveshjes për krijimin e tyre, në Komitetin Shtetëror për Kultet.
  9. Kryegjyshata Botërore Bektashiane, si dhe organizatat e tjera që krijojnë për ushtrimin e veprimtarisë së saj, në të gjitha format e ligjshme të organizimit të tyre, janë persona juridikë jofitimprurës.

### Neni 8

#### Personaliteti juridik i Kryegjyshit Botërore Bektashiane

1. Kryegjyshata Botërore Bektashiane njihet si person juridik me vendim të Gjykatës së rrethit Gjyqësor Tiranë, bazuar në dokumentet e mëposhtme:
  - a) Kërkesa për regjistrimin e personit juridik, paraqitur nga përfaqësuesi ligjor i Kryegjyshit Botërore Bektashiane;
  - b) Akti i themelimit të personit juridik, i firmosur nga përfaqësuesi ligjor i Kryegjyshit Botërore Bektashiane, sipas rregullave të saj, ku, ndërmjet të tjerave, përcaktohen selia, natyra dhe objekti i veprimtarisë.
  - c) Statuti i personit juridik, sipas rregullave të Kryegjyshit Botërore Bektashiane, ku, ndërmjet të tjerave, përcaktohen struktura e organizimit të Kryegjyshit, organet, drejtuesit dhe funksionarët, si dhe mënyra e emërimit dhe e zgjedhjes së tyre, përfaqësuesit ligjorë të saj, detyrat dhe kompetencat përkatëse, burimet e financimit dhe mënyrat e mbarimit të personit juridik.
  - d) Mendimi i dhënë nga Komiteti Shtetëror për Kultet, i cili konfirmon njohjen e misionit fetar të kërkuarit.
2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës, të shoqëruar me dokumentet e sipërpërmendura, bën njohjen e personit juridik dhe regjistrimin e tij, nëpërmjet vendimit përkatës.

### Neni 9

Afati dhe territori i veprimtarisë së personave juridikë të bashkësisë fetare

1. Kryegjyshata Botërore Bektashiane dhe personat juridikë të krijuar prej saj, mund ta ushtrojnë veprimtarinë e tyre me afat të pakufizuar,

në një pjesë ose në të gjithë territorin, si dhe për ushtrimin e lirisë së besimit të shqiptarëve që jetojnë jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, sipas përzgjedhjes së vetë bashkësisë.

2. Kryegjyshata Botërore Bektashiane pranon detyrimin e rregulluar me statutin e saj dhe rregulloren e brendshme që brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, shërbesat fetare të kryhen në gjuhën shqipe, si dhe titullarët e zgjedhur për drejtimin e bashkësisë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë të jenë me kombësi shqiptare dhe me moral atdhedashës.

#### Neni 10

##### Parimet e organizimit dhe të veprimtarisë së Kryegjyshitës Botërore Bektashiane

1. Palët angazhohen për respektimin e parimeve kushtetuese mbi të cilat ndërtohet kjo Marrëveshje dhe do të punojnë së bashku me zbatimin e legjislacionit shqiptar në fuqi.
2. Shteti respekton pavarësinë e Kryegjyshitës Botërore Bektashiane për t'u organizuar e ushtruar veprimtarinë e saj, si dhe për të administruar pasuritë që zotëron, në bazë të parimeve, rregullave, traditave (kanoneve) dhe statutit të saj.
3. Parimet, rregullat, kanonet dhe statuti i Kryegjyshitës Botërore Bektashiane dhe veprimtaria e saj respektojnë interesat kombëtarë, bashkëjetesën dhe tolerancën fetare ndërmjet bashkësive fetare në Shqipëri.

#### Neni 11

##### Organizimi i Kryegjyshitës Botërore Bektashiane

1. Në marrëdhëniet me organet, institucionet dhe organizatat e tjera laike e fetare, brenda dhe jashtë vendit, besimtarët e Kryegjyshitës Botërore Bektashiane përfaqësohen nga organet, funksionarët dhe drejtuesit e formuar, të emëruar a zgjedhur në përputhje me statutin.
2. Kryegjyshata Botërore Bektashiane ka të drejtë të formojë organet e saj, të emërojë funksionarët dhe drejtuesit në mënyrë të pavarur, në përputhje me dispozitat e parashikuara në statutin e saj. Titullari i Kryegjyshitës caktohet sipas procedurave dhe kritereve të parashikuara në statutin e Kryegjyshitës Botërore Bektashiane.
3. Përpara shpalljes publike të titullarit të caktuar, si dhe të ndryshimeve në strukturat e saj drejtuese, Kryegjyshata Botërore Bektashiane



njofton Komitetin Shtetëror për Kultet.

4. Funkionarëve, drejtuesve dhe organeve të Kryegjyshitës Botërore Bektashiane u garantohet liri e plotë e ushtrimit të veprimtarisë fetare, organizative e administrative, në përputhje me aktet e Kryegjyshitës, për aq sa kjo veprimtari nuk vjen në kundërshtim me rendin kushtetues dhe ligjor.

#### Neni 12

##### Marrëdhëniet me bashkësitë e huaja fetare

1. Kryegjyshata Botërore Bektashiane ka të drejtë të krijojë dhe të mbajë kontakte me bashkësi fetare të një vendi tjetër ose ndërkombëtare, të marrë pjesë në veprimtaritë e tyre fetare e bamirëse, për aq sa këto kontakte nuk bien ndesh me rendin e brendshëm kushtetues.
2. Kryegjyshata Botërore Bektashiane ka të drejtë të përfitojnë mbështetje financiare dhe/ose materiale nga entitete dhe/ose individë të huaj, për aq sa kjo mbështetje nuk bie ndesh me këtë Marrëveshje dhe me legjislacionin në fuqi.

### KREU III

#### STATUTI FINANCIAR

#### Neni 13

##### Mbështetja financiare ose materiale shtetërore

1. Shteti shqiptar mund t'i japë Kryegjyshitës Botërore Bektashiane, apo subjekteve juridike të themeluara prej saj, mbështetje financiare ose materiale.
2. Modalitetet dhe kriteret për sigurimin e kësaj mbështetjeje financiare duhet të përcaktohen me një ligj specifik për mbështetje financiare nga Buxheti i Shtetit për kultet fetare.

#### Neni 14

##### Regjistrimi në organet tatimore

Kryegjyshata Botërore Bektashiane, si dhe personat e saj juridikë, duhet të regjistrohen në organet tatimore, sikurse çdo person juridik jofitimprurës, në përputhje me legjislacionin përkatës.

Neni 15  
Statusi juridik dhe fiskal

1. Personat juridikë të Kryegjyshitës Botërore Bektashiane përmbushin të gjitha detyrimet ligjore të parashikuara për të gjitha personat juridikë jofitimprurës.
2. Përjashtohen nga të gjitha llojet e taksave:
  - a) Subvencionet financiare të çfarëdo lloji dhe çdo e ardhur tjetër e ligjshme, si edhe donacionet materiale të destinuar për të realizuar misionin e vet, kur këto të ardhura apo donacione nuk përdoren për përfitime nga organizatorët.
  - b) Ndërtimi i objekteve të reja, ndërtesat në pronësi ose në përdorim të Kryegjyshitës Botërore Bektashiane, ose të personave juridikë të themeluar prej saj të regjistruara pranë organeve kompetente shtetërore, në rastet kur ato përdoren pa qëllim fitimi për ushtrimin e besimit, drejtimin dhe administrimin fetar, veprimtarinë baritore, humanitare e bamirëse, formimin e klerikëve, mësimin e teologjisë dhe shkencave të tjera fetare, si dhe të personelit fetar dhe laik në shërbim të Kryegjyshitës Botërore Bektashiane.
  - c) Taksa e trashëgimisë ose e kalimit të pasurisë në procesin e regjistrimit të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, të cilat i dhurohen Kryegjyshitës Botërore Bektashiane, ose kur ato kalojnë mes entiteteve të vetë Komunitetit Bektashian.
3. Personat juridikë të themeluar nga Kryegjyshata Botërore Bektashiane, por që nuk e kanë zotësinë juridike ose nuk janë regjistruar si organizata jofitimprurëse përpara ratifikimit të kësaj Marrëveshjeje, gëzojnë të drejtën që të regjistrohen në gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë sipas nenit 8 të kësaj Marrëveshjeje, brenda dy vjetëve nga dita e hyrjes së saj në fuqi.
4. Përjashtohen nga detyrimi i derdhjes së kontributeve për sigurim shoqëror dhe shëndetësor personeli fetar dhe laik në shërbim të Kryegjyshitës Botërore Bektashiane, me kombësi të huaj, me banim të rregullt në Shqipëri, të cilët nuk përfitojnë asnjë të ardhur apo shpërblim për kryerjen e veprimtarisë së tyre dhe që i kanë derdhur këto kontribute në vendet e origjinës.
5. Kryegjyshata Botërore Bektashiane, për personelin klerik dhe laik të saj, si kategori profesionale krejt e veçantë, ka të drejtë shkallëzimin e diferencuar për nivelin e pagës, për efekt kontributesh të sigurimeve

- shoqërore e shëndetësore dhe tatimi mbi të ardhurat e personit.
6. Për veprimtaritë me karakter institucional, si: ushtrimi i kultit, drejtimi dhe administrimi i komunitetit, veprimtaria fetare, humanitare dhe bamirëse, formimi i klerit, mësimi i teologjisë dhe i shkencave fetare, Kryegjyshata Botërore Bektashiane dhe personat juridikë të themeluar prej saj nuk janë të detyruar të mbajnë regjistër kontabël dhe t'u nënshtrihen standardeve administrative të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për këtë çështje. Si pasojë, për të tilla veprimtari ato nuk e kanë detyrim që të paraqesin bilancin kontabël vjetor tek organet kompetente shtetërore dhe as ta depozitojnë atë pranë organizmave shtetërorëtë caktuar nga legjislacioni në fuqi.

#### KREU IV BASHKËPUNIMI NË TË MIRË TË SHTETASVE

##### Neni 16 Festat fetare

1. Ditët e festave fetare që do të jenë ditë pushimi vendosen me ligj. Kryegjyshata Botërore Bektashiane mund të propozojnë festa fetare, që sipas mendimit të saj, mund të shpallen ditë pushimi.
2. Kryegjyshata Botërore Bektashiane, në përputhje me nevojat fetare të besimtarëve, kanë të drejtë të përcaktojnë edhe festa të tjera veç atyre që do të trajtohen me ligj si festa zyrtare, të cilat nuk janë të detyrueshme për sektorin shtetëror publik dhe privat.

##### Neni 17 Institucionet edukative dhe arsimore të Kryegjyshitës Botërore Bektashiane

1. Kryegjyshata Botërore Bektashiane ka të drejtë, në përputhje me kriteret e parashikuara nga legjislacioni në fuqi, të ngrejë dhe të administrojë institucione edukative dhe arsimore të të gjitha niveleve.
2. Shteti dhe Kryegjyshata Botërore Bektashiane angazhohen të garantojnë të drejtën e individëve për t'u arsimuar pa asnjë dallim, përfshirë edhe arsimin fetar, duke respektuar të drejtën e prindërve për të siguruar edukimin e fëmijëve në përputhje me bindjet e tyre.

3. Shteti e njeh vlefshmërinë e dokumenteve të lëshuara nga institucionet arsimore fetare, sipas kriterëve të caktuara nga legjislacioni në fuqi për arsimin.
4. Gjatë procesit mësimdhënës shteti dhe Kryegjyshata Botërore Bektashiane angazhohen që arsimiti i fëmijëve të bazohet mbi të drejtat e njeriut dhe parimet demokratike, të drejtohet në përgatitjen e fëmijëve për një jetë të përgjegjshme në një shoqëri të lirë, në frymën e mirëkuptimit, paqes, tolerancës, barazisë gjinore dhe vëllazërisë midis njerëzve, grupeve etnike, kombëtare dhe fetare, ose personave me origjinë tjetër, duke iu kundërvënë racizmit e fanatizmit.

#### Neni 18

##### Kryerja e veprimtarive sociale

Kryegjyshata Botërore Bektashiane ka të drejtë të ushtrojë veprimtari sociale me karakter ekonomik, edukativ e shëndetësor. Kjo e drejtë përfshin edhe krijimin e mjediseve sociale të përshtatshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### Neni 19

##### Organizatave bamirëse

Kryegjyshata Botërore Bektashiane mund të themelojë organizata bamirëse, duke respektuar rregullat e përgjithshme dhe legjislacionin në fuqi.

#### Neni 20

##### Liria e shprehjes dhe e drejta për informim

1. Shteti dhe Kryegjyshata Botërore Bektashiane njohin dhe pranojnë mjetet e informimit publik si një element të rëndësishëm për mbrojtjen e lirisë së shprehjes dhe të ndërgjegjes.
2. Kryegjyshata Botërore Bektashiane ka të drejtë të shprehë dhe të përhapë lirisht bindjet e saj nëpërmjet mjeteve të komunikimit publik, medias së shkruar dhe asaj pamore, si dhe në çfarëdo forme tjetër të njohur ose që do të njihet në të ardhmen.
3. Kryegjyshata Botërore Bektashiane ka të drejtë të themelojë struktura të komunikimit publik në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në çdo rast, përmbajtja që jepet përmes mjeteve të komunikimit masiv nuk duhet të përshkohet nga ide që cenojnë rendin kushtetues, tolerancën

fetare, ose që diskriminojnë bashkësitë fetare dhe nxisin grindje ndërfitare.

4. Kryegjyshata Botërore Bektashiane ka të drejtë të shprehet nëpërmjet mjeteve të komunikimit dhe informimit publik.
5. Komiteti Shtetëror për Kultet bashkëpunon me Kryegjyshitën Botërore Bektashiane për nevoja studimore e informuese.

#### Neni 21

#### Objektet e kultit

1. Ndërtesat dhe objektet që shërbejnë për kryerjen e ceremonive fetare konsiderohen të shenjta nga Kryegjyshata Botërore Bektashiane. Ndërhyrja e autoriteteve shtetërore në to është e ndaluar, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë kërkohet në zbatim të një vendimi gjyqësor ose titulli ekzekutiv, ose në rast të kanosjes së një rreziku të afërm.
2. Paprekshmëria e hapësirës publike garantohehet nga shteti.
3. Organet kompetente shtetërore, në bashkëpunim me Kryegjyshitën Botërore Bektashiane, përcaktojnë vendin për ndërtimin e objekteve të reja të kultit dhe vendosjen e simboleve fetare, në përputhje me planet rregulluese urbanistike dhe kriteret që parashikon ligji “Për urbanistikën”.

### KREU V

### ÇËSHTJET E PRONËSISË

#### Neni 22

#### E drejta e pronës

1. Shteti i njeh Kryegjyshitës Botërore Bektashiane të drejtën e pronës mbi sende të luajtshme dhe të paluajtshme.
2. Shteti do t’i kthejë dhe kompensojë Kryegjyshitës Botërore Bektashiane të gjitha pronat, me përparësi objektet e kultit tashmë të njohura nga të gjithë, të cilat kanë qenë për shekuj qendra shpirtërore dhe kulturore të komunitetit bektashian dhe përbëjnë historinë e këtij komuniteti, si objektet e kultit, vendet e shenjta, sendet e kultit dhe arkivat e saj të konfiskuara nga regjimi komunist.
3. Në rastet kur objektet e kultit të Komunitetit Bektashian nuk gjenden të

regjistruara në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, pronësinë do ta vërtetojë (provojë) nëpërmjet dokumenteve të Arkivit Qendror të Shtetit.

### Neni 23

#### Mbrojtja e trashëgimisë kulturore fetare

1. Republika e Shqipërisë njeh trashëgiminë morale dhe pasurore të besimit bektashian.
2. Objektet e kultit që kanë statusin e monumentit të kulturës, i kthehen në pronësi dhe përdorim Kryegjyshitës Botërore Bektashiane dhe për çdo ndërhyrje të mundshme që do të bëjë Instituti i Monumenteve të Kulturës të bashkëpunojë me të.
3. Shteti mund të marrë në përdorim një objekt të kultit vetëm për nevoja e interesa madhorë dhe vetëm pasi të ketë marrë paraprakisht pëlqimin e Kryegjyshitës Botërore Bektashiane.
4. Këshilli i Ministrave, duke u bazuar edhe në mendimin e bashkësisë, bashkërendon përpjekjet në të ardhmen për të evidentuar, vlerësuar e mbrojtur pasuritë kulturore, si dhe godinate kultit të Kryegjyshitës Botërore Bektashiane, të cilat bartin vlera të kulturës kombëtare materiale e shpirtërore.
5. Shteti lejon ushtrimin e veprimtarisë fetare në një objekt të kultit që është trashëgimi kulturore kombëtare, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

## KREU VI

### DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

### Neni 24

#### Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Interpretimi dhe zbatimi i kësaj Marrëveshjeje, si dhe zgjidhja e çështjeve të diskutueshme bëhen mbi bazën e mirëkuptimit midis palëve.
2. Ndryshimet e kësaj Marrëveshjeje mund të bëhen me mirëkuptim midis palëve.
3. Për të gjitha çështjet e përbashkëta në të cilat do të ketë mendime të ndryshme, Kryegjyshata Botërore Bektashiane dhe Këshilli i

Ministrave i Republikës së Shqipërisë do të gjejnë një qëndrim të njëjtë, duke pranuar ndërmjetësimin e Komitetit Shtetëror për Kultet përzgjidhjen e gjithë pranuar.

Neni 25  
Dispozita të fundit

1. Shteti i njeh të drejtën Kryegjyshit Botërore Bektashiane që të lidhin marrëveshje të veçanta për zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.
2. Kjo Marrëveshje shërben si akt bazë për nënshkrimin e marrëveshjeve të veçanta, me Kryegjyshitën Botërore Bektashiane, që ratifikohen në Kuvend.
3. Marrëveshjet e veçanta që lidhen me Kryegjyshitën Botërore Bektashiane në bazë të kësaj Marrëveshjeje, regjistrohen në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Kryegjyshata Botërore Bektashiane mund të tërhiqet nga kjo Marrëveshje me anë të denoncimit të Marrëveshjes së ratifikuar në Kuvend.

Bërë në Tiranë, më 24.10.2008.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE  
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

PËR KRYEGJYSHATËN  
BOTËRORE BAKTASHIANE

